

Rregullore e Komisionit (KE) nr. 1702/2003, datë 24 shtator 2003, që parashtron rregullat zbatuese për certifikimin e vlefshmërisë ajrore dhe certifikimin mjedisor të mjeteve fluturuese dhe të produkteve, pjesëve apo pajisjeve përkatëse, si edhe për certifikimin e sipërmarrjeve të projektimit dhe të prodhimit të tyre (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në)

Gazeta Zyrtare L 243, 27/09/2003, fq. 0006 – 0079

Rregullore e Komisionit (KE) nr. 1702/2003, datë 24 shtator 2003, që parashtron rregullat zbatuese për certifikimin e vlefshmërisë ajrore dhe certifikimin mjedisor të mjeteve fluturuese dhe të produkteve, pjesëve apo pajisjeve përkatëse, si edhe për certifikimin e sipërmarrjeve të projektimit dhe të prodhimit të tyre (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në)

Komisioni i Komuniteteve Europiane,

Duke pasur parasysh Rregulloren (KE) nr. 1592/2002 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 15 korrik 2002, për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e Agjencisë Europiane për Sigurinë e Aviacionit [1] (më poshtë quajtur Rregullorja bazë), sipas përshtatjes nga Rregullorja (KE) nr. 1701/2003 [2], dhe veçanërisht nenet 5 dhe 6 të saj,

Duke pasur parasysh se:

(1) Rregullorja bazë përcakton normat e përbashkëta bazë për të siguruar nivel të lartë dhe uniform sigurie të aviacionit civil dhe mbrojtjes së mjedisit; për këtë qëllim Komisioni miraton rregullat e nevojshme zbatuese për të siguruar zbatim uniform, si dhe themelon "Agjencinë Europiane për Sigurinë Ajrore" (më poshtë quajtur "Agjencia") për të ndihmuar Komisionin me hartimin e këtyre rregullave zbatuese.

(2) Normat ekzistuese aeronautike në fushën e vlefshmërisë ajrore sikurse janë renditur në Shtojcën II të Rregullores së Këshillit (KEE) nr. 3922/91 [3], të ndryshuar së fundmi nga Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 2871/2000 [4] do të shfuqizohen nga 28 shtatori 2003.

(3) Është e nevojshme të miratohen norma teknike dhe procedura administrative të përbashkëta, për të siguruar vlefshmërinë ajrore dhe pajtueshmërinë mjedisore të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike, që janë objekt i rregullores bazë; këto kritere dhe procedura duhet të përcaktojnë kushtet për lëshimin, mbajtjen, ndryshimin, pezullimin apo revokimin e certifikatave të duhura.

(4) Sipërmarrjet që merren me projektimin dhe prodhimin e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve duhet të përmbushin disa norma teknike për të dëshmuar se kanë aftësitë dhe mjetet e duhura për të përmbushur përgjegjësitë dhe privilegjet e lidhura me to. Komisioni duhet të miratojë masat që përcaktojnë kushtet për lëshimin, mbajtjen, ndryshimin, pezullimin apo revokimin e certifikatave që vërtetojnë këtë respektim. .

(5) Gjatë miratimit të masave për zbatimin e normave të përbashkëta bazë në fushën e vlefshmërisë ajrore, Komisioni duhet të kujdeset, që ato të reflektojnë zhvillimet më të fundit dhe praktikat më të mira, duke pasur parasysh përvojën mbarëbotërore në fushën e aeronautikës si dhe progresin shkencor dhe teknik, dhe të reagojë me shpejtësi për të përballuar shkaqet e njohura të aksidenteve dhe incidenteve të rënda.

(6) Nevoja për të siguruar zbatim uniform të normave të përbashkëta bazë të vlefshmërisë ajrore dhe atyre mjedisore për produktet, pjesët dhe pajisjet aeronautike, kërkon procedura analoge nga ana e autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare, dhe ku është e zbatueshme edhe nga ana e Agjencisë, me qëllim vlerësimin e

pajtimit me këto norma. Agjencia duhet të hartojë kushtet për certifikim, si edhe materiale udhëzuese e shpjeguese, për të bërë të mundur njehsueshmërinë e nevojshme rregullatore.

(7) Për këtë qëllim, është e nevojshme të lejohet një tranzicion gradual drejt një kuadri të ri rregullator të Agjencisë, duke i siguruar aviacionit civil të Komunitetit ruajtjen e një niveli të lartë dhe uniform sigurie. Është e nevojshme që industrisë aeronautike dhe administratave të Shteteve Anëtare t'u lihet kohë e mjaftueshme për t'u përshtatur me këtë kuadër të ri dhe për të njohur vlefshmërinë e vazhdueshme të certifikatave të lëshuara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 57 të Rregullores bazë.

(8) Masat e parashikuara nga kjo rregullore bazohen në opinionin e dhënë nga Agjencia [5] në përputhje me nenin 12, pika 2, germa (b) dhe nenin 14, pika 1 të Rregullores bazë.

(9) Masat e parashikuara në këtë rregullore janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Agjencisë Europiane për Sigurinë e Aviacionit, i themeluar në bazë të nenit 54, pika 3 të Rregullores bazë.

MIRATON KËTË RREGULLORE:

Neni 1

Fusha e veprimit dhe përkufizimet

1. Kjo rregullore, në përputhje me nenin 5, pika 4 dhe nenin 6, pika 3 të Rregullores bazë, përcakton kritere të përbashkëta teknike dhe procedura administrative për certifikimin e vlefshmërisë ajrore dhe certifikimin mjedisor të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve duke përcaktuar:

- a) lëshimin e certifikatave tip, certifikatave tip të kufizuara, certifikatave tip shtesë dhe ndryshimet në këto certifikata;
- b) lëshimin e certifikatave të vlefshmërisë ajrore, certifikata të kufizuara të vlefshmërisë ajrore, leje fluturimi dhe certifikata ripranimi në shërbim;
- c) dhënien e miratimit për projektet e riparimit;
- d) dëshminë e pajtimit me kërkesat për mbrojtjen mjedisore;
- e) lëshimin e certifikatave për zhurmën;
- f) identifikimin e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve;
- g) certifikimin e pjesëve dhe pajisjeve të caktuara;
- h) certifikimin e sipërmarrjeve të projektimit dhe të prodhimit;
- i) nxjerrjen e direktivave për vlefshmërinë ajrore;

2. Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- (a) “APA” nënkupton “Autoritetet e Përbashkëta Aeronautike”
- (b) “JAR” nënkupton “Kërkesat e Përbashkëta Aeronautike”

- (c) “Pjesa 21” nënkupton kërkesat dhe procedurat për certifikimin e mjetit fluturues ose të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve, certifikimin e sipërmarrjeve të projektimit dhe të prodhimit të parashikuara në këtë rregullore.
- (d) “Pjesa M” nënkupton kërkesa të zbatueshme për vlefshmërinë ajrore, të miratuara në përputhje me Rregulloren bazë.

Neni 2

Certifikimi i produkteve, pjesëve dhe pajisjeve

1. Për produktet, pjesët dhe pajisjet lëshohen certifikata sikurse përcaktohet në pjesën 21.
2. Duke u shmangur nga germa 1, mjetet fluturuese, duke përfshirë çdo produkt, pjesë apo pajisje të montuar, të cilët nuk janë të regjistruar në ndonjë Shtet Anëtar, nuk janë objekt i dispozitave të titujve H dhe I të pjesës 21.
3. Për produktet për të cilat është lëshuar certifikatë tip para 28 shtatorit 2003 nga një Shtet Anëtar, zbatohen dispozitat e mëposhtme:
 - (a) Produkti i tillë konsiderohet i pajisur me certifikatë tip certifikimi në përputhje me këtë rregullore, kur:
 - (i) kushtet e certifikatës tip të tij janë:
 - kushtet e certifikimit tip APA, për produkte që janë certifikuar sipas procedurave të APA-s, sikurse është përcaktuar në skedën teknike APA; ose
 - për produkte të tjera, kushtet e certifikimit tip sikurse përcaktohet në skedën e fluturimit të certifikatës tip të shtetit të projektimit, nëse ky shtet i projektimit është:
 - një Shtet Anëtar, përveç rasteve kur Agjencia pasi merr parasysh kodet e vlefshmërisë ajrore të përdorura dhe përvojën e shërbimit vendos se këto kushte të certifikimit tip nuk ofron nivel sigurie të barasvlefshëm me atë që kërkohet nga Rregullorja bazë dhe nga kjo rregullore; ose
 - një shtet me të cilin një Shtet Anëtar ka lidhur një marrëveshje dypalëshe për vlefshmërinë ajrore, ose një marrëveshje të ngjashme në kuadër të të cilës këto produkte janë certifikuar në bazë të kodeve të vlefshmërisë ajrore të Shtetit të projektimit, përveç rasteve kur Agjencia vendos që këto kode të vlefshmërisë ajrore apo sistemi i sigurisë i Shtetit të projektimit të këtij shteti projektimi, nuk garantojnë nivel sigurie të barasvlefshëm me atë të kërkohet nga Rregullorja bazë dhe nga kjo rregullore;
 - Agjencia duhet të bëjë një vlerësim të parë të implikimit të këtyre dy dispozitave të mësipërme, me qëllim që t’i paraqesë një opinion Komisionit që përmban ndryshime të mundshme të kësaj rregulloreje.
 - (ii) kushtet për mbrojtjen mjedisore janë ato që janë përcaktuar në Shtojcën 16 të Konventës së Çikagos, siç janë të zbatueshme për produktin;
 - (iii) rregullat e zbatueshme për vlefshmërinë ajrore janë ato të shtetit të projektimit.
 - (b) Çdo projekt mjeti fluturues të pranishëm në regjistrin e një Shteti Anëtar që para datës 28 shtator 2003, konsiderohet i miratuar në përputhje me këtë rregullore kur:
 - (i) projekti tip bazë i tij është pjesë e një certifikate tip të parashikuar në germën (a);
 - (ii) të gjitha ndryshimet e këtij projekti tip bazë, të cilat nuk janë përgjegjësia e mbajtësit të certifikatës tip, janë miratuar; dhe

(iii) respektohen rregullat për vlefshmërinë ajrore të nxjerra ose të miratuara nga Shteti Anëtar ku është regjistruar para 28 shtatorit 2003, duke përfshirë çdo ndryshim të rregullave për vlefshmërinë ajrore të shtetit të projektimit të miratuara nga Shteti Anëtar i regjistrimit.

(c) Agjencia përcakton certifikatën tip të certifikimit për produktet që nuk përmbushin kërkesat e germës (a) para 28 marsit 2007.

(d) Agjencia përcakton skedën teknike akustike të certifikatës tip për të gjitha produktet e përfshira në germën (a) para 28 marsit 2007. Deri sa të bëhet ky përcaktim, Shtetet Anëtare mund të vazhdojnë të lëshojnë certifikata akustike në përputhje me rregullat e brendshme në fuqi.

4. Për sa i përket produkteve që më 28 shtator 2003 janë në proces certifikimi tip që kryhet nga APA ose një Shtet Anëtar:

(a) nëse një produkt është duke u certifikuar nga disa Shtete Anëtare, si referencë merret projekti më i përparuar.

(b) pika 21A.15 germat (a), (b) dhe (c) të pjesës 21 nuk zbatohen;

(c) duke u shmangur nga pika 21A.17 germa (a) e pjesës 21, kushtet e certifikimit tip janë ato të përcaktuara nga APA, ose kur është e zbatueshme, nga Shteti Anëtar në ditën e kërkesës për miratim;

(d) konstatimet e përputhshmërisë të bëra nëpërmjet procedurave të APA-s ose të Shtetit Anëtar, konsiderohen se janë bërë nga Agjencia me qëllim përputhjen me pikat 21A.20 germat (a) dhe (b) të pjesës 21;

5. Për sa i përket produkteve të pajisur me certifikatë tip kombëtare ose të barasvlefshme me të, për të cilat procesi i miratimit të një ndryshimi të kryer nga një Shtet Anëtar nuk përfundon në kohën kur certifikata tip konsiderohet se është në përputhje me këtë rregullore:

(a) nëse ky proces miratimi kryhet nga disa Shtete Anëtare, si referencë merret projekti më i përparuar;

(b) pika 21A93 e pjesës 21 nuk zbatohet;

(c) kushtet e certifikatës tip të zbatueshme janë ato të përcaktuara nga APA ose kur është e zbatueshme, nga Shteti Anëtar në datën e kërkesës për miratimin e ndryshimit;

(d) konstatimet e përputhshmërisë të bëra nëpërmjet procedurave të APA-s ose të Shtetit Anëtar konsiderohen se janë bërë nga Agjencia me qëllim përputhjen me pikat 21A.20 germat (a) dhe (b) të pjesës 21;

6. Për sa i përket certifikatës tip shtesë për të cilat më 28 shtator 2003 është në vazhdim procesi i certifikimit nga një Shtet Anëtar sipas procedurave të APA-s për certifikatat shtesë, si dhe për sa i përket ndryshimeve të mëdha të produkteve të propozuara nga persona të ndryshëm nga mbajtësi i certifikatës tip të produktit, për të cilat më 28 shtator 2003 është në vazhdim procesi i certifikimit nga një Shtet Anëtar sipas procedurave të brendshme të zbatueshme:

(a) nëse një proces certifikimi po kryhet nga disa Shtete Anëtare, si referencë merret projekti më i përparuar.

(b) pikat 21A.113 germat (a) dhe (b) të pjesës 21 nuk zbatohen;

(c) kushtet e zbatueshme për certifikimin janë ato të përcaktuara nga APA ose kur është e zbatueshme, nga Shteti Anëtar në datën e kërkesës për certifikatë tip shtesë ose për miratimin e ndryshimit të madh;

(d) konstatimet e përputhshmërisë të bëra nëpërmjet procedurave të APA-s ose të Shtetit Anëtar konsiderohen se janë bërë nga Agjencia me qëllim përputhjen me pikën 21A.115 germa (a) të pjesës 21;

7. Për sa i përket produkteve të pajisur me certifikatë tip kombëtare ose të barasvlershme me të, dhe për të cilat procesi i miratimit për një projekt të rëndësishëm riparimi që kryhet nga një Shtet Anëtar nuk është përfunduar në kohën kur certifikata tip përcaktohet në përputhje me këtë rregullore, konstatimet e përputhshmërisë të bëra sipas procedurave të APA-s ose Shtetit Anëtar konsiderohen se janë nxjerrë nga Agjencia me qëllim përputhjen me pikën 21A.433 germa (a) të pjesës 21.

8. Për sa i përket pjesëve dhe pajisjeve për të cilat më 28 shtator 2003 po kryhet një proces miratimi ose autorizimi:

(a) nëse një proces autorizimi kryhet nga disa Shtete Anëtare, si referencë merret projekti më i përparuar;

(b) pika 21A. 603 e pjesës 21 nuk zbatohet;

(c) kërkesat e zbatueshme për të dhënat sipas 21A.605 germa (b) të pjesës 21, janë ato të përcaktuara nga Shteti Anëtar përkatës, në datën e kërkesës për miratim ose autorizim;

(d) konstatimet e përputhshmërisë të bëra nga Shteti Anëtar përkatës konsiderohen se janë bërë nga Agjencia me qëllim përputhjen me pikën 21A.606 germa (b) të pjesës 21;

9. Një certifikatë e vlefshmërisë ajrore e lëshuar nga një Shtet Anëtar që vërteton përputhshmërinë me një certifikatë tip të përcaktuar në përputhje me pikën 3, konsiderohet në përputhje me këtë rregullore.

10. Në pritje të përcaktimit të Agjencisë sipas germës (c) të pikës 3, llojet e mjeteve fluturuese që lejohen të përdoren për fluturime nga një Shtet Anëtar para 28 shtatorit 2003 dhe për të cilat nuk mund të lëshohet certifikatë tip në përputhje me pikën 3, mbeten nën përgjegjësinë e Shtetit Anëtar të regjistrimit sipas kërkesave të brendshme të zbatueshme.

11. Deri më 28 mars 2007, Shtetet Anëtare duhet të bëjnë konstatimet e nevojshme me qëllim që kufizimet e vendosura ndaj mjetit fluturues për mangësitë e kushteve thelbësore, nuk e pengojnë mjetin fluturues të kryejë manovra normale fluturimi të sigurta. Në raste të tilla, lejet e fluturimit përmbajnë kufizime për përdorimin e hapësirës ajrore të Shtetit Anëtar autoriteti kompetent i të cilit jep lejen. Për fluturimet jashtë kësaj hapësire ajrore, duhet njohja e lejes nga autoritetet kompetente të shteteve përkatëse.

Deri më 28 mars 2007, një mjet ajror që është lejuar nga një Shtet Anëtar të fluturojë para datës 28 shtator 2003 pa një certifikatë për vlefshmërinë ajrore, mund të mbetet nën përgjegjësinë e Shtetit Anëtar në përputhje me normat e brendshme në fuqi. Ky mjet fluturues duhet të fluturojë vetëm brenda hapësirës ajrore të Shtetit Anëtar në fjalë. Për fluturimet jashtë kësaj hapësire ajrore, duhet njohja e lejes nga autoritetet kompetente të shteteve përkatëse.

12. Kur i referohemi pjesës 21 për të zbatuar dhe/ose për të respektuar dispozitat e pjesës M dhe pjesa M nuk është në fuqi, zbatohen në vend të saj normat e brendshme përkatëse.

13. Miratimet e pjesëve dhe pajisjeve të dhëna nga një Shtet Anëtar dhe të vlefshme më 28 shtator 2003, konsiderohen të lëshuara në përputhje me këtë rregullore.

14. Për sa u përket certifikatave tip shtesë të lëshuara nga një Shtet Anëtar sipas procedurës së APA-s ose sipas procedurave të brendshme, si dhe për sa u përket ndryshimeve të produkteve të propozuara nga persona të ndryshëm nga mbajtësit e certifikatës tip të produktit, të miratuara nga një Shtet Anëtar sipas procedurave

kombëtare të zbatueshme, ku certifikata tip shtesë ose ndryshimi është i vlefshëm më 28 shtator 2003, certifikata tip shtesë ose ndryshimi konsiderohet e lëshuar në përputhje me këtë rregullore.

Neni 3 **Sipërmarrjet e projektimit**

1. Një sipërmarrje përgjegjëse për projektimin e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve, ose që kryen modifikime apo riparime, duhet të dëshmojë aftësitë e saj në përputhje me dispozitat e pjesës 21.

2. Duke u shmangur nga pika 1, sipërmarrja me seli kryesore në një shtet joanëtar, mund të dëshmojë aftësitë e veta përmes zotërimit të një certifikate të lëshuar nga ai shtet për produktin, pjesët dhe pajisjet që janë objekt i kërkesës për certifikim, me kusht që:

(a) ai shtet të jetë shteti i projektimit; dhe

(b) agjencia të ketë përcaktuar se sistemi i atij shteti përfshin të njëjtin nivel të pavarur të kontrollit të përputhshmërisë me atë të parashikuar nga kjo rregullore, ose përmes një sistemi të barasvlefshëm për miratimin e sipërmarrjeve, ose përmes ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të autoritetit kompetent të këtij shteti.

3. Miratimet e sipërmarrjes së projektimit (DOA) të lëshuara ose të njohura nga një Shtet Anëtar në përputhje me kërkesat dhe procedurat e APA-s dhe i vlefshëm para 28 shtatorit 2003, do të konsiderohet se është në përputhje me këtë rregullore. Në një rast të tillë, afati për vendimin e mospërputhjeve të nivelit të dytë që përmendet në nënpjesën J të pjesës 21, nuk do ta kalojë një vit kur këto mospërputhje lidhen me ndryshime të JAR në fuqi më përpara.

4. Mbajtësi i një certifikatë tip, i cili më 28 shtator 2003 nuk ka miratimin e përshtatshëm DOA, sipas procedurave të zbatueshme të APA-s, dëshmon aftësinë e tij sipas kushteve të përcaktuara në 21A.14 të pjesës 21 para 28 shtatorit 2005.

5. Sipërmarrja që ka bërë kërkesë për certifikatë tip shtesë, një miratim të një riparimi të madh ose një miratim të projektit të Njësisë Ndhmëse të Energjisë, e cila nuk mban më 28 shtator 2003 një miratim DOA të lëshuar nga një Shtet Anëtar sipas procedurave të zbatueshme të APA-s, e dëshmon aftësinë e tij para datës 28 shtator 2005 në përputhje me pjesën 21, 21A.112, 21A.432B, ose në rast të një Njësie Ndhmëse të Energjisë, në përputhje me 21A.602B.

6. Për sa i përket sipërmarrjeve për të cilat miratimi DOA shqyrtohet përmes një Shteti Anëtar më 28 shtator 2003 sipas procedurave të zbatueshme të APA-s:

1. nuk zbatohet 21A.234 e pjesës 21;

2. konstatimet e përputhshmërisë të arritura sipas procedurave të APA-s do të konsiderohen se janë realizuar nga Agjencia me qëllim përputhjen me 21A.245 të pjesës 21.

Neni 4 **Sipërmarrjet prodhuese**

1. Një sipërmarrje përgjegjëse për prodhimin e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve duhet të dëshmojë aftësitë e veta në përputhje me dispozitat e pjesës 21.

2. Duke u shmangur nga pika 1, një prodhues, selia e të cilit është një shtet joanëtar mund të dëshmojë aftësitë e tij duke mbajtur një certifikatë të lëshuar nga shteti për produktin, pjesën dhe pajisjen për të cilën bëhet kërkesë në rast se:

(a) shteti është shteti i prodhimit; dhe

(b) agjencia ka përcaktuar se sistemi i atij shteti përfshin të njëjtin nivel të pavarur të kontrollit të përputhshmërisë sikurse përcaktohet në këtë rregullore, ose nëpërmjet një sistemi të barasvlefshëm për miratimin e sipërmarrjeve ose përmes ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të autoritetit të atij shteti.

3. Miratimi për sipërmarrjet i dhënë ose i njohur nga një Shtet Anëtar në përputhje me kërkesat dhe procedurat e APA-s para 28 shtatorit 2003, konsiderohet në përputhje me këtë rregullore. Në këtë rast, afati për vendimin e mospërputhjeve të nivelit të dytë, të përmendura në nënpjesën G të pjesës 21 nuk duhet ta kalojnë një vit kur këto konstatime kanë lidhje me ndryshimet në JAR-në e zbatueshme më parë.

4. Sipërmarrjet duhet të dëshmojnë aftësinë e tyre sipas kësaj rregulloreje para datës 28 shtator 2005.

5. Deri sa një sipërmarrje të ketë dëshmuar aftësinë e vet sipas nënpjesëve F dhe G të pjesës 21, deklaratat e përputhshmërisë dhe certifikatat e autorizuara të lëshuara nga sipërmarrja sipas normave kombëtare në fuqi do të konsiderohen se janë lëshuar në përputhje me këtë rregullore.

6. Për sa i përket sipërmarrjeve për të cilat po ndiqet një procedurë për miratim të sipërmarrjeve prodhuese përmes një Shteti Anëtar në 28 shtator 2003 sipas procedurave të zbatueshme të APA-s:

(a) 21A.134 e pjesës 21 nuk do të zbatohet;

(b) konstatimet e përputhshmërisë të arritura sipas procedurave të APA-së do të konsiderohen se janë arritur nga Agjencia me qëllim përputhjen me 21A.145 të pjesës 21. xxx

Neni 5 Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në 28 shtator 2003, me përjashtim të 21A.804 germa (a) pika 3 të pjesës 21 e cila hyn në fuqi në 28 mars 2004, dhe të nënpjesëve H të pjesës 21 e cila hyn në fuqi në 28 shtator 2004.

2. Duke u shmangur nga 21A.159 e pjesës 21, Shtetet Anëtare mund të japin miratime të një kohëzgjatjeje të kufizuar deri më 28 shtator 2007.

3. Duke u shmangur nga 21A.181 e pjesës 21, Shtetet Anëtare mund të lëshojnë certifikata për një kohëzgjatje të kufizuar deri më 28 shtator 2008.

4. Kur një Shtet Anëtar shfrytëzon dispozitat e pikave 2 dhe 3, ai njofton Komisionin dhe Agjencinë.

5. Agjencia bën një vlerësim në kohën e duhur të implikimit të dispozitave të kësaj rregulloreje mbi kohëzgjatjen e vlefshmërisë së miratimeve duke pasur parasysh dhënien e një opinioni për Komisionin duke përfshirë ndryshime të mundshme të tij.

Kjo rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 24 shtator 2003.

Për Komisionin

Loyola de Palacio

Zv-president

- [1] GZ L 240, 07.09.2002, fq. 1
- [2] Shiko faqen 5 të Gazetës Zyrtare
- [3] GZ L 373, 31.12.1991, fq. 4
- [4] GZ L 333, 29.12.2000, fq. 47
- [5] 1.9.2003

SHTOJCË

Pjesa 21

Certifikimi i avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve të lidhura me të dhe certifikimi i sipërmarrjeve projektuese dhe prodhuese

Përmbajtje (paraqitje e detajuar)

Tabelë

21.1 Të përgjithshme

Për qëllimin e kësaj pjese, “autoriteti kompetent” nënkupton:

- (a) për sipërmarrjet që vendin kryesor të biznesit e kanë në një Shtet Anëtar, autoriteti i caktuar nga ai Shtet Anëtar; ose Agjencia nëse kërkohet kështu nga ai Shtet Anëtar; ose
- (b) për sipërmarrjen që vendin kryesor të biznesit e kanë në një shtet joanëtar, Agjencia.

SEKSIONI A

KËRKESAT PËR KËRKUESIT DHE TË DREJTAT DHE DETYRIMET E FITUARA

NËNPJESA A – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

21A.1 Qëllimi

Kjo pjesë përcakton dispozitat e përgjithshme që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e kërkuesit për, dhe mbajtësit të ndonjë certifikatë të lëshuar ose që do të lëshohet në përputhje me këtë seksion.

21A.2 Marrja përsipër nga një person tjetër i cili nuk është mbajtës apo kërkues për certifikatë

Veprimet dhe detyrimet që merren përsipër nga mbajtësi i, ose kërkuesi për, një certifikate për një produkt, pjesë ose pajisje sipas këtij seksioni, mund të ndërmerren në emër të tij nga cilido person fizik ose juridik, në rast se mbajtësi i, ose kërkuesi për, atë certifikatë mund të tregojë se ka bërë një marrëveshje me personin tjetër për të siguruar, që detyrimet e mbajtësit respektohen dhe do të respektohen ashtu si duhet.

21A.3 Dështimet, keqfunksionimet dhe defektet

(a) Sistemi për mbledhjen, hetimin dhe analizën e të dhënave.

Mbjtësi i një certifikate tip, certifikate tip të kufizuar, certifikate tip shtesë, autorizimit të Urdhrit European për Standardin Teknik, (UEST), miratimit të një projekti riparimi të rëndësishëm, ose i ndonjë miratimi tjetër që ka lidhje me to, që konsiderohen se janë nxjerrë në përputhje me këtë rregullore, do të ketë një sistem për të mbledhur, hetuar dhe analizuar raportet e informacioneve në lidhje me dështimet, keqfunksionimet, defektet ose dukuri të tjera që mund të shkaktojnë efekte negative në vazhdimësinë e aftësisë për të fluturuar, të produktit, pjesës ose pajisjes së mbuluar nga certifikata tip, certifikata tip e kufizuar, certifikata tip shtesë, autorizimi UEST, miratimi i riparimeve të rëndësishme ose ndonjë miratim tjetër që konsiderohet se është lëshuar sipas kësaj rregulloreje. Informacioni për këtë sistem do të vihet në dispozicion të të gjithë operatorëve të produktit, pjesës ose pajisjes dhe nëse kërkohet edhe në dispozicion të ndonjë personi të autorizuar sipas rregulloreve të tjera që kanë lidhje me to dhe që janë në zbatim.

(b) Raportimi pranë Agjencisë

1. Mbjtësi i një certifikate tip, certifikate tip të kufizuar, certifikate tip shtesë, autorizimit të UEST-it, miratimit të një projekti riparimi të rëndësishëm ose i ndonjë miratimi tjetër që ka lidhje me to që konsiderohen se janë nxjerrë në përputhje me këtë rregullore, do të raportojë pranë Agjencisë për ndonjë dështim, keqfunksionim, defekt ose ndonjë ngjarje tjetër për të cilën ka dijeni në lidhje me një produkt, pjesë ose pajisje që mbulohet nga certifikata tip, certifikata tip e kufizuar, certifikata tip shtesë, autorizim UEST, miratim të një projekti riparimi të rëndësishëm, ose ndonjë miratim tjetër të këtij lloji që konsiderohen se janë lëshuar sipas kësaj rregulloreje dhe që ka rezultuar në, ose mund të rezultojë në ndonjë gjendje të pasigurtë.

2. Këto raporte do të përgatiten në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Agjencia, sapo të jetë e mundur të përdoren, dhe në çdo rast të dërgohen, jo më vonë se 72 orë pas identifikimit të kushteve që mund të jenë të pasigurta, në rast se kjo nuk pengohet nga kushte të jashtëzakonshme.

(c) Hetimi i ngjarjeve të raportuara

1. Kur një ngjarje e raportuar sipas germës (b), ose sipas 21A.129 germa (f) pika 2 ose sipas 21A.165 germa (f) pika 2 rezulton si pasojë e një mangësie në projektim ose në prodhim, mbajtësi i një certifikate tip, certifikate tip të kufizuar, certifikate tip shtesë, autorizimit të UEST-it, miratimit të një projekti riparimi të rëndësishëm ose i ndonjë miratimi tjetër që ka lidhje me to, që konsiderohen se janë nxjerrë në përputhje me këtë rregullore, ose sipas rastit, prodhuesi do të hetojë mbi shkakun e mangësisë dhe do t'i raportojë Agjencisë rezultatet e hetimit dhe ndonjë veprim që po ndërmerret ose që propozon të ndërmarrë për të korrigjuar atë mangësi.

2. Nëse Agjencia arrin në përfundimin se duhen marrë masa për ta korrigjuar mangësinë, mbajtësi i një certifikate tip, certifikate tip të kufizuar, certifikate tip shtesë, autorizimit të UEST-it, miratimit të një projekti riparimi të rëndësishëm ose i ndonjë miratimi tjetër që ka lidhje me to, që konsiderohen se janë nxjerrë në përputhje me këtë rregullore, ose sipas rastit, prodhuesi do të paraqesë të dhënat përkatëse pranë Agjencisë.

21A.3B Direktivat për aftësinë për të fluturuar

(a) Një direktivë për aftësinë për të fluturuar, është një dokument i lëshuar ose i miratuar nga Agjencia, i cili urdhëron kryerjen e punimeve në një avion për të kthyer një nivel të pranueshëm sigurie kur provat tregojnë në nivelin e sigurisë së atij avioni në të kundërt do të komprometohej.

(b) Agjencia do të nxjerrë direktivë për aftësinë për të fluturuar kur:

1. Agjencia ka përcaktuar se ekziston një kusht i pasigurt në një avion si pasojë e një mangësie në atë avion, motor, helikë, pjesë ose pajisje të montuar në këtë avion; dhe

2. Ai kusht mund të ekzistojë ose të zhvillohet në një avion tjetër.

(c) Kur një direktivë për aftësinë për të fluturuar duhet të lëshohet nga Agjencia për të korrigjuar kushtin e pasigurt të përmendur në germën (b), ose për të kërkuar kryerjen e një inspektimi, mbajtësi i një certifikate tip, certifikate tip të kufizuar, certifikate tip shtesë, autorizimit të UEST-it, miratimit të një projekti riparimi të rëndësishëm ose i ndonjë miratimi tjetër që ka lidhje me to, që konsiderohen se janë nxjerrë në përputhje me këtë rregullore:

1. Propozon veprimin e përshtatshëm korrigjues ose inspektimet e kërkuara, ose të dyja dhe paraqet pranë Agjencisë hollësira të këtyre propozimeve për të marrë miratimin e tyre.

2. Në vijim të miratimit nga Agjencia të propozimit të përmendur në nënpikën 1, vë në dispozicion të gjithë operatorëve të njohur ose të gjithë atyre që zotërojnë produktin, pjesën ose pajisjen, dhe nëse kërkohet, edhe të ndonjë personi të cilit i kërkohet të veprojë në përputhje me direktivën, të dhënat e duhura përshkruese dhe udhëzimet e realizimit.

(d) Direktiva për aftësinë për të fluturuar përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

1. Një identifikim të kushtit të pasigurtë;
2. Një identifikim të avionit të prekur;
3. Veprimin (Veprimet) e nevojshme;
4. Kohën brenda të cilës duhet të kryhet veprimi (veprimet);
5. Datën e hyrjes në fuqi.

21A.4 Koordinimi ndërmjet projektimit dhe prodhimit

Secili mbajtës i një certifikate tip, certifikate tip të kufizuar, certifikate tip shtesë, autorizim të UEST-it, miratimit të ndryshimit të projektit tip ose miratimit të projektit të riparimit, bashkëpunon me sipërmarrjen prodhuese sipas nevojave për të siguruar:

- (a) Koordinimin e kënaqshëm të projektimit dhe prodhimit të kërkuar sipas rastit në 21A.122 ose 21A.133 ose 21A.165 germa (c) pika 2 dhe
- (b) Mbështetjen e duhur të aftësisë së vazhdueshme për të fluturuar të produktit, pjesës ose pajisjes.

NËNPJESA B – CERTIFIKATAT TIP DHE CERTIFIKATAT TIP TË KUFIZUARA

21A. 11 Qëllimi

Kjo nënpjesë përcakton procedurën për lëshimin e certifikatave tip për produktet dhe certifikatat tip të kufizuara për avionët, dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e kërkuarve për certifikata si dhe të mbajtësve të atyre certifikatave.

21A.13 E drejta për t'u përzgjedhur

Çdo person fizik ose juridik që ka dëshmuar ose është në proces e sipër të dëshmimit të aftësisë së tij në përputhje me 21A.14, ka të drejtën të merret në konsideratë si kërkuar për një certifikatë tip ose certifikatë tip të kufizuar sipas kushteve të përcaktuara në këtë nënpjesë.

21A14. Dëshmimi i aftësive

(a) Secila sipërmarrje që bën kërkesë për një certifikatë tip ose certifikatë tip të kufizuar dëshmon aftësinë e saj duke qenë në zotërim të miratimit të sipërmarrjes projektuese, të lëshuar nga Agjencia në përputhje me nënpjesën J.

(b) Duke u shmangur nga germa (a), si një procedurë alternative ndaj dëshmimit të aftësive, një kërkuar mund të kërkojë të bjerë dakord me Agjencinë për përdorimin e procedurave, që përcaktojnë praktikën e burimeve të caktuara dhe radhën e veprimeve të nevojshme për të qenë në përputhje me këtë pjesë, kur produkti është një nga të mëposhtmit:

1. një aeroplan shumë i lehtë ose avion i hapur me helikë, një planer ose një planer me energji, një balonë, një avion termik;
2. një aeroplan i vogël me të gjithë elementet e mëposhtëm:
 - (i) Motor me një piston, me aspirim natyral, me fuqinë maksimale të ngritjes jo më të madhe se 250 hp (kuaj fuqi)
 - (ii) Konfigurim konvencional
 - (iii) Material dhe strukturë konvencionale
 - (iv) Fluturimet sipas VFR, jashtë kushteve të ngritjes

- (v) Numri maksimal i vendeve është 4 duke përfshirë pilotin dhe masa maksimale për ngritje deri në 3000 libra ose 1361 kilogramë;
 - (vi) Kabinë e papresuar;
 - (vii) Pult komandimi jo elektrik;
 - (viii) Fluturime bazë akrobatike të kufizuara deri në +6/-3g; ose
3. një motor me piston; ose
 4. një motor ose helikë me certifikatë tip sipas kodit të zbatueshëm të aftësisë për të fluturuar për planer me energji; ose
 5. një helikë me lëkundje të fiksuar ose të ndryshueshme

21A.15 Kërkesa

- (a) Kërkesa për një certifikatë tip ose për një certifikatë tip të kufizuar bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Agjencia.
- (b) Kërkesa për një certifikatë tip për avion ose një certifikatë tip të kufizuar shoqërohet me një vizatim tredimensional të atij avioni dhe të dhëna paraprake bazë, duke përfshirë edhe karakteristikat e propozuara të funksionimit si dhe kufizimet.
- (c) Kërkesa për një certifikatë tip për një motor apo helikë shoqërohet nga një vizatim i vendosjes së përgjithshme, një përshkrim i karakteristikave të projektit, karakteristikat e funksionimit, dhe kufizimet e propozuara të funksionimit të motorit ose helikës.

21A.16A Kodet e aftësisë për të fluturuar

Agjencia, në përputhje me nenin 14 të Rregullores bazë, nxjerr kodet e aftësisë për të fluturuar si mjete standarde për të treguar përputhshmërinë e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve me kërkesat themelore të Shtojcës I të Rregullores bazë. Këto kode janë aq të hollësishme dhe të caktuara sa duhet për t'u treguar kërkesve kushtet sipas të cilave lëshohen certifikatat.

21A.16.B Kushte të posaçme

(a) Agjencia përcakton kushte të posaçme e të hollësishme teknike, të quajtura kushte të posaçme, për një produkt, në rast se kodi përkatës i aftësisë për të fluturuar nuk përmban standarde të mjaftueshme ose të përshtatshme për produktin për arsye se:

1. Produkti ka tipare të reja ose të pazakonta projektimi, në krahasim me praktikat e projektimit në të cilat është bazuar kodi i zbatueshëm i aftësisë për të fluturuar; ose
2. Produkti mendohet të përdoret për një qëllim jo konvencional;
3. Përvoja, në lidhje me produkte të tjera në shërbim ose me produkte të tjera që kanë karakteristika të ngjashme projektimi, ka treguar se mund të krijohen kushte të pasigurta.

(b) Kushtet e posaçme përmbajnë standarde të tilla sigurie, që Agjencia mendon se është e nevojshme të përcaktohet një nivel sigurie i barasvlefshëm me atë të përcaktuar në kodin e zbatueshëm të aftësisë për të fluturuar.

21A.17 Baza për certifikimin tip

(a) Baza për certifikimin tip që duhet bërë e ditur për lëshimin e një certifikate tip ose të një certifikate tip të kufizuar konsiston në:

1. Kodi i zbatueshëm i aftësisë për të fluturuar i përcaktuar nga Agjencia, që është në fuqi në datën e kërkesës për atë certifikatë, me përjashtim të rasteve kur:

(i) Agjencia e përcakton ndryshe; ose

(ii) Përputhshmëria me ndryshime të mëvonshme në fuqi zgjidhet nga kërkuesi ose kërkohet sipas germave (c) dhe (d).

2. Ndonjë kushti të posaçëm të përcaktuar në përputhje me 21A.16B germa (a).

(b) Kërkesa për certifikimin tip të avionëve të mëdhenj dhe avionëve të mëdhenj të hapur me helikë, është i vlefshëm për pesë vjet dhe kërkesa për ndonjë lloj tjetër certifikatë tip është i vlefshëm për tre vjet, me përjashtim të rasteve kur kërkuesi dëshmon në momentin e kërkesës se produkti i tij kërkon një kohë më të gjatë për t'u projektuar, zhvilluar dhe testuar, dhe Agjencia miraton një periudhë vlefshmërie më të gjatë.

(c) Në rast se një certifikatë tip nuk është lëshuar, ose është e qartë se nuk do të lëshohet brenda afateve kohore të përcaktuara sipas germës (b); kërkuesi mund të:

1. Bëjë një kërkesë të re për certifikatë tip dhe të përmbushë të gjitha kërkesat e germës (a) të zbatueshme për kërkesën fillestare; ose të

2. Bëjë kërkesë për një zgjatje të afatit të kërkesës origjinale dhe të përmbushë kodet e aftësisë për të fluturuar që ishin në fuqi në një datë që zgjidhet nga kërkuesi, por jo më herët se data pararendëse e datës së lëshimit të certifikatës tip, sipas afatit të përcaktuar në germën (b) për kërkesën fillestare.

(d) Nëse një kërkues zgjedh që të veprojë në përputhje me ndryshimet e kodeve të aftësisë për të fluturuar që janë në fuqi pasi bëhet kërkesa për certifikatën tip, ai duhet të veprojë në përputhje edhe me çdo ndryshim tjetër që Agjencia mendon se ka lidhje të drejtpërdrejtë.

21A.18 Përcaktimi i kërkesave të zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit dhe kushtet e certifikimit

(a) Kërkesat e zbatueshme për zhurmat për lëshimin e një certifikate tip të një avioni, përshkruhen sipas dispozitave të Kapitullit 1 të Shtojcës 16, Vëllimi I, Pjesa II e Konventës së Çikagos dhe:

1. për avionët subsonik me motor reaktiv, në Vëllimin I, Pjesa II, Kapitujt 2,3,4 sipas zbatimit;

2. për aeroplanë me helika, në Vëllimin I, Pjesa II, Kapitujt 3,4,5,6 dhe 10 sipas zbatimit;

3. për helikopterët, në Vëllimin I, Pjesa II, Kapitujt 8 dhe 11 sipas zbatimit; dhe

4. për avionët supersonik, në Vëllimin I, Pjesa II, Kapitulli 12, sipas zbatimit.

(b) Kërkesat e zbatueshme për lëshimin e gazrave për lëshimin e një certifikate tip për një avion ose motor janë përcaktuar në Shtojcën 16 të Konventës së Çikagos:

1. për parandalimin e humbjeve të qëllimshme të lëndës djegëse, në Vëllimin II, Pjesa II, Kapitulli 2;

2. për emetimin e motorëve reaktiv turbo dhe me ventilator turbo, të caktuar për forcë shtytëse vetëm në shpejtësitë supersonike, në vëllimin II, Pjesa III, Kapitulli 2; dhe

3. për emetimin e motorëve reaktiv turbo dhe me ventilator turbo, të caktuar për forcë shtytëse vetëm në shpejtësitë supersonike, në vëllimin II, Pjesa III, Kapitulli 3.

(c) Agjencia, në përputhje me nenin 14 të Rregullores bazë, nxjerr kushtet e certifikimit duke kërkuar mjete të pranueshme, për të dëshmuar përputhshmërinë me kriteret për zhurmën dhe lëshimin e gazrave të përcaktuara respektivisht në germa (a) dhe (b).

21A.19 Ndryshimet që kërkojnë një certifikatë tip të re

Çdo person fizik ose juridik që propozon ndryshimin e një produkti, bën kërkesë për një certifikatë tip të re, nëse Agjencia arrin në përfundimin se ndryshimi në projektim, fuqi, shtyrje, ose në masë është i një shkalle kaq të madhe, sa që kërkohet një verifikim i plotë për të parë nëse ka përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit tip.

21A.20 Përputhshmëria me bazën e certifikimit tip dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit

(a) Kërkuesi për një certifikatë tip ose certifikatë tip të kufizuar tregon përputhshmërinë e bazës së zbatueshme për certifikimin tip dhe kërkesave për mbrojtjen mjedisore, dhe i jep Agjencisë mjetet nëpërmjet të cilave kjo përputhshmëri është treguar.

(b) Kërkuesi deklaron se ka treguar përputhshmërinë me gjithë bazën për certifikimin tip dhe kërkesat për mbrojtjen mjedisore.

(c) Kur kërkuesi ka një miratim të përshtatshëm të një sipërmarrjeje projektuese, deklarata e germës (b) bëhet sipas dispozitave të nënpjesës J.

21A.21 Lëshimi i një certifikate tip

Kërkuesi ka të drejtën t'i lëshohet një certifikatë tip nga Agjencia pasi:

(a) ka dëshmuar aftësitë e tij në përputhje me 21A.14;

(b) ka paraqitur deklaratën e përmendur në 21A.20 germa (b); dhe

(c) është dëshmuar se:

1. Produkti që duhet certifikuar përmbush bazën e zbatueshme të bazës për certifikimin tip, si dhe kriteret e mbrojtjes mjedisore të përcaktuara në përputhje me 21A.17 dhe 21A.18;

2. Dispozitat e aftësisë për të fluturuar të cilat nuk përmbushen, kompensohen nga faktorë që sigurojnë një nivel të barasvlefshëm sigurie;

3. Asnjë tipar ose karakteristikë nuk e bën të pasigurtë për përdorimet, për të cilat kërkohet certifikim; dhe

4. Kërkuesi për certifikatë tip është shprehur qartë se është i përgatitur të përmbushë 21A.44.

(d) Në rastin e një certifikate tip për avion, për motorin ose helikën, ose të dyja këto, nëse janë të montuara në avion, të ketë një certifikatë tip të lëshuar ose përcaktuar në përputhje me këtë rregullore.

21A.23 Lëshimi i një certifikate tip të kufizuar

(a) Për një avion që nuk përmbush dispozitat e 21A.21 (c), kërkuesi ka të drejtën t'i lëshohet nga Agjencia një certifikatë tip e kufizuar pasi:

1. të ketë përmbushur bazën e përshtatshme për certifikimin tip të përcaktuar nga Agjencia, duke garantuar sigurinë e duhur në lidhje me qëllimin e përdorimit të avionit, si dhe të ketë përmbushur kriteret e zbatueshme të mbrojtjes mjedisore;

2. të ketë shprehur qartë se është i përgatitur të përmbushë 21A.44.

(b) Motori ose helika, ose të dyja, kur janë të montuar në avion:

1. Kanë një certifikatë tip që është lëshuar ose përcaktuar në përputhje me këtë rregullore; ose

2. Është treguar se janë në përputhje me kushtet e certifikimit, që nevojiten për të garantuar një fluturim të sigurtë të avionit.

21A.31 Projekti tip

(a) Projekti tip përbëhet nga:

1. Skicat dhe kushtet dhe një listë e atyre skicave dhe kushteve, që nevojiten për të përcaktuar konfigurimin dhe tiparet e projektit të produktit, që është dëshmuar se është në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit tip dhe me kriteret për mbrojtjen mjedisore;

2. Informacione mbi materialet e proceset, dhe mbi metodat e prodhimit e të montimit të produktit, të nevojshme për të garantuar përshtatshmërinë e produktit;

3. Një seksion për kufizimet e miratuara të aftësisë për të fluturuar, të udhëzimeve për aftësinë për të fluturuar, të vazhdueshme, sikurse përcaktohet nga kodi i zbatueshëm i aftësisë për të fluturuar; dhe

4. Çdo të dhënë tjetër të nevojshme, për të lejuar nëpërmjet krahasimit përcaktimin e aftësisë për të fluturuar, karakteristikat e zhurmës, humbjen e lëndës djegëse, dhe emetimet e shkarkimit (ku është e zbatueshme) të produkteve të mëvonshme të të njëjtit tip.

(b) Secili projekt tip identifikohet në mënyrën e përshtatshme.

21A.33 Hetimi dhe testet

(a) Kërkuesi kryen të gjitha kontrollet dhe provat që nevojiten, për të treguar përputhshmërinë me bazën e zbatueshme për certifikimin tip dhe kërkesat për mbrojtjen mjedisore.

(b) Para se të kryhet çdo provë e kërkuar në germën (a), kërkuesi duhet të ketë përcaktuar se:

1. Për modelin e testit:

(i) Materialet dhe proceset janë në përputhje me kushtet për projektin tip të propozuar;

(ii) Pjesët e produktit janë në përputhje me skicat në projektin tip të propozuar;

(iii) Procesi i prodhimit, konstruksionit dhe montimit janë në përputhje me të dhënat që përcaktohen në projektin tip të propozuar; dhe

2. Pajisjet e provës dhe të gjitha pajisjet matëse të përdorura për provën janë të përshtatshme për provën dhe janë të kalibruara si duhet.

(c) Kërkuesi lejon Agjencinë të kryejë çdo kontroll të nevojshëm për të kontrolluar përputhshmërinë me germën (b).

(d) Kërkuesi e lejon Agjencinë të shqyrtojë çdo raport dhe të kryejë çdo kontroll, si dhe të kryejë ose të jetë e pranishme gjatë gjithë provave si në fluturim ashtu edhe në tokë, që janë të nevojshme për të kontrolluar vlefshmërinë e deklaratës së përputhshmërisë të paraqitur nga kërkuesi në zbatim të 21A.20 germa (b), dhe për të përcaktuar se asnjë tipar ose karakteristikë nuk e bën produktin të pasigurt për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

(e) Për provat e kryera nga Agjencia ose për ato gjatë të cilave Agjencia është e pranishme sipas germës (d):

1. Kërkuesi i paraqet Agjencisë një deklaratë përputhshmërie me germën (b); dhe

2. Asnjë ndryshim në lidhje me provën, i cili mund të ndikojë në deklaratën e përputhshmërisë, nuk mund t'i bëhet një produkti, pjese ose pajisjeje, nga momenti kur tregohet përputhshmëria me germën (b) deri kur paraqitet pranë Agjencisë për provë.

21A.35 Provat e fluturimit

(a) Provat e fluturimit për të marrë certifikatë tip do të kryhen në bazë të kushteve të përcaktuara nga Agjencia për këto lloj provash me fluturime.

(b) Kërkuesi realizon të gjitha provat me fluturime që Agjencia konsideron të nevojshme:

1. Për të përcaktuar përputhshmërinë me bazën e zbatueshme për certifikimin tip dhe kërkesat për mbrojtjen mjedisore, dhe

2. Për të përcaktuar nëse ka garanci të mjaftueshme se avioni, pjesët dhe pajisjet e tij janë të besueshme dhe funksionojnë si duhet në rastet kur avionët duhen certifikuar sipas këtij seksioni, me përjashtim të rasteve kur bëhet fjalë për planerë dhe aeroplanë me masën maksimale të ngritjes deri në 2722 kilogramë.

(c) (E rezervuar)

(d) (E rezervuar)

(e) (E rezervuar)

(f) Provat e fluturimeve të përcaktuara në germën (b) pika 2 përfshijnë:

1. Për avionët që përfshijnë motorët me turbinë të një lloji që nuk është përdorur më parë në një avion që ka certifikatë tip, të paktën 300 orë pune me sasinë e plotë të motorëve që janë në përputhje me një certifikatë tip; dhe

2. Për të gjithë llojet e tjerë të avionëve, të paktën 150 orë pune.

21A.41 Certifikata tip

Si certifikata tip dhe certifikata tip e kufizuar konsiderohen se përfshijnë projektin tip, kufizimet e funksionimit, fletën e të dhënave të certifikatës tip për aftësinë për të fluturuar dhe emetimet e gazrave, bazën e zbatueshme të certifikimit tip dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore, me të cilat Agjencia regjistron përputhshmërinë dhe ndonjë

kusht tjetër, ose kufizimet e përcaktuara për produktin në kushtet e zbatueshme të certifikimit dhe në kërkesat për mbrojtjen mjedisore. Certifikata tip e avionit dhe certifikata tip e kufizuar, përveç kësaj, përfshijnë të dyja, fletën e të dhënave të certifikimit tip për zhurmën. Fleta e të dhënave për certifikimin tip të motorit përfshin të dhënat për përputhshmërinë e shkarkimit të gazrave.

21A.44 Detyrimet e mbajtësit

Secili mbajtës i certifikatës tip ose certifikatës tip të kufizuar:

(a) merr përsipër përgjegjësitë e përcaktuara në 21A.3, 21A.3B, 21A.4, 21A.55, 21A.57 dhe 21A.61; dhe për këtë qëllim vazhdon të përmbushë kërkesat për t'u konsideruar.

21A.47 Transferueshmëria

Transferimi i një certifikate tip ose i një certifikate tip të kufizuar mund të bëhet vetëm ndaj një personi fizik ose juridik, që është në gjendje të marrë përsipër përgjegjësitë sipas 21A.44, dhe për këtë qëllim, ka treguar aftësinë e tij për t'u kualifikuar sipas kritereve të 21A.14.

21A.51 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e vazhduar

(a) Certifikata tip dhe certifikata tip e kufizuar lëshohen për kohëzgjatje të pakufizuar. Ato mbeten të vlefshme nëse:

1. Mbajtësi vazhdon të jetë në përputhje me këtë pjesë; dhe
 2. Certifikata nuk dorëzohet ose shfuqizohet sipas procedurave administrative të përcaktuara nga Agjencia.
- (b) Me t'u dorëzuar ose shfuqizuar, certifikata tip dhe certifikata tip e kufizuar i kthehet Agjencisë.

21A.55 Mbajtja e të dhënave

Të gjitha informacionet e nevojshme të projektimit, skicat dhe raportet e provave të realizuara, ruhen nga mbajtësi i certifikatës tip ose i certifikatës tip të kufizuar, në dispozicion të Agjencisë, dhe do të mbahen në mënyrë që të jepet informacioni i nevojshëm, për të siguruar aftësinë e vazhdueshme për të fluturuar dhe përputhshmërinë me kërkesat e zbatueshme të produktit për mbrojtjen mjedisore.

21A.57 Manualet

Mbajtësi i një certifikate tip ose i një certifikate tip të kufizuar përgatit, mban dhe përditëson origjinalet e të gjitha manualeve që kërkohen prej bazës së zbatueshme të certifikimit tip dhe të kërkesave për mbrojtjen mjedisore për produktin, dhe t'i sigurojë kopje të tyre Agjencisë, me kërkesën e kësaj të fundit.

21A.61 Udhëzimet për aftësinë e vazhdueshme për të fluturuar

(a) Mbajtësi i një certifikate tip ose certifikate tip të kufizuar japin të paktën një set udhëzimesh për aftësinë e vazhdueshme për të fluturuar, duke përfshirë të dhëna përshkruese dhe udhëzime për realizimin, të përgatitura në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit tip, secilit prej zotëruesve të një ose më shumë avionëve, motorëve ose helikave me lëvrimin e tyre ose me lëshimin e certifikatës së parë të aftësisë për të fluturuar për avionin në fjalë, cilado ndodh më vonë, dhe që për pasojë i bën këto udhëzime të disponueshme sipas kërkesave ndaj çdo personi tjetër, i cili kërkohet të përmbushë ndonjë nga kushtet e atyre udhëzimeve. Disponueshmëria e ndonjë manuali ose pjesë të udhëzimeve për aftësinë e vazhdueshme për të fluturuar, që ka të bëjë me riparimin kapital ose

forma të tjera të mirëmbajtjes serioze, mund të vonohet, për derisa produkti të hyjë në shërbim, por ato do të jenë të disponueshme para se produkti të arrijë moshën e duhur ose ciklin/orët e fluturimit.

(b) Përveç kësaj, ndryshimet për aftësinë e vazhdueshme për të fluturuar i bëhen të ditura të gjithë operatorëve të njohur të produktit, si dhe u vihen në dispozicion, me kërkesën e tyre, secilit person, i cili duhet të zbatojë ndonjë prej atyre udhëzimeve. Një program që tregon se si shpërndahen ndryshimet e udhëzimeve për aftësinë e vazhdueshme për të fluturuar i dorëzohet Agjencisë.

(NËNPJESA C – E PAZBATUESHME)

NËNPJESA D – NDRYSHIME TË CERTIFIKATAVE TIP DHE TË CERTIFIKATAVE TIP TË KUFIZUARA

21A. 90 Qëllimi

Kjo nënpjesë përcakton procedurën për miratimin e ndryshimeve në projektin tip dhe certifikatave tip, dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e kërkuessve për, dhe të mbajtësve të atyre miratimeve. Në këtë nënpjesë, referencat ndaj certifikatave tip përfshijnë certifikatat tip dhe certifikatat tip të kufizuara.

21A.91 Klasifikimi i ndryshimeve në projektin tip

Ndryshimet në projektin tip klasifikohen si të vogla dhe si të mëdha. Një “ndryshim i vogël” konsiderohet një ndryshim që nuk ka ndonjë efekt të dukshëm në masë, ekuilibër, forcë strukturore, besueshmëri, karakteristika të operimit, zhurmë, humbje të lëndës djegëse, emetimin e shkarkimit, ose karakteristika të tjera që prekin aftësinë për fluturim të produktit. Pa paragjykuar 21A.19, të gjitha ndryshimet e tjera janë “ndryshime të mëdha” sipas kësaj nënpjesë. Ndryshimet e vogla dhe ato të mëdha miratohen në përputhje me 21A.95 ose 21A.97 sipas rastit dhe identifikohen në mënyrën e duhur.

21A. 92. Kualifikimi

(a) Vetëm mbajtësi i certifikatës mund të bëjë kërkesë për miratimin e një ndryshimi të madh në projektin tip sipas kësaj nënpjesë; të gjithë kërkuessit e tjerë për një ndryshim të madh në projektin tip bëjnë kërkesë në përputhje me nënpjesën E.

(b) Çdo person fizik ose juridik mund të bëjë kërkesë për një ndryshim të vogël të projektit tip sipas kësaj nënpjesë.

21A.93 Kërkesa

Kërkesa për miratimin e një ndryshimi të projektit tip bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Agjencia, dhe përfshin:

(a) Një përshkrim të ndryshimit që identifikon:

1. Të gjitha pjesët e projektit tip dhe manualet e miratuara që preken nga ndryshimi; dhe
2. Kushtet e certifikimit dhe kërkesat për mbrojtjen mjedisore me të cilat duhet të përputhet ndryshimi sipas 21A.101.

(b) Identifikimi i çdo rihetimi të nevojshëm për të treguar se produkti i ndryshuar është në përputhje me kushtet e zbatueshme të certifikimit dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore.

21A.95 Ndryshime të vogla

Ndryshimet e vogla të projektit tip klasifikohen dhe miratohen:

- (a) Nga Agjencia; ose
- (b) Nga një sipërmarrje e miratuar projektimi sipas një procedure për të cilën bihet dakord me Agjencinë.

21A.97 Ndryshimet e mëdha

(a) Një kërkues për miratimin e një ndryshimi të madh:

1. I paraqet Agjencisë të dhëna vërtetuese së bashku me të dhëna të tjera përshkruese të nevojshme për t'u përfshirë në projektin tip.
2. Tregon se produkti i ndryshuar përputhet me kushtet e zbatueshme të certifikimit dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore, sikurse përcaktohet në 21A.101;
3. Deklaron se ka treguar përputhjen me bazën e zbatueshme të certifikimit tip dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore, si dhe vë në dispozicion të Agjencisë bazën mbi të cilën është bërë ky deklaram; dhe
4. Kur kërkuesi ka miratimin e një sipërmarrjeje projektuese të përshtatshme, bën deklaratën e germës (a) pika 3 në përputhje me dispozitat e nënpjesës J;
5. Është në përputhje me 21A.33 dhe kur është e zbatueshme, me 21A.35

(b) Miratimi i një ndryshimi të madh në një projekt tip kufizohet për atë ose ato të dhëna të caktuara në projektin tip i cili është ndryshuar.

21A.101 Përcaktimi i kushteve të zbatueshme të certifikimit dhe i kërkesave për mbrojtjen mjedisore

(a) Një kërkues, për një ndryshim të certifikatës tip, dëshmon se produkti i ndryshuar është në përputhje me kodin e aftësisë për të fluturuar, që është i zbatueshëm për produktin e ndryshuar dhe që është në fuqi ditën e kërkesës për ndryshim, dhe me kërkesat për mbrojtjen mjedisore të përcaktuara në 21A.18.

(b) Duke u shmangur nga germa (a), një kërkues mund të tregojë se produkti i ndryshuar është në përputhje me një ndryshim të mëparshëm të kodit të aftësisë për të fluturuar, të përcaktuar në germën (a), dhe të kushteve të certifikimit, që sipas Agjencisë ka lidhje të drejtpërdrejtë. Sidoqoftë, kodi i aftësisë për të fluturuar i ndryshuar më parë mund të mos paraprijë kodin përkatës të aftësisë për të fluturuar që përfshihet me referencë në certifikatën tip. Kërkuesi mund të tregojë se ka përputhje me një ndryshim të mëparshëm të kodit të aftësisë për të fluturuar, për një nga të mëposhtmet:

1. Një ndryshim që sipas Agjencisë nuk është domethënës. Për të përcaktuar nëse një ndryshim i caktuar është domethënës, Agjencia merr në konsideratë ndryshimin në kontekst me gjithë ndryshimet e mëparshme të projektit tip si dhe gjithë rishikimet e bëra për kushtet e certifikimit, të përfshira në certifikatën tip të produktit. Ndryshimet që plotësojnë një nga kriteret e mëposhtme konsiderohen automatikisht si domethënës:

- (i) Të dhënat e përgjithshme ose parimet e konstruksionit nuk janë ruajtur.
- (ii) Supozimet e përdorura për certifikimin e produktit që do ndryshohet nuk mbeten të vlefshme.

2. Çdo fushë, sistem, pjesë ose pajisje që Agjencia konsideron se nuk preket nga ndryshimi.

3. Çdo fushë, sistem, pjesë ose pajisje që preket nga ndryshimi, për të cilin Agjencia konsideron se përputhja me kodin e aftësisë për të fluturuar që përshkruhet në germën (a), nuk do të kontribuonte materialisht në nivelin e sigurisë së produktit të ndryshuar ose nuk do të ishte praktike.

(c) Kërkuesit për ndryshim të një avioni (që nuk është avion i hapur me helikë) prej 2722 kg (6000 lbs.) ose peshë maksimale më të vogël, ose për një avion të hapur me helikë pa turbinë me peshë maksimale 1361 kg (3000 lbs.) ose peshë maksimale më të vogël, mund të tregojë se produkti i ndryshuar është në përputhje me bazën e certifikimit tip të përfshirë në certifikatën tip me referencë. Gjithësesi, nëse Agjencia përfundon se ndryshimi është domethënës në një fushë, Agjencia mund të përcaktojë përputhshmërinë me një ndryshim të bazës së certifikimit tip të përfshirë në certifikatën tip me referencë, i cili është në fuqi në datën e kërkesës dhe me ndonjë kusht certifikimi, që sipas Agjencisë ka lidhje të drejtpërdrejtë, përveçse në rast se Agjencia përfundon se përputhshmëria me atë ndryshim ose përcaktim certifikimi, nuk do të kontribuonte materialisht në nivelin e sigurisë së produktit të ndryshuar ose nuk do të ishte praktike.

(d) Nëse Agjencia përfundon se kodi i aftësisë për të fluturuar që është në fuqi ditën e kërkesës për ndryshim, nuk ofron standarde të përshtatshme, në lidhje me ndryshimin e propozuar, kërkuesi do të zbatojë edhe kushtet e posaçme edhe ndryshime të atyre kushteve, të parashikuara në 21A.16B, për të dhënë një nivel sigurie të njëjtë me atë të përcaktuar me kodin e aftësisë për të fluturuar, që është në fuqi datën e kërkesës për ndryshimin.

(e) Kërkesa për një ndryshim të një certifikate tip për aeroplanë të mëdhenj dhe avionë të hapur me helikë, të mëdhenj, është e efektshme për pesë vjet, dhe kërkesa për ndryshim të ndonjë tjetër certifikate tip është e efektshme për tre vjet. Në një rast kur ndryshimi nuk është miratuar, ose kur është e qartë se nuk do të miratohet në afatin kohor të përcaktuar në këtë germë, kërkuesi mund:

1. Të paraqesë një kërkesë të re për ndryshim të certifikatës tip dhe të përmbushë dispozitat e germës (a) të zbatueshme për ndryshim; ose
2. Të paraqesë kërkesë për shtyrje të kërkesës fillestare dhe të përmbushë dispozitat e germës (a) për një datë të efektshme kërkesë, e cila zgjidhet nga kërkuesi, të jetë jo më parë se data pararendëse ndaj datës së miratimit të ndryshimit në periudhën kohore të përcaktuar sipas kësaj germe për kërkesën fillestare për ndryshim.

21A.103 Dhënia e miratimit

(a) Kërkuesi ka të drejtën të bëjë ndryshime të mëdha për një projekt të miratuar nga Agjencia pasi:

1. të paraqesë deklaratën e përmendur në 21A.97 germa (a) pika 3; dhe
2. Tregohet se:

- (i) Produkti i ndryshuar përmbush kushtet e zbatueshme të certifikimit dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore, sikurse përcaktohet në 21A.101;
 - (ii) Mospërputhja e çdo dispozite të aftësisë për të fluturuar kompensohet nëpërmjet faktorëve që sigurojnë një nivel të njëjtë sigurie; dhe
 - (iii) Asnjë tipar ose karakteristikë nuk e bën produktin të pasigurtë për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.
- (b) Një ndryshim i vogël miratohet vetëm në përputhje me 21A.95, nëse tregohet se produkti i ndryshuar përmbush kushtet e zbatueshme të certifikimit, sikurse përcaktohet në 21A.101.

21A.105 Mbajtja e të dhënave

Për secilin ndryshim, informacionet që kanë lidhje me projektimin, skicimin dhe relacionet e provave, duke përfshirë të dhënat e inspektiveve për produktet e ndryshuara që testohen, mbahen nga kërkuesi në dispozicion të Agjencisë dhe ruhen në mënyrë që të jepet informacioni i nevojshëm, për të siguruar aftësinë e vazhdueshme për të fluturuar, dhe në përputhje me kërkesat e zbatueshme të mbrojtjes mjedisore të produktit të ndryshuar.

21A.107 Udhëzime për aftësinë e vazhdueshme për të fluturuar

(a) Mbajtësi i një miratimi për një ndryshim të vogël të projektit tip do të japë të paktën një set me ndryshimet përkatëse, nëse ka, për udhëzimet për aftësinë e vazhdueshme për të fluturuar të produktit, në të cilin do montohet ndryshimi i vogël, të përgatitura në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit tip, për secilin zotërues të një ose më shumë motorë avionësh, ose helika që pësojnë ndryshim, me lëvrimin e tyre ose me nxjerrjen e certifikatës së parë për aftësinë për të fluturuar për avionin e prekur, cilado të ndodhë më vonë, dhe ato ndryshime t’ia vëre në dispozicion, sipas kërkesës, edhe çdo personi tjetër i cili duhet të veprojë në përputhje me kushtet e atyre udhëzimeve.

(b) Përveç kësaj, modifikime të atyre ndryshimeve të udhëzimeve për aftësinë e vazhdueshme për të fluturuar do t’u vihen në dispozicion të gjithë operatorëve të produkteve, duke përfshirë edhe ndryshimet e vogla, dhe sipas kërkesës do t’u vihen në dispozicion çdo personi që duhet të veprojë në përputhje me ndonjë nga ato udhëzime.

21A.109 Detyrimet dhe shënimi MEP

Mbajtësi i një miratimi për ndryshim të projektit tip do të:

(a) Marrë përsipër detyrimet e përcaktuara në 21A.4, 21A.105 dhe 21A.107; dhe

(b) përcaktojë shënimin, duke përfshirë edhe germat MEP (quajtur më poshtë “Miratimi European i Pjesës”), në përputhje me 21A.804 germa (a).

NËNPJESA E - CERTIFIKATË TIP SHITESË

21A.111 Qëllimi

Kjo nënpjesë përcakton procedurën për miratimin e ndryshimeve të mëdha të projektit tip sipas procedurave për certifikatë tip shtesë, dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e kërkuesve për dhe të mbajtësve të atyre certifikatave.

21A.112 E drejta për t’u përzgjedhur

Çdo person fizik ose juridik (“sipërmarrje”) që ka dëshmuar se, ose është duke treguar aftësinë e tij sipas 21A.112B, ka të drejtën të bëjë kërkesë për një certifikatë tip shtesë sipas kushteve të përcaktuara në këtë nënpjesë.

21A.112B Dëshmimi i aftësisë

(a) Çdo sipërmarrje që bën kërkesë për një certifikatë tip shtesë, dëshmon aftësitë e saj duke pasur një miratim si sipërmarrje projektuese, të lëshuar nga Agjencia në përputhje me nënpjesën J.

(b) Duke u shmangur nga germa (a), si një procedurë alternative për të dëshmuar aftësinë e tij, një kërkues mund të kërkojë miratimin e Agjencisë për të përdorur procedura që përcaktojnë praktikën e caktuara të projektimit, burimet dhe radhën e veprimtarive, të nevojshme për të qenë në përputhje me këtë nënpjesë.

21A.113 Kërkesa për një certifikatë tip shtesë

(a) Kërkesa për certifikatën tip shtesë bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Agjencia.

(b) Kërkesa për certifikatën tip shtesë përfshin përshkrimet dhe identifikimet e kërkuara në 21A.93. Përveç kësaj, kërkesa duhet të tregojë se informacioni në të cilin bazohet identifikimi i kërkuar është i përshtatshëm ose nga burimet e kërkuesit ose përmes një marrëveshjeje me mbajtësin e certifikatës tip.

21A.114 Paraqitja e përputhshmërisë

Çdo kërkues për një certifikatë tip shtesë duhet të respektojë 21A.97.

21A.115 Lëshimi i një certifikate tip shtesë

Kërkuesi ka të drejtën t'i lëshohet një certifikatë tip shtesë nga Agjencia pasi:

- (a) të zbatojë 21A.103 germa (a);
- (b) të vërtetojë aftësinë e tij në përputhje me 21A.112B;
- (c) kur, sipas 21A.113 germa (b), kërkuesi ka bërë një marrëveshje me mbajtësin e certifikatës tip,
 1. Mbajtësi i certifikatës tip e ka informuar se nuk ka kundërshtime teknike ndaj informacionit të paraqitur sipas 21A.93; dhe
 2. Mbajtësi i certifikatës tip ka rënë dakord të bashkëpunojë me mbajtësin e certifikatës tip shtesë për të siguruar përmbushjen e gjithë detyrimeve për aftësinë e vazhdueshme për të fluturuar të produktit të ndryshuar duke respektuar 21A.44 dhe 21A.118A.

21A.116 Transferueshmëria

Certifikata tip shtesë i transferohet vetëm një personi fizik apo juridik që është në gjendje të marrë përsipër detyrimet e 21A.118, dhe për këtë qëllim ka vërtetuar aftësinë e tij për t'u kualifikuar sipas kritereve të 21A.112B.

21A.117 Ndryshime ndaj asaj pjese të një produkti që mbulohet nga certifikata tip shtesë

- (a) Ndryshime të vogla të asaj pjese të produktit që mbulohet nga certifikata tip shtesë klasifikohen dhe miratohen në përputhje me nënpjesën D.
- (b) Çdo ndryshim i madh i asaj pjese të produktit që mbulohet nga certifikata tip shtesë miratohet si një certifikatë tip shtesë në përputhje me këtë nënpjesë.
- (c) Duke u shmangur nga germa (b), ndryshimet e mëdha të një pjese të produktit që mbulohet nga certifikata tip shtesë që paraqitet nga mbajtësi i certifikatës tip, mund të miratohet si një ndryshim i certifikatës tip shtesë ekzistuese.

21A.118A Detyrimet dhe shënimi MEP

Çdo mbajtës i një certifikate tip:

- (a) Merr përsipër përgjegjësitë:
 - 1) e përcaktuara në 21A.3, 21A.3B, 21A.4, 21A.105, 21A.119 dhe 21A.120;
 - 2) të nënkuptuara në bashkëpunimin me mbajtësin e certifikatës tip sipas 21A.115 germa (c) pika 2; dhe për këtë qëllim të vazhdojë të përmbushë kriteret e 21A.112B
- (b) Përcaktojë shënimin, duke përfshirë gerrat MEP, në përputhje me 21A.804 germa (a).

21A.118B Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e vazhdueshme

- (a) Certifikata tip shtesë lëshohet për një kohëzgjatje të pacaktuar. Ajo mbetet e vlefshme nëse:
 1. mbajtësi vazhdon të veprojë në përputhje me këtë pjesë; dhe
 2. certifikata nuk dorëzohet ose nuk shfuqizohet sipas procedurave të zbatueshme administrative të përcaktuara nga Agjencia.
- (b) Me t'u dorëzuar ose shfuqizuar, certifikata tip shtesë i kthehet Agjencisë.

21A.119 Manualet

Mbajtësi i një certifikate tip shtesë duhet të përgatitë, mbajë dhe përditësojë dokumentin fillestar e ndryshimeve të manualeve që kërkohen nga baza e certifikimit tip dhe kërkesat për mbrojtjen mjedisore për këtë produkt, të nevojshme për të mbuluar ndryshimet e realizuara sipas certifikatës tip shtesë, dhe me kërkesën e Agjencisë t'i japë asaj këto manuale.

21A.120 Udhëzime për aftësinë e vazhdueshme për të fluturuar

(a) Mbajtësi i certifikatës tip shtesë për një avion, motor ose helikë, do t'i japë të paktën një set të ndryshimeve përkatëse të udhëzimeve për aftësinë e vazhdueshme për të fluturuar, të përgatitura në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit tip, secilit prej zotëruesve të njohur të një ose më shumë avionëve, motorëve ose helikave që kanë tiparet e certifikatës tip shtesë, me lëvrimin e tyre ose me lëshimin e certifikatës së parë të aftësisë për të fluturuar, avionin e prekur, cilado të ndodhë më vonë, dhe pastaj, nëse kërkohet, t'u vërë në dispozicion ndryshimet në ato udhëzime edhe personave të tjerë që duhet të përmbushin ndonjë nga kushtet e atyre udhëzimeve. Disponueshmëria e ndonjë manuali ose e ndonjë pjese të ndryshimeve të udhëzimeve për aftësinë e vazhdueshme për të fluturuar, që ka të bëjë më riparimin ose me mirëmbajtje të rëndësishme, mund të shtyhet derisa produkti të ketë hyrë në shërbim, por duhet të jetë gati para se produkti të arrijë moshën e duhur ose ciklin e orëve të fluturimit.

(b) Përveç kësaj, ndryshime të këtyre modifikimeve të udhëzimeve për aftësinë e vazhdueshme për të fluturuar do t'u vihen në dispozicion të gjithë operatorëve të njohur të një produkti që përfshin certifikatën tip shtesë, dhe nëse kërkohet do t'i vihet në dispozicion çdokujt që duhet të veprojnë në përputhje me ato udhëzime. Agjencisë i dorëzohet një program që tregon sesi shpërndahen ndryshimet e udhëzimeve për aftësinë e vazhdueshme për të fluturuar.

NËNPJESA F – PRODHIMI PA PASUR LEJEN PËR SIPËRMARRJE PRODHUESE

21A.121 Qëllimi

(a) Kjo nënpjesë përcakton procedurën për të treguar përputhshmërinë me kushtet e zbatueshme të projektit të një produkti, pjese ose pajisjeje, që do të prodhohet pa pasur leje për sipërmarrje prodhuese sipas nënpjesës G.

(b) Kjo nënpjesë përcakton rregullat mbi detyrimet e prodhuesit të një produkti, pjese ose pajisjeje që prodhohet sipas kësaj nënpjesë.

21A.122 E drejta për t'u përzgjedhur

Çdo person fizik ose juridik mund të bëjë kërkesë për të treguar përputhshmërinë e produkteve të veçanta, pjesëve ose pajisjeve sipas kësaj nënpjesë, nëse:

(a) zotëron ose ka bërë kërkesë për të marrë një miratim që mbulon projektin e produktit, pjesës ose pajisjes, ose

(b) ka siguruar koordinim të kënaqshëm ndërmjet prodhimit dhe projektimit, përmes një marrëveshjeje të përshtatshme me kërkuesin për, ose zotëruesin e një projekti të tillë.

21A.124 Kërkesa

(a) Secila kërkesë për një marrëveshje, për të treguar përputhshmërinë e produkteve të veçanta, pjesëve ose pajisjeve sipas kësaj nënpjesë, bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga autoriteti kompetent.

(b) Kjo kërkesë përmban:

1. prova që tregojnë, aty ku është e zbatueshme, se:

(i) dhënia e lejes për një sipërmarrje prodhuese sipas nënpjesës G është e papërshtatshme; ose

(ii) certifikimi ose miratimi i një produkti, pjese ose pajisjeje sipas kësaj nënpjesë nevojitet në varësi të lëshimit të miratimit për sipërmarrjen prodhuese sipas nënpjesës G.

2. Një përmbledhje të informacionit të kërkuar nga 21A.125 germa (b).

21A.125 Lëshimi i letërmarrëveshjes

Kërkuesi ka të drejtën t'i lëshohet një letërmarrëveshje nga autoriteti kompetent, ku bihet dakord se është treguar përputhshmëri e produkteve të veçanta, pjesëve dhe pajisjeve sipas kësaj nënpyese, pasi:

(a) të jetë përcaktuar një sistem për kontrollin e prodhimit, që siguron se secili produkt, pjesë apo pajisje është në përputhje me kushtet e zbatueshme të sistemit dhe është në gjendje pune pa cenuar sigurinë.

(b) të jetë sjellë një manual që përmban:

1. përshkrim të sistemit të kontrollit të prodhimit sikurse kërkohet në germa (a),

2. përshkrim të mjeteve për të bërë përcaktimet në sistemin e kontrollit të prodhimit, a

3. përshkrim të provave të 21A.127 dhe 21A. 128, dhe të emrave të personave të autorizuar për qëllimet e 21A.130 germa (a).

(c) të jetë treguar se është në gjendje të japë asistencë në përputhje me 21A.3 dhe 21A.129 germa (d).

21A.125B Përfundime

(a) Kur gjenden prova objektive, që tregojnë se mbajtësi i një letërmarrëveshjeje sipas kërkesave të zbatueshme të kësaj pjese, përfundimet klasifikohen si më poshtë:

1. Konstatimet të nivelit të parë janë çdo mospërputhje me këtë pjesë, që mund të çojë në mospërputhje të pakontrolluara me kushtet e zbatueshme të projektit, të cilat mund të prekin sigurinë e avionit.

2. Konstatime të nivelit të dytë janë çdo mospërputhje me këtë pjesë që nuk klasifikohet si niveli i parë.

(b) Konstatime të nivelit të tretë janë çdo element ku, nëpërmjet provave objektive, është identifikuar se ka probleme që mund të çojnë në mospërputhje sipas germës (a).

(c) Pasi merret njoftimi për konstatimet sipas 21B.143:

1. Në rast se arrihen konstatime të nivelit të parë, mbajtësi i letërmarrëveshjes dëshmon veprime korrigjuese në përputhje me kërkesat e autoritetit kompetent brenda një periudhe prej jo më shumë se 21 ditë pune, pas marrjes së konfirmimit të konstatimeve;

2. Në rast se arrihen konstatime të nivelit të dytë, periudha e veprimeve korrigjuese, e dhënë nga autoriteti kompetent, do jetë e përshtatshme me natyrën e konstatimeve, por në çdo rast, fillimisht nuk do t'i kalojë gjashtë muaj. Në disa rrethana dhe në varësi të konstatimeve, autoriteti kompetent mund ta zgjasë periudhën gjashtë mujore në një plan të kënaqshëm veprimi të masave korrigjuese, për të cilin bihet dakord nga autoriteti kompetent.

3. Konstatimet e nivelit të tretë nuk kërkojnë që të ndërmerren veprime të menjëhershme nga mbajtësi i letërmarrëveshjes.

(d) në rast se arrihen konstatime të nivelit të dytë, letërmarrëveshja mund t'i nënshtrohet një kufizimi të pjesshëm ose të plotë pezullimi dhe shfuqizimi sipas 21B.145. Mbajtësi i letërsë marrëveshjes konfirmon në kohë marrjen e njoftimit të kufizimit, pezullimit ose të shfuqizimit të letërmarrëveshjes.

21A.125C Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e vazhdueshme

(a) Letërmarrëveshja jepet për një kohëzgjatje të kufizuar prej jo më shumë se një viti. Ajo mbetet e vlefshme, përveçse kur:

1. Mbajtësi i letërmarrëveshjes nuk tregon përputhshmërinë me kërkesat e zbatueshme për këtë nënpjesë; ose
 2. Ka prova se prodhuesi nuk mund të ketë kontroll të kënaqshëm gjatë prodhimit të produkteve, pjesëve ose pajisjeve, sipas marrëveshjes; ose
 3. Prodhuesi nuk i përmbush më kërkesat e parashtruara në 21A.122; ose
 4. Letërmarrëveshja është dorëzuar, shfuqizuar në përputhje me 21B.145 ose i ka mbaruar afati.
- (b) Me t'u dorëzuar, anuluar ose me të mbaruar afati, letërmarrëveshja i kthehet autoritetit kompetent.

21A.126 Sistemi i inspektimit të prodhimit

- (a) Sistemi i inspektimit të prodhimit, që kërkohet në 21A.125, do të jetë një mjet për të përcaktuar se:
1. Materialet hyrëse dhe ato që blihen ose pjesët e nënkontraktuara, që përdoren në produktin e përfunduar, janë sikurse përcaktohet në kushtet e zbatueshme të projektit.
 2. Materialet hyrëse dhe ato që blihen ose pjesët e nënkontraktuara, identifikohen ashtu si duhet.
 3. Proceset, teknikat e prodhimit dhe metodat e montimit që ndikojnë në cilësinë dhe sigurinë e produktit të përfunduar realizohen në përputhje me kushtet e pranuar nga autoriteti kompetent.
 4. Ndryshimet e projektit, duke përfshirë zëvendësime të materialeve, janë miratuar sipas nënpjesës D ose E dhe kontrollohen para se të përfshihen në produktin e përfunduar.
- (b) Sistemi i inspektimit të prodhimit që kërkohet nga 21A.125 germa (a) do të jetë i tillë që të sigurojë se:
1. Pjesët në proces inspektohen nëse përputhen me të dhënat e zbatueshme të projektit në pikat e prodhimit ku mund të bëhen përcaktime të sakta.
 2. Materialet që mund të dëmtohen ose prishen mbahen dhe mbrohen në mënyrë të përshtatshme.
 3. Skicat e projekteve janë të gatshme për personelin prodhues dhe inspektues dhe përdoren kur është e nevojshme.
 4. Materialet dhe pjesët e papranuara ndahen dhe identifikohen në mënyrë që të parandalohet montimi i tyre në produktin e përfunduar.
 5. Materialet dhe pjesët që ndalohen, pasi nuk përputhen me të dhënat ose kushtet e projektit, dhe që duhet të merren në konsideratë për montim në produktin e përfunduar, i nënshtrohen një rishikimi të miratuar të procedurës inxhinierike dhe prodhuese. Ato materiale dhe pjesë që sipas kësaj procedure përcaktohet se janë të tilla, që ndaj tyre të mund të kryhen shërbime, identifikohen në mënyrën e duhur dhe riinspektohen, nëse është e nevojshme, që të kryhen punimet edhe një herë ose kur nevojiten riparime. Materialet dhe pjesët e papranuara nga kjo procedurë shënohen dhe eliminohen për të siguruar se nuk do të përfshihen në produktin përfundimtar.
 6. Të dhënat që prodhohen nga sistemi i inspektimit ruhen, identifikohen me produktin e përfunduar ose pjesën, kur është e praktikueshme, në mënyrë që të jepet informacioni i nevojshëm për të siguruar aftësinë e vazhdueshme të fluturimit për produktin.

21A.127 Testimet: avioni

(a) Secili prodhues i një avioni, të prodhuar sipas kësaj nën pjese, përcakton një procedurë të miratuar të testimit tokësor dhe ajror, dhe formularët përkatës për çdo element, dhe në përputhje me këta formularë, teston për çdo avion të prodhuar, në mënyrë që të përcaktohen aspektet përkatëse të përputhshmërisë me 21A. 125 germa (a).

(b) Çdo procedurë testimi e prodhimit përfshin të paktën:

1. Kontroll të cilësisë së përpunimit;
2. Kontroll për rendimentin e fluturimit (duke përdorur instrumente normale të avionëve);
3. Kontroll për funksionimin e duhur të gjithë pajisjeve dhe sistemeve të avionit;
4. Përcaktimi se të gjithë instrumentat shënohen ashtu si duhet dhe se të gjitha afishet dhe manuallet e kërkuara të fluturimit montohen pas provave të fluturimit;
5. Kontroll të karakteristikave operacionale të avionit në tokë;
6. Kontroll të ndonjë elementi tjetër që ka të bëjë me avionin që po testohet.

21A.128 Testimet: motorët dhe helikat

Çdo prodhues motorësh, helikash, të prodhuara sipas kësaj nën pjese, do të bëjë teste të pranueshme funksionale, sikurse përcaktohet në dokumentacionin e mbajtësit të certifikatës tip, për çdo motor ose helikë me lëkundje, për të përcaktuar nëse vepron si duhet në të gjitha operacionet për të cilat e ka certifikatën tip, për të verifikuar aspektet përkatëse të përputhshmërisë me 21A. 125 germa (a).

21A.129 Detyrimet e prodhuesit

Secili prodhues i një produkti, pjesë ose pajisjeje që prodhohet sipas kësaj nën pjese:

(a) Vë në dispozicion të autoritetit kompetent për inspektim çdo produkt, pjesë ose pajisje.

(b) Mban në vendin e prodhimit kushtet teknike dhe skicat e nevojshme për të përcaktuar nëse produkti është në përputhje me kushtet e projektit.

(c) Mban një sistem të inspektimit të prodhimit që siguron se çdo produkt është në përputhje me kushtet e zbatueshme të projektit dhe është në gjendje të operojë në mënyrë të sigurtë.

(d) Jep asistencë për mbajtësit e certifikatës tip, certifikatës tip të kufizuar ose miratimit të projektit kur ka të bëjë me veprime të aftësisë së vazhdueshme për të fluturuar që kanë lidhje me produktet, pjesët dhe pajisjet që janë prodhuar.

(e) Vendos dhe mban një sistem të ngjarjeve të brendshme për të mirën e sigurisë, për të mundësuar mbledhjen dhe vlerësimin e raporteve të ngjarjeve, në mënyrë që të identifikohen prirjet negative dhe të zgjidhin mangësitë, si dhe të shkëpusë ngjarjet e raportueshme. Ky sistem përfshin vlerësimin e informacionit të nevojshëm në lidhje me ngjarjet dhe përhapjen e informacionit që ka të bëjë me të.

(f) 1. I raporton mbajtësit të certifikatës tip ose të miratimit të projektit, të gjitha rastet kur produktet, pjesët ose pajisjet aeronautike janë hedhur në treg nga prodhuesi, dhe më pas është identifikuar se ato devijojnë nga të dhënat e zbatueshme të projektit dhe heton me mbajtësin e certifikatës tip ose të miratimit të projektit për të identifikuar ato devijime të cilat mund të çojnë në një gjendje të pasigurtë.

2. I raporton Agjencisë dhe autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar devijimet, të cilat mund të çojnë në një gjendje të pasigurtë të identifikuar sipas pikës 1. Raporte të tilla bëhen në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Agjencia sipas 21A.3 germa (b) pika 2 ose të pranuar nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar.

3. Kur prodhuesi vepron edhe si furnizues për një sipërmarrje tjetër prodhuese, i raporton edhe asaj sipërmarrjeje të gjitha rastet kur i ka kaluar asaj sipërmarrjeje produkte, pjesë ose pajisje, për të cilat ka identifikuar më pas se ka devijime të mundshme nga të dhënat e zbatueshme të projektit.

21A.130 Deklarata e përputhshmërisë

(a) Secili prodhues i një produkti, pjesë ose pajisjeje të prodhuar sipas kësaj nën pjese bën një deklaratë përputhshmërie, një formular EASA 52 për avion të përfunduar ose formular EASA 1 për produkte, pjesë apo

pajisje të tjera (shih shtojcën). Kjo deklaratë nënshkruhet nga personi i autorizuar i cili ka një pozicion me përgjegjësi në sipërmarrjen prodhuese.

(b) Deklarata e përputhshmërisë përfshin:

1. Për çdo produkt, pjesë ose pajisje një deklaratë se produkti, pjesa ose pajisja është në përputhje me të dhënat e miratuara të projektit dhe është në gjendje të përdoret në mënyrë të sigurtë.

2. Për çdo avion, një deklaratë se avioni është kontrolluar në tokë dhe ajër në përputhje me 21A.127 germa (a); dhe

3. Për çdo motor, ose helikë me lëkundje të ndryshueshme, një deklaratë se motori ose helika i është nënshtruar një testi përfundimtar funksionaliteti nga ana e prodhuesit, në përputhje me 21A.128, dhe kur bëhet fjalë për motor është bërë edhe një përcaktim në përputhje me të dhënat e dorëzuara nga mbajtësi i certifikatës tip të motorit, se çdo motor i përfunduar është në përputhje me kërkesat e zbatueshme për emetimin e gazrave në datën e prodhimit të motorit.

(c) Secili prodhues i një produkti, pjese ose pajisjeje të tillë sapo:

1. Të bëhet transferimi fillestar i pronësisë së një produkti, pjese ose pajisjeje të tillë; ose

2. të bëhet kërkesa për dhënien fillestare të një certifikate të aftësisë për të fluturuar të avionit; ose

3. të bëhet kërkesa për dhënien fillestare të një dokumenti për aftësinë për të fluturuar për një motor, helikë, pjesë ose pajisje,

paraqet një deklaratë aktuale të përputhshmërisë për vleftësim nga autoriteti kompetent.

(d) Autoriteti kompetent vlerëson duke kundërfirmosur deklaratën e përputhshmërisë, nëse pas një inspektimi përfundon se produkti, pjesa ose pajisja është në përputhje me të dhënat e zbatueshme të projektit dhe është në gjendje për t'u përdorur në mënyrë të sigurtë.

NËNPJESA G – MIRATIMI I SIPËRMARRJES PRODHUESE

21A.131 Qëllimi

Kjo nënpjesë përcakton:

(a) Procedurën për dhënien e miratimit të sipërmarrjes prodhuese duke treguar përputhshmërinë e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve me të dhënat e zbatueshme të projektimit.

(b) Rregullat në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e kërkuësve për, dhe mbajtësve të, këtyre miratimeve.

21A.133 E drejta për t'u përzgjedhur

Çdo person fizik ose juridik ("sipërmarrje") ka të drejtën të bëjë kërkesë për një miratim sipas kësaj nënpjesë. Kërkuësi do të:

(a) argumentojë se, për një sferë të caktuar pune, është e nevojshme një leje sipas kësaj nënpjesë për të treguar se ka përputhshmëri me një projekt të caktuar; dhe

(b) të zotërojë ose të ketë bërë kërkesë për një miratim të atij projekti të caktuar; ose

(c) të ketë siguruar përmes një marrëveshjeje të përshtatshme me kërkuësin për ose me mbajtësin e një lejeje për atë projekt të caktuar, koordinim të kënaqshëm ndërmjet prodhimit dhe projektimit.

21A.134 Kërkesa

Çdo procedurë për një sipërmarrje prodhuese bëhet pranë autoritetit kompetent në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga ai autoritet, dhe përfshin një përmbledhje të informacionit të kërkuar nga 21A.143 dhe kriteret e miratimit për t'u lëshuar sipas 21A.151.

21A.135 Lëshimi i miratimit për sipërmarrjen prodhuese

Sipërmarrja ka të drejtën t'i jepet leje për një sipërmarrje prodhuese nga autoriteti kompetent kur tregon se përmbush kërkesat e zbatueshme sipas kësaj nënpjesë.

21A.139 Sistemi i cilësisë

(a) Sipërmarrja prodhuese vërteton se ka vënë në punë dhe është në gjendje të ruajë një sistem cilësie. Sistemi i cilësisë dokumentohet. Ky sistem cilësie është i tillë që t'i mundësojë sipërmarrjes që të sigurojë se çdo produkt, pjesë ose pajisje e prodhuar nga sipërmarrje ose nga partnerët e saj, ose të siguruar nga ose të nënkontraktuara ndaj palëve të jashtme, është në përputhje me të dhënat e zbatueshme të projektit dhe është në gjendje për përdorim të sigurtë, dhe kështu ushtron privilegjet e përcaktuara në 21A.163.

(b) Sistemi i cilësisë përmban:

1. Sikurse është e zbatueshme brenda fushës së miratimit, procedura kontrolli për:

(i) Lëshimin, miratimin ose ndryshimin e dokumenteve

(ii) Revizionin dhe kontrollin e shitësit dhe nënkontraktuesit.

(iii) Verifikimin se pjesët, materialet dhe pajisjet që vijnë, duke përfshirë edhe artikuj që janë të rinj ose të përdorur nga blerësit e produkteve, janë sikurse përcaktohet në të dhënat e zbatueshme të projektit.

(iv) Identifikimin dhe ndjekjen.

(v) Proceset e prodhimit.

(vi) Inspektimi dhe provat duke përfshirë prova fluturimi të prodhimit.

(vii) Kalibrimi i makinerive, veglave dhe pajisjeve të testimit.

(viii) Kontroll mospërputhës i objektit.

(ix) Koordinim për aftësinë për të fluturuar me kërkuesin për ose mbajtësin e miratimit të projektit.

(x) Plotësimi dhe mbajtja e të dhënave.

(xi) Kompetenca dhe kualifikimet e personelit.

(xii) Lëshimi i dokumenteve të aftësisë për të fluturuar.

(xiii) Përpunimi, ruajtja dhe paketimi.

(xiv) Revizione të cilësisë së brendshme që rezultojnë nga veprimet korrigjuese.

(xv) Puna brenda kushteve të miratimit kur kryhet në vende të tjera të ndryshme nga ato të miratuara.

(xvi) Puna e kryer pas përfundimit të produktit por para lëvrimin të tij për ta mbajtur avionin në gjendje për përdorim të sigurtë.

Procedurat e kontrollit duhet të përfshijnë dispozita të caktuara për pjesët kritike.

2. Një funksion i pavarur që siguron cilësinë për të monitoruar përputhshmërinë me dhe përshtatshmërinë e procedurave të dokumentuara të sistemit të cilësisë. Ky monitorim përfshin një sistem reagimi ndaj personit ose grupit të personave të përmendur në 21A.145 germa (c) pika 1 për të siguruar, kur nevojiten, veprime korrigjuese.

21A.143 Ekspozeja

(a) Sipërmarrja i paraqet autoritetit kompetent një ekspoze të sipërmarrjes prodhuese duke dhënë informacionin e mëposhtëm:

1. Një deklaratë e nënshkruar nga menaxheri përgjegjës, e cila konfirmon se gjithmonë do të ketë përputhshmëri me ekspozenë e sipërmarrjes prodhuese dhe me ndonjë manual që ka të bëjë me të, dhe që përcakton përputhshmërinë e miratuar të sipërmarrjes me këtë nënpjesë.

2. Titujt dhe emrat e menaxherëve të pranuar nga autoriteti kompetent në përputhje me 21A. 145 germa (c) pika 2.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e menaxherit sikurse kërkohet në 21A. 145 germa (c) pika 2 duke përfshirë çështje për të cilat ata, në emër të sipërmarrjes mund të punojnë drejtpërdrejt me autoritetin kompetent.

4. Një skemë organizative të shoqëruar me zinxhirin e përgjegjësisë së menaxherëve sikurse kërkohet në 21A. 145 germa (c) pikat 1 dhe 2.

5. Një listë e stafit certifikues sikurse i referohemi në 21A.145 germa (d).

6. Një përshkrim i përgjithshëm i burimeve njerëzore.

7. Një përshkrim i përgjithshëm i mjediseve të ndodhura në secilën adresë të përcaktuar në certifikatën e miratimit të sipërmarrjes prodhuese.

8. Një përshkrim i përgjithshëm i sferës së punës së sipërmarrjes prodhuese, që ka të bëjë me kushtet e miratimit.

9. Procedurën për të njoftuar autoritetin kompetent për ndryshime organizative.
 10. Procedurën e ndryshimit të ekspozesë së sipërmarrjes prodhuese.
 11. Një përshkrim të sistemit të cilësisë dhe të procedurave sikurse kërkohet nga 21A.139 germa (b) pika 1.
 12. Një listë e palëve të jashtme të përmendura në 21A. 139 germa (a).
- (b) Ekspozeja e sipërmarrjes prodhuese ndryshohet, sipas nevojës, në mënyrë që të mbetet një përshkrim i përditësuar i sipërmarrjes, dhe kopje të ndryshimeve i jepet autoritetit kompetent.

21A.145 Kërkesat për miratim

Sipërmarrja prodhuese dëshmon, bazuar në informacionin e dhënë në përputhje me 21A.143, se:

(a) për sa i përket kërkesave të përgjithshme të miratimit, mjediset, kushtet e punës, pajisjet dhe veglat, proceset dhe materialet e tjera në lidhje me to, numri dhe aftësia e personelit, dhe organizimi i përgjithshëm janë të përshtatshme për të përmbushur përgjegjësitë sipas 21A.165.

(b) për sa i përket gjithë të dhënave për aftësinë për të fluturuar, zhurmën, humbjen e lëndës djegëse dhe emetimin e shkarkimeve:

1. Sipërmarrja prodhuese merr këto të dhëna nga Agjencia dhe nga mbajtësi apo kërkuesi për, certifikatë tip, certifikatë tip të kufizuar ose miratim të projektit, për të përcaktuar nëse është në përputhje me të dhënat e zbatueshme të projektit.

2. Sipërmarrja prodhuese ka përcaktuar një procedurë për të siguruar se të dhënat për aftësinë për të fluturuar, zhurmën, humbjen e lëndës djegëse dhe emetimin e shkarkimeve përfshihen në mënyrën e duhur në këto të dhëna të prodhimit.

3. Këto të dhëna mbahen të përditësuara dhe i vihen në dispozicion gjithë personelit që ka nevojë të ketë akses tek këto të dhëna për të kryer detyrat e tyre.

(c) për sa i përket drejtuesve dhe stafit:

1. Menaxheri emërohet nga sipërmarrja dhe i përgjigjet Autoritetit Kompetent. Përgjegjësia e tij ose e saj brenda sipërmarrjes është të sigurojë se gjithë procesi i prodhimit kryhet në përputhje me standardet e kërkuara, dhe se sipërmarrja prodhuese vazhdimisht është në përputhje me të dhënat dhe procedurat e identifikuar në ekspozenë e përmendur në 21A. 143.

2. Një person ose grup personash caktohet nga sipërmarrja prodhuese për të siguruar se sipërmarrja është në përputhje me kërkesat e kësaj pjese dhe identifikohen, së bashku, me gjithë autoritetin e tyre. Ky person/këta persona veprojnë nën autoritetin e drejtpërdrejtë të drejtuesit përgjegjës, siç përcaktohet në nënpikën 1. Personat e emëruar janë në gjendje të tregojnë njohuritë e duhura, formimin dhe përvojën e duhur për të përmbushur përgjegjësitë e tyre.

3. Personelit në të gjitha nivelet i jepet autoriteti i përshtatshëm që të mundin të përmbushin përgjegjësitë që u janë caktuar dhe që të ketë koordinim të plotë dhe të efektshëm brenda sipërmarrjes prodhuese, për sa i përket çështjeve të të dhënave të aftësisë për të fluturuar, zhurmës, humbjes së lëndës djegëse dhe emetimit të shkarkimeve.

(d) për sa i përket stafit certifikues, të autorizuar nga sipërmarrja prodhuese për të nënshkruar dokumentet e lëshuara sipas 21A.163 nën sferën e kushteve të miratimit:

1. Njohuritë, formimi profesional (duke përfshirë funksione të tjera në sipërmarrje), dhe përvoja e personelit certifikues janë të përshtatshme për të përmbushur përgjegjësitë që u janë caktuar.

2. Sipërmarrja prodhuese mban të dhëna për të gjithë personelin certifikues që përfshin hollësi të fushës së punës së tyre dhe të autorizimit të tyre.

3. Personelit certifikues u janë dhënë prova të fushës dhe autorizimit të tyre.

21A.147 Ndryshime të sipërmarrjes prodhuese të miratuar

(a) Pas dhënies së miratimit për sipërmarrjen prodhuese, secili ndryshim i sipërmarrjes së miratuar të prodhimit, i cili është domethënës për të treguar përputhshmërinë ose për aftësinë për të fluturuar dhe karakteristikat e zhurmës, humbjen e lëndës djegëse dhe emetimit të shkarkimeve të produktit, pjesës ose pajisjes, sidomos ndryshime ndaj sistemit të cilësisë, miratohen nga autoriteti kompetent. Kërkesa për miratim i paraqitet me shkrim autoritetit kompetent dhe sipërmarrja i vërtetohet atij para realizimit të ndryshimit se do të vazhdojë të veprojë në përputhje me këtë nënpjesë.

(b) Autoriteti kompetent përcakton kushtet, sipas së cilave një sipërmarrje prodhimi e miratuar sipas kësaj nënpjesë mund të veprojë gjatë këtyre ndryshimeve, përveç se kur autoriteti kompetent vendos që miratimi duhet të pezullohet.

21A.148 Ndryshimi i vendndodhjes

Ndryshimi i vendndodhjes së mjediseve prodhuese të sipërmarrjeve të miratuara prodhuese konsiderohen domethënës dhe për këtë arsye duhet të jenë në përputhje me 21A.147.

21A.149 Transferueshmëria

Miratimi i sipërmarrjes prodhuese nuk është i transferueshëm, përveç se kur është rezultat i ndryshimit të pronësisë, që për qëllimet e 21A.147 konsiderohet domethënës.

21A.151 Kushtet e miratimit

Kushtet e miratimit identifikojnë fushën e punës, produktet ose kategoritë e pjesëve dhe pajisjeve, ose të dyja, për të cilat mbajtësi ka të drejtën të ushtrojë privilegjet sipas 21A.163.

Ato kushte do të jepen si pjesë e miratimit të sipërmarrjes së prodhimit.

21A.153 Ndryshimet e kushteve të miratimit

Çdo ndryshim i kushteve të miratimit miratohet nga autoriteti kompetent. Kërkesa për ndryshimin e kushteve të miratimit bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga autoriteti kompetent. Kërkuesi duhet të përmbushë kërkesat e zbatueshmërisë në këtë nënpjesë.

21A.157 Hetime

Një sipërmarrje prodhuese merr masat e nevojshme që lejojnë Autoritetin Kompetent të bëjë çdo hetim, duke përfshirë hetimet e partnerëve dhe nënkontraktuesve, të nevojshme për të përcaktuar përputhshmërinë dhe vazhdimësinë e përputhshmërisë me kërkesat e zbatueshme të kësaj nënpjesë.

21A.158 Përfundime

(a) Kur ka prova objektive që tregojnë mospërputhshmëri të mbajtësit të një miratimi të sipërmarrjes prodhuese me kërkesat e zbatueshme të kësaj pjese, përfundimet klasifikohen si më poshtë:

1. Përfundime të nivelit të parë janë çdo mospërputhje me këtë pjesë, që mund të çojë në mospërputhje të pakontrolluara me të dhënat e zbatueshme të projektit të cilat mund të prekin sigurinë e avionit.

2. Përfundime të nivelit të dytë janë çdo mospërputhje me këtë pjesë, që nuk klasifikohet si niveli i parë.

- (b) Përfundime të nivelit të tretë janë çdo element ku, nëpërmjet provave objektive, është identifikuar se ka probleme që mund të çojnë në mospërputhje sipas germës (a).
- (c) Pasi merret njoftimi për përfundimet sipas 21B.225:

1. Në rast se arrihen përfundime të nivelit të parë, mbajtësi i miratimit të sipërmarrjes prodhuese ndërmerr veprime korrigjuese në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kompetent brenda një periudhe prej jo më shumë se 21 ditë pune pas marrjes së konfirmimit të përfundimeve;

2. Në rast se arrihen përfundime të nivelit të dytë, periudha e veprimeve korrigjuese e dhënë nga autoriteti kompetent do të jetë e përshtatshme me natyrën e përfundimeve, por në çdo rast, fillimisht nuk do t'i kalojë gjashtë muaj. Në disa rrethana dhe në varësi të përfundimeve, autoriteti kompetent mund ta zgjasë periudhën gjashtë mujore në një plan të kënaqshëm veprimi të masave korrigjuese për të cilin bihet dakord nga autoriteti kompetent.

3. Përfundimet e nivelit të tretë nuk kërkojnë që të ndërmerren veprime të menjëhershme nga mbajtësi i miratimit të sipërmarrjes prodhuese.

(d) Në rast se arrihen përfundime të nivelit të dytë, miratimi i sipërmarrjes prodhuese mund të jetë subjekt i një kufizimi të pjesshëm ose të plotë, pezullimi ose shfuqizimi sipas 21B.145. Mbajtësi i miratimit të sipërmarrjes prodhuese konfirmon në kohë marrjen e njoftimit të kufizimit, pezullimit ose të shfuqizimit të letrës së marrëveshjes.

21A.159 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e vazhdueshme

- (a) Miratimi i sipërmarrjes prodhuese lëshohet për një kohëzgjatje të pakufizuar. Mbetet i vlefshëm përveç se kur:
1. Sipërmarrja prodhuese nuk dëshmon përputhshmëri me kërkesat e zbatueshme në këtë nënpjesë; ose
 2. autoriteti kompetent pengohet nga mbajtësi ose ndonjë partner ose nënkontraktues i tij të kryejë investigimet në përputhje me 21A.257; ose
 3. Ekzistojnë prova që sipërmarrja prodhuese nuk mund të mbajë një kontroll të kënaqshëm të prodhimit të produkteve, pjesëve ose pajisjeve sipas miratimit; ose
 4. Sipërmarrja prodhuese nuk i plotëson më kërkesat e 21A.133; ose
 5. Certifikata është dorëzuar ose shfuqizuar 21B.245.
- (b) me t'u dorëzuar ose shfuqizuar, certifikata i kthehet autoritetit kompetent.

21A.163 Privilegjet

Në vijim të kushteve të miratimit të lëshuara sipas 21A.135, mbajtësi i një miratimi të sipërmarrjes prodhuese mund:

- (a) Të kryejë aktivitete prodhuese sipas kësaj pjese.
- (b) Në rast të një avioni të përfunduar dhe me paraqitjen e një deklarate përputhshmërie (Formulari EASA 52) sipas 21A.174, të marrë një certifikatë avioni të aftësisë së fluturimit dhe një certifikatë të zhurmës pa prova të mëtejshme.
- (c) Në rast të produkteve, pjesëve ose pajisjeve të tjera të lëshojë certifikata të autorizuara të shitjes (Formulari EASA 1) sipas 21A.307 pa prova të mëtejshme.
- (d) Të mirëmbajë avionin e ri që ka prodhuar dhe të lëshojë një certifikatë të lejimit për të shërbyer (Formulari EASA 53) në lidhje me atë mirëmbajtje.

21A.165 Detyrimet e mbajtësit

Mbajtësi i një miratimi të sipërmarrjes prodhuese:

- (a) Siguron që ekspozet e sipërmarrjes prodhuese e siguruar, në përputhje me 21A.143, dhe dokumentet, të cilave i referohet, përdoren si dokumente bazë pune brenda sipërmarrjes.
- (b) Mban sipërmarrjen prodhuese, në përputhje me të dhënat dhe procedurat e miratuara, për miratimin e sipërmarrjes prodhuese.
- (c) 1. Përcakton që çdo avion i përfunduar përputhet me projektin tip dhe është në kushte për përdorim të sigurtë para se t'i dorëzohen autoritetit kompetent deklaratat e përputhshmërisë, ose
2. Përcakton që produktet, pjesët ose pajisjet e tjera janë të plota dhe në përputhje me të dhënat e projektit të miratuar, dhe janë në kushte për operim të sigurt përpara lëshimit të Formularit EASA 1, për të vërtetuar aftësinë e fluturimit dhe krahas kësaj në rast të motorëve, përcakton sipas të dhënave të siguruara nga mbajtësi i certifikatës tip të motorit, që çdo motor i përfunduar është në përputhje me kërkesat e zbatueshme të emetimit të gazrave, siç përcaktohet në 21A.18 germa (b), aktuale në datën e prodhimit të motorit, për të vërtetuar përputhshmëri të emetimeve, ose
3. Përcakton që produktet, pjesët ose pajisjet e tjera përputhen me të dhënat e zbatueshme përpara lëshimit të Formularit EASA 1 si certifikatë përputhshmërie;
- (d) Regjistron të gjitha detajet e punës së kryer.
- (e) Vendos dhe mban një sistem të brendshëm raportimi të ngjarjeve në interes të sigurisë, për të siguruar mbledhjen dhe vlerësimin e raporteve të ngjarjeve, me qëllim për të identifikuar tendenca të kundërta, ose për të trajtuar mungesat dhe të nxjerrë ngjarjet e raportueshme. Ky sistem përfshin vlerësimin e informacionit përkatës, në lidhje me ngjarjet dhe shpërndarjen e informacionit që ka të bëjë me të.
- (f) 1. I raporton mbajtësit të certifikatës tip ose miratimit për projektim, të gjitha rastet kur produktet, pjesët ose pajisjet janë lëshuar nga sipërmarrja prodhuese dhe më pas është identifikuar se kanë devijime të mundshme nga të dhënat e zbatueshme të projektit, dhe heton me mbajtësin e certifikatës tip ose të miratimit të projektit për të identifikuar ato devijime të cilat mund të çojnë në kushte të pasigurta.
2. I raporton Agjencisë dhe autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar devijimet, të cilat mund të çojnë në kushte të pasigurta të identifikuar në përputhje me nënpikën 1. Të tilla raportime bëhen në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Agjencia sipas 21A.3 germa (b) pika 2, ose në një formë e mënyrë të pranuar nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar.
3. Kur mbajtësi i miratimit të sipërmarrjes prodhuese vepron si një furnizues për një tjetër sipërmarrje prodhuese, i raporton gjithashtu asaj sipërmarrjeje tjetër të gjitha rastet ku i ka lëshuar asaj organizate produkte, pjesë ose pajisje, dhe më pas ka identifikuar se ato mund të kenë devijime të mundshme nga të dhënat e zbatueshme të projektit.
- (g) I siguron ndihmë mbajtësit të certifikatës tip ose të miratimit të projektit që merret me çdo veprim të vazhdueshëm të aftësisë për të fluturuar që janë të lidhura me produktet, pjesët ose pajisjet që janë prodhuar.
- (h) Realizon një sistem arkivimi duke përfshirë kërkesat e imponuara ndaj partnerëve, furnizuesve dhe nënkontraktuesve, duke siguruar ruajtjen e të dhënave të përdorura për të justifikuar përputhshmërinë e produkteve, pjesëve ose pajisjeve. Këto të dhëna vihen në dispozicion të Autoritetit Kompetent dhe mbahen në mënyrë që të jepet informacioni i nevojshëm për aftësinë e vazhdueshme të fluturimit të produkteve, pjesëve ose pajisjeve.
- (i) Kur, sipas kushteve të miratimit, mbajtësi lëshon një certifikatë të lejimit të shërbimit, përcakton që çdo avion i përfunduar i është nënshtruar mirëmbajtjes së nevojshme dhe është në kushte për operim të sigurt, përpara lëshimit të certifikatës.

NËNPJESA H – CERTIFIKATAT E AFTËSISË PËR TË FLUTURUAR

21A.171 Qëllimi

Kjo nënpjesë përcakton procedurën për lëshimin e certifikatave të aftësisë për të fluturuar

21A.172 E drejta për t'u përzgjedhur

Çdo person fizik ose juridik në emër të të cilit është regjistruar ose do të regjistrohet një avion në një Shtet Anëtar (Shteti Anëtar i regjistrimit), ose përfaqësuesi i tij, do të pranohet si një kërkues për një certifikatë të aftësisë për të fluturuar për atë avion sipas kësaj nënpjese.

21A.173 Klasifikimi

Certifikatat e aftësisë për të fluturuar klasifikohen si vijon:

(a) Certifikatat e aftësisë për të fluturuar lëshohen për avionë që përputhen me një tip certifikate që është lëshuar në përputhje me këtë pjesë.

(b) Certifikatat e kufizuara të aftësisë për të fluturuar lëshohen për avionë:

1. të cilët përputhen me një tip certifikate të kufizuar që është lëshuar në përputhje me këtë pjesë; ose
2. për të cilët i është treguar Agjencisë se përmbushin kushtet e veçanta të certifikimit duke pasur siguri të mjaftueshme.

(c) Lejet për të fluturuar lëshohen për avionët që nuk plotësojnë ose nuk kanë treguar se plotësojnë kushtet e zbatueshme të certifikimit, por janë në gjendje të kryejnë fluturime të sigurta sipas kushteve të përcaktuara.

21A.174 Kërkesa

(a) Në bazë të 21A.172, një kërkesë për një certifikatë të aftësisë për të fluturuar bëhet në një formë dhe mënyrë të përcaktuar nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit.

(b) Secila kërkesë për një certifikatë të aftësisë për të fluturuar ose certifikatë të kufizuar të aftësisë për të fluturuar përfshin:

1. klasa e certifikatës së aftësisë për të fluturuar për të cilën është bërë kërkesë;
2. në lidhje me një avion të ri:
 - (i) një deklaratë përputhshmërie:
 - e lëshuar sipas 21A.163 germa (b), ose
 - e lëshuar sipas 21A.130 dhe e vlerësuar nga autoriteti kompetent,
 - ose, për një avion të importuar, një deklaratë që avioni përputhet me një projekt të miratuar nga Agjencia, të nënshkruar nga autoriteti eksportues
 - (ii) Një raport të peshës dhe balancës me një planifikim të ngarkesës.
 - (iii) Manualin e fluturimit, kur kërkohet nga kodi i zbatueshëm i aftësisë për të fluturuar për avionin e veçantë;
3. në lidhje me avionë të përdorur:
 - (i) me origjinë nga një Shtet Anëtar, një certifikatë rishikimi të aftësisë për të fluturuar të lëshuar në përputhje me pjesën M
 - (ii) me origjinë nga një shtet joanëtar:

- një deklaratë nga autoriteti kompetent i shtetit ku avioni është ose ishte regjistruar duke reflektuar statusin e aftësisë për të fluturuar të avionit në regjistrin e tij në kohën e transferimit.
- një raport të peshës dhe balancës me një planifikim të ngarkesës;
- manualin e fluturimit, kur një material i tillë kërkohet nga kodi i zbatueshëm i aftësisë për të fluturuar për një avion të veçantë;
- të dhëna historike që përcaktojnë prodhimin, modifikime dhe standardin e mirëmbajtjes së avionit, duke përfshirë të gjitha kufizimet të shoqëruara me një certifikatë të kufizuar të aftësisë për të fluturuar sipas 21A.184 germa (c);
- një rekomandim për lëshimin e një certifikate të aftësisë për të fluturuar ose certifikate të kufizuar të aftësisë për të fluturuar dhe një certifikate të aftësisë së rishikuar të fluturimit, në vijim të një rishikimi të aftësisë së fluturimit në përputhje me pjesën M.

(c) Vetëm nëse bihet dakord ndryshe, deklaratat e përmendura në germën (b) pika 2 nënpika (i) dhe (b) pika 3 nënpika (ii) lëshohen jo më shumë se 60 ditë përpara paraqitjes së avionit te autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit.

(d) Çdo kërkesë për një leje për fluturim përfshin:

1. Qëllimin e fluturimit/fluturimeve;
2. Itineraret ose hapësirën ajrore, ose të dyja, të përdorura për fluturimin;
3. Ekuipazhin minimal të fluturimit që kërkohet për të operuar avionin dhe kualifikimet e tyre;
4. Kufizimet për transportin e personave të tjerë nga ekuipazhi i fluturimit;
5. Mënyrat në të cilat avioni nuk përputhet me kushtet e zbatueshme të certifikimit;
6. Çdo kufizim që konsiderohet i nevojshëm për operim të sigurt të avionit;
7. Çdo informacion tjetër që konsiderohet i nevojshëm për qëllime të përshkrimit të kufizimeve në operim.

21A.175 Gjuha

Manualët, afishet, listat dhe shenjat e instrumenteve dhe informacioni tjetër i nevojshëm, i kërkuar nga kushtet e zbatueshme të certifikimit, paraqiten në një ose më shumë gjuhë zyrtare të Komunitetit Europian të pranueshme nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit.

21A.177 Ndryshimi ose modifikimi

Një certifikatë e aftësisë për të fluturuar mund të ndryshohet ose modifikohet vetëm nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit.

21A.179 Transferueshmëria dhe rilëshimi brenda Shteteve Anëtare

(a) Kur pronësia e një avionit ka ndryshuar:

1. nëse mbetet në të njëjtin regjistër, certifikata e aftësisë për të fluturuar, ose certifikata e kufizuar e aftësisë për të fluturuar në përputhje vetëm me një tip certifikate të kufizuar, transferohet së bashku me avionin;
2. nëse avioni është i regjistruar në një Shtet tjetër Anëtar, certifikata e aftësisë për të fluturuar, ose certifikata e kufizuar e aftësisë për të fluturuar në përputhje vetëm me një tip lëshohet,
 - (i) me paraqitjen e certifikatës së mëparshme të aftësisë për të fluturuar dhe të një certifikate të vlefshme të rishikimit të aftësisë për të fluturuar të lëshuar sipas pjesës M, dhe
 - (ii) kur plotësohet 21A.175.

(b) Kur pronësia e një avionit ka ndryshuar dhe avioni ka:

1. një certifikatë të kufizuar të aftësisë për të fluturuar që nuk përputhet me certifikatën tip të kufizuar, ose
2. një leje për të fluturuar,

Certifikata të tilla të aftësisë për të fluturuar transferohen së bashku me avionin, me kusht që avioni të mbetet në të njëjtin regjistër, ose lëshohet vetëm me marrëveshje formale të autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të regjistrimit në të cilin transferohet.

21A.180 Inspektimet

Mbajtësi i certifikatës së aftësisë për të fluturuar siguron akses në avionin për të cilin ajo certifikatë e aftësisë për të fluturuar është lëshuar me kërkesë të autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të regjistrimit.

21A.181 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e vazhdueshme

- (a) një certifikatë e aftësisë për të fluturuar lëshohet për një kohëzgjatje të pakufizuar. Ajo mbetet e vlefshme kur:
1. përputhet me projektin tip të zbatueshëm dhe kërkesat e vazhdueshme të aftësisë për të fluturuar; dhe
 2. avioni mbetet në të njëjtin regjistër; dhe
 3. certifikata tip ose certifikata tip e kufizuar sipas së cilës është lëshuar nuk është shfuqizuar më parë sipas 21A.51.
 4. kur certifikata nuk dorëzohet ose shfuqizohet sipas 21B.330.
- (b) me t'u dorëzuar ose shfuqizuar, certifikata i kthehet autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të regjistrimit.

21A.182 Identifikimi i avionit

Çdo kërkues për certifikatë të aftësisë për të fluturuar sipas kësaj nënpjesë dëshmon se avioni i tij identifikohet në përputhje me nënpjesën Q.

21A.183 Lëshimi i certifikatave të aftësisë për të fluturuar

Autoriteti kompetent i shtetit të regjistrimit lëshon një certifikatë të aftësisë për të fluturuar për:

1. avion të ri:

- (i) me paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar nga 21A.174 germa (b) pika 2.
- (ii) kur avioni përputhet me një projekt të miratuar dhe është në kushte për operim të sigurt. Kjo mund të përfshijë inspektimet nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit.
2. avion të përdorur:

- (i) me paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar nga 21A.174 germa (b) pika 3 duke dëshmuar që:
- avioni përputhet me një projekt tip të miratuar sipas një certifikatë tip dhe çdo certifikate tip shtesë, ndryshim ose riparim të miratuar në përputhje me këtë pjesë, dhe me direktivat e zbatueshme të aftësisë për të fluturuar, dhe
 - avioni është inspektuar në përputhje me dispozitat e zbatueshme të pjesës M, dhe
- (ii) kur avioni përputhet me një projekt të miratuar dhe është në kushte për operim të sigurt. Kjo mund të përfshijë inspektimet nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit.

21A.184 Lëshimi i certifikatave të kufizuara të aftësisë për të fluturuar

(a) Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit lëshon një certifikatë të kufizuar të aftësisë për të fluturuar për:

1. avion të ri, me paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar nga 21A.174 germa (b) pika 2 duke treguar se avioni përshtatet me një projekt të miratuar nga Agjencia sipas një certifikate tip të kufizuar ose në përputhje me kushtet e veçanta të certifikimit, dhe është në kushte për operim të sigurt.

2. avion të përdorur:

(i) me paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar nga 21A.174 germa (b) pika 3 duke treguar se:

- avioni përputhet me një projekt të miratuar nga Agjencia sipas një certifikate tip të kufizuar ose në përputhje me kushtet e veçanta të certifikimit, dhe
- janë zbatuar direktivat e zbatueshme të aftësisë për të fluturuar, dhe
- avioni është inspektuar në përputhje me dispozitat e përshtatshme të pjesës M;

(ii) kur autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit përfundon se avioni përputhet me projektin e miratuar dhe është në kushte pune të sigurta. Kjo mund të përfshijë inspektimet nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrit.

(b) Për një avion që nuk mund të plotësojë kërkesat thelbësore të përmendura në rregulloren bazë dhe i cili nuk është i pranueshëm për një tip certifikate të kufizuar, Agjencia, si të nevojshme për të marrë në konsideratë devijimet nga këto kërkesa thelbësore:

1. lëshon dhe kontrollon përputhshmërinë me kushtet e veçanta të certifikimit duke siguruar sigurinë e duhur në lidhje me përdorimin e planifikuar, dhe

2. përcakton kufizimet për përdorim të këtij avioni.

(c) kufizimet për përdorim do të shoqërohen me certifikatat e kufizuara të aftësisë së fluturimit, duke përfshirë kufizimet në hapësirën ajrore sipas nevojës për të marrë parasysht devijimet nga kërkesat thelbësore të aftësisë të fluturimit të vendosura në këtë Rregullore bazë.

21A.185 Lëshimi i lejeve të fluturimit

Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit lëshon leje fluturimi, pasi Agjencia të ketë përfunduar, se avioni dhe kufizimet e shoqëruara të përshtatshme, që kompensojnë devijimin nga kërkesat thelbësore, lejojnë avionin të kryejë në mënyrë të sigurtë fluturimin bazë. Për këtë qëllim, Agjencia mund të bëjë ose t'i kërkojë kërkuesit të bëjë inspektimet ose provat e nevojshme për të garantuar sigurinë.

NËNPJESA I – CERTIFIKATAT E ZHURMËS

21A.201 Qëllimi

Kjo nënpjesë përcakton procedurën e lëshimit të certifikatave të zhurmës.

21A.203 E drejta për t'u përzgjedhur

Çdo person fizik ose juridik në emër të të cilit është regjistruar ose do të regjistrohet një avion në një Shtet Anëtar (Shteti Anëtar i regjistrimit), ose përfaqësuesi i tij, mund të bëjë kërkesë për një certifikatë të zhurmës për atë avion sipas kësaj nënpjesë.

21A.204 Kërkesa

(a) Bazuar në 21A.172, kërkesa për certifikatë zhurme bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit.

(b) Secila kërkesë përfshin:

1. në lidhje me një avion të ri:

(i) një deklaratë përputhshmërie:

- të lëshuar sipas 21A.163 germa (b), ose

- të lëshuar sipas 21A.130 dhe vleftësuar nga autoriteti kompetent
- ose, për një avion të importuar, një deklaratë të nënshkruar nga autoriteti eksportues që avioni përputhet me një projekt të miratuar nga Agjencia, dhe

(ii) Informacioni për zhurmën përcaktuar në përputhje me kërkesat e zbatueshme për zhurmën. Ky informacion përfshihet në manualin e fluturimit, kur një manual fluturimi kërkohet nga kodi i zbatueshëm i aftësisë për të fluturuar për atë avion në veçanti.

2. në lidhje me një avion të përdorur:

(i) Informacioni për zhurmën, përcaktuar në përputhje me kërkesat në zbatim për zhurmën. Ky informacion përfshihet në manualin e fluturimit, kur një i tillë kërkohet nga kodi i zbatueshëm i aftësisë për të fluturuar për atë avion në veçanti, dhe

(ii) Të dhënat historike për të përcaktuar prodhimin, modifikimin dhe standardin e mirëmbajtjes së avionit.

(c) Përveç se kur bihet dakord ndryshe, deklarata e përmendur në germën (b) pika 1 përdoret jo më shumë se 60 ditë përpara paraqitjes së avionit tek autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të regjistrimit.

21A.205 Lëshimi i certifikatave të zhurmës

Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit lëshon një certifikatë të zhurmës me paraqitjen e dokumentave të kërkuara sipas 21A.204 germa (b).

21A.207 Ndryshimi ose modifikimi

Certifikata e zhurmës mund të ndryshohet ose modifikohet vetëm nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit.

21A.209 Transferimi dhe rilëshimi brenda Shteteve Anëtare

Kur pronësia e një avioni ka ndryshuar:

(a) nëse avioni mbetet në të njëjtin regjistër, certifikata e zhurmës transferohet së bashku me avionin; ose

(b) nëse avioni lëviz në një regjistër të një Shteti tjetër Anëtar, certifikata e zhurmës lëshohet me t'u paraqitur certifikata e mëparshme e zhurmës.

21A.210 Inspektimet

Kur autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit ose Agjencia kërkon të kryejë inspektim, mbajtësi i certifikatës së zhurmës siguron hyrjen në avion.

21A.211 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e vazhdueshme

(a) certifikata e zhurmës lëshohet për një kohëzgjatje të pakufizuar. Ajo mbetet e vlefshme kur:

1. respektohet tip projekti i zbatueshëm, mbrojtja mjedisore dhe kërkesat e vazhdueshme të aftësisë për të fluturuar; dhe

2. avioni mbetet në të njëjtin regjistër; dhe

3. certifikata tip ose certifikata tip e kufizuar, sipas së cilës është lëshuar, nuk është shfuqizuar më parë sipas 21A.51.

4. certifikata nuk është dorëzuar ose shfuqizuar sipas 21B.430.

(b) me t'u dorëzuar ose shfuqizuar, certifikata i kthehet autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të regjistrimit.

NËNPJESA J – MIRATIMI I SIPËRMARRJES PROJEKTUESE

21A.231 Qëllimi

Kjo nënpjesë përcakton procedurën për miratimin e sipërmarrjeve projektuese dhe rregullave që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e kërkuesve, dhe mbajtësve të miratimeve të tilla.

21A.233 E drejta për t'u përzgjedhur

Çdo person fizik ose juridik ("sipërmarrje") mund të bëjë kërkesë për miratimin sipas kësaj nënpjese:

- (a) në përputhje me 21A.14, 21A.112B, 21A.432B ose 21A.602B; ose
- (b) për miratimin e ndryshimeve të vogla ose riparimeve të vogla projektuese, kur kërkohet për qëllimin e marrjes së privilegjeve sipas 21A.263.

21A.234 Kërkesa

Çdo kërkesë për miratim të sipërmarrjeve projektuese bëhet në një formë dhe mënyrë të përcaktuar nga Agjencia, dhe përfshin një përmbledhje të informacionit të kërkuar në 21A.243, dhe kushteve të miratimit që kërkohet të lëshohet sipas 21A.251.

21A.235 Lëshimi i miratimit të sipërmarrjes projektuese

Një sipërmarrje ka të drejtën të marrë miratimin si sipërmarrje projektuese të dhënë nga Agjencia, kur ajo të ketë treguar përputhshmëri me kërkesat e zbatueshme sipas kësaj nënpjese.

21A.239 Sistemi i garancisë projektuese

(a) Sipërmarrja projektuese tregon se ka ngritur dhe është në gjendje të mirëmbajë një sistem të garancisë projektuese për kontrollin dhe mbikëqyrjen e projektit, dhe të ndryshimeve projektuese, pjesëve dhe pajisjeve të mbuluara nga kërkesa. Ky sistem i garancisë projektuese duhet të jetë i tillë që t'i mundësojë sipërmarrjes:

1. të sigurojë që projekti i produkteve, pjesëve dhe pajisjeve ose ndryshimi projektues i tyre, përputhen me certifikatën tip bazë të zbatueshme dhe kërkesat për mbrojtjen mjedisore; dhe

2. të sigurojë që përgjegjësitë e saj përmbushen si duhet në përputhje me:

- (i) dispozitat e përshtatshme të kësaj pjese; dhe
- (ii) kushtet e miratimit të lëshuar sipas 21A.251.

3. të monitorojë në mënyrë të pavarur përputhshmërinë me dhe përshtatshmërinë e procedurave të dokumentuara të sistemit. Ky monitorim përfshin një sistem reagimi për një person ose një grup personash që kanë përgjegjësinë për të siguruar veprime korrigjuese.

(b) Sistemi i garancisë projektuese përfshin një funksion kontrollues të pavarur të dëshmimeve të përputhshmërisë, mbi bazën e të cilit sipërmarrje i dorëzon Agjencisë deklarata të përputhshmërisë dhe dokumenta që kanë të bëjnë me to.

(c) Sipërmarrja projektuese përcakton mënyrën në të cilën sistemi i garancisë projektuese konsideron pranueshmërinë e pjesëve ose pajisjeve të projektuara ose detyrave të kryera nga partnerë ose nënkontraktues sipas metodave të cilat i nënshtrohen procedurave me shkrim.

21A.243 Të dhënat

(a) Sipërmarrja projektuese pajis Agjencinë me një manual, i cili përshkruan drejtpërdrejt ose përmes referencave, sipërmarrjen, procedurat përkatëse dhe produktet ose ndryshimet e produkteve që do të projektohen.

(b) kur ndonjë pjesë ose pajisje, ose ndonjë ndryshim i produkteve projektohet nga sipërmarrja ose nënkontraktues partner, manual që përfshin një deklaratë se si sipërmarrja projektuese është në gjendje të japë, për të gjitha pjesët dhe pajisjet, garancinë e përputhshmërisë të kërkuar sipas 21A.239 germa (b), dhe përmban drejtpërdrejt ose përmes referencave, përshkrimet dhe informacionin mbi aktivitetet e projektit dhe sipërmarrjen e atyre partnerëve ose nënkontraktuesve, të cilat të jenë të nevojshme për të përcaktuar këtë deklaratë.

(c) Manuali ndryshohet sipas nevojës që të jetë një përshkrim i përditësuar i sipërmarrjes, dhe kopjet e ndryshimeve sigurohen nga Agjencia.

(d) Sipërmarrja projektuese siguron një deklaratë të kualifikimeve dhe eksperiencës së stafit drejtues dhe personave të tjerë përgjegjës, për marrjen e vendimeve që ndikojnë në aftësinë e fluturimit dhe mbrojtjen mjedisore në sipërmarrje.

21A.245 Kërkesat për miratim

Sipërmarrja projektuese tregon, mbi bazën e informacionit të dorëzuar në përputhje me 21A.243, se krahas përputhshmërisë me 21A.239:

(a) personeli në të gjitha departamentet teknike është i mjaftueshëm në numër dhe ka përvojën e mjaftueshme, si dhe i është dhënë autoriteti i nevojshëm për të qenë në gjendje të përmbushë përgjegjësitë që i janë ngarkuar, dhe se këto, së bashku me akomodimin, mjediset dhe pajisjet janë të mjaftueshme për t'i mundësuar personelit të arrijë objektivat e aftësisë për të fluturuar, zhurmës, lubrifikuesit dhe lëshimi i gazrave për produktin;

(b) ka një koordinim të plotë dhe efikas ndërmjet departamenteve dhe brenda departamenteve në lidhje me çështjet e aftësisë për të fluturuar dhe mbrojtjes mjedisore.

21A.247 Ndryshimet në sistemin e garancisë projektuese

Pas dhënies së miratimit për një sipërmarrje projektuese, çdo ndryshim në sistemin e garancisë projektuese, i cili ka rëndësi për të treguar përputhshmëri ose për aftësinë e fluturimit dhe mbrojtjen mjedisore të produktit, miratohet nga Agjencia. Kërkesa për miratim dorëzohet me shkrim pranë Agjencisë, dhe sipërmarrja projektuese i dëshmon Agjencisë, mbi bazën e dorëzimit të ndryshimeve të propozuara në manual, dhe përpara zbatimit të ndryshimit, se ajo do të vazhdojë të përputhet me këtë nënpjesë pas zbatimit.

21A.249 Transferueshmëria

Përveç se si rezultat i një ndryshimi në pronësi, i cili konsiderohet i rëndësishëm për qëllimet e 21A.247, miratimi i një sipërmarrjeje projektuese nuk është i transferueshëm.

21A.251 Kushtet e miratimit

Kushtet e miratimit identifikojnë llojet e punës së projektit, kategoritë e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve për të cilat sipërmarrja projektuese ka një miratim të sipërmarrjes projektuese, dhe funksionet e detyrat për kryerjen e të cilave miratohet sipërmarrje në lidhje me aftësinë e fluturimit dhe karakteristikat e zhurmës, lubrifikantët dhe lëshimin e gazrave të produkteve. Për miratimin e sipërmarrjes projektuese që mbulon certifikatën tip ose autorizimi ETSO për njësitë ndihmëse të energjisë (APU), kushtet e miratimit përmbajnë edhe listën e produkteve ose APU. Këto kushte jepen si pjesë e miratimit të sipërmarrjes së projektit.

21A.253 Ndryshimet e kushteve të miratimit

Çdo ndryshim në kushtet e miratimit miratohet nga Agjencia. Një kërkesë për një ndryshim në termat e miratimit bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Agjencia. Sipërmarrja projektuese përputhet me kërkesat e zbatueshme për këtë nënpjesë.

21A.257 Hetimet

(a) Sipërmarrja projektuese kryen veprimet e nevojshme për të lejuar Agjencinë të bëjë çdo hetim, duke përfshirë hetimet e partnerëve dhe nënkontraktuesve, të nevojshëm për të përcaktuar përputhshmërinë dhe përputhshmërinë e vazhdueshme me kërkesat e zbatueshme të kësaj nënpjesë;

(b) Sipërmarrja projektuese lejon Agjencinë të rishikojë çdo raport dhe të bëjë çdo inspektim, dhe të kryejë ose të jetë e pranishme në çdo fluturim dhe provë në tokë, të nevojshme për të kontrolluar vlefshmërinë e deklaratave të përputhshmërisë të dorëzuara nga kërkuesi sipas 21A.239 germa (b).

21A.258 Përfundime

(a) Kur gjenden prova objektive që tregojnë mospërputhshmëri të mbajtësit të miratimit të sipërmarrjes projektuese me kërkesat e zbatueshme të kësaj pjese, përfundimet klasifikohen si vijon:

1. Përfundime të nivelit të parë janë çdo mospërputhje me këtë pjesë që mund të çojë në mospërputhje të pakontrolluara me të dhënat e zbatueshme të projektit, të cilat mund të prekin sigurinë e avionit;

2. Përfundime të nivelit të dytë janë çdo mospërputhje me këtë pjesë që nuk klasifikohen si niveli i parë.

(b) Përfundime të nivelit të tretë janë çdo element ku, nëpërmjet provave objektive, është identifikuar se ka probleme që mund të çojnë në mospërputhje sipas germës (a).

(c) Pasi merret njoftimi për përfundimet sipas procedurave të zbatueshme administrative të vendosura nga Agjencia;

1. Në rast se arrihen përfundime të nivelit të parë, mbajtësi i miratimit të sipërmarrjes projektuese ndërmerr veprime korrigjuese, në përputhje me kërkesat e Agjencisë, brenda një periudhe prej jo më shumë se 21 ditë pune pas marrjes së konfirmimit me shkrim të përfundimeve;

2. Në rast se arrihen përfundime të nivelit të dytë, periudha e veprimeve korrigjuese e dhënë nga Agjencia do jetë e përshtatshme me natyrën e përfundimeve por në çdo rast, fillimisht nuk do t'i kalojë gjashtë muaj. Në disa rrethana dhe në varësi të përfundimeve, autoriteti kompetent mund ta zgjasë periudhën gjashtë mujore në një plan të kënaqshëm veprimi të masave korrigjuese për të cilin bihet dakord nga Agjencia;

3. Përfundimet e nivelit të tretë nuk kërkojnë që të ndërmerren veprime të menjëhershme nga mbajtësi i miratimit të sipërmarrjes projektuese.

(d) në rast se arrihen përfundime të nivelit të parë ose të dytë, miratimi i sipërmarrjes projektuese mund të jetë subjekt i një pezullimi ose shfuqizimi të pjesshëm ose të plotë, sipas procedurave të zbatueshme administrative të përcaktuara nga Agjencia. Mbajtësi i miratimit të sipërmarrjes projektuese konfirmon në kohë marrjen e njoftimit të pezullimit ose të shfuqizimit të miratimit të sipërmarrjes projektuese.

21A.259 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e vazhdueshme

(a) Miratimi i sipërmarrjes projektuese jepet për një kohëzgjatje të pakufizuar. Ai mbetet i vlefshëm përveçse kur:

1. Sipërmarrja projektuese nuk arrin të dëshmojë përputhshmërinë me kërkesat e zbatueshme në këtë nënpjesë; ose

2. Agjencia nuk lejohet nga mbajtësi ose ndonjë partner ose nënkontraktues i tij të kryejë investigimet në përputhje me 21A.257; ose

3. Ka prova që sistemi i garancisë projektuese nuk mund të mbajë një kontroll dhe mbikëqyrje të kënaqshme të projektit të produkteve ose të ndryshimeve të tij sipas miratimit; ose

4. Certifikata është dorëzuar ose shfuqizuar sipas procedurave të zbatueshme administrative të vendosura nga Agjencia.
- (b) me t'u dorëzuar ose shfuqizuar, certifikata i kthehet Agjencisë.

21A.263 Privilegjet

- (a) Mbajtësi i një miratimi të sipërmarrjes projektuese ka të drejtën të kryejë aktivitete projektuese sipas kësaj pjese dhe brenda fushës së punës së miratuar.
- (b) Sipas 21A.257 germa (b), dokumente që tregojnë përputhshmëri që paraqiten nga kërkuesi për qëllime të marrjes së:
1. certifikatë tip ose miratimi i një ndryshimi të madh të një projekti tip; ose
 2. certifikatë tip shtesë; ose
 3. autorizim ETSO sipas 21A.602 germa (b) pika 1;
 4. miratim për një riparim të madh projektues;
- pranohen nga Agjencia pa verifikim të mëtejshëm.
- (c) Mbajtësi i një miratimi të sipërmarrjes projektuese ka të drejtën, brenda kushteve të miratimit dhe sipas procedurave përkatëse të sistemit të garancisë projektuese:
1. të klasifikojë ndryshimet në projektin tip dhe riparimet si “të mëdha” ose “të vogla”
 2. të miratojë ndryshimet e vogla të projektit tip dhe riparimet e vogla
 3. të japë informacion ose udhëzime që përmbajnë deklaratën që vijon: “përmbajtja teknike e këtij dokumenti miratohet nën autoritetin e DOA nr. [EASA]. J. [xyz].”
 4. të miratojë ndryshimet dokumentuese të manualit të fluturimit të avionit, dhe të japë ndryshime të tilla që përmbajnë deklaratën që vijon: "Rishikim nr. xx i AFM ref. yyy, miratohet nga autoriteti i DOA nr.[EASA].J.[xyz].”
 5. të miratojë projektin e riparimeve të mëdha të produkteve për të cilat mban një certifikatë tip ose certifikatën tip shtesë.

21A.265 Detyrimet e mbajtësit

Mbajtësi i miratimit të sipërmarrjes projektuese:

- (a) Mban manualin në përputhje me sistemin e garancisë projektuese;
- (b) Siguron që ky manual lëshohet si një dokument bazë pune brenda sipërmarrjes;
- (c) Përcakton që projekti i produktit, ose ndryshimet ose riparimet e tij, sipas rastit, përputhen me kërkesat e zbatueshme dhe nuk kanë tipar të pasigurtë;
- (d) Me përjashtim të ndryshimeve të vogla ose riparimeve të miratuara sipas privilegjit të 21A.263, t'i sigurojë Agjencisë deklaratë dhe dokumentacione shoqëruese që konfirmojnë përputhje me germën (c);
- (e) I siguron Agjencisë informacionin ose udhëzimet që lidhen me veprimet e kërkuara sipas 21A.3B.

NËNPJESA K – PJESËT DHE PAJISJET

21A.301 Qëllimi

Kjo nënpjesë përcakton procedurën në lidhje me miratimin e pjesëve dhe pajisjeve.

21A.303 Përputhshmëria me kërkesat e zbatueshme

Përputhshmëria e pjesëve dhe pajisjeve për t'u montuar në një produkt të mbuluar nga certifikata tip tregohet:

- (a) në lidhje me procedurat e certifikatës tip të nënpjesës B, D ose E për produktin në të cilin do të montohet; ose
- (b) kur është e zbatueshme, sipas procedurave autorizuese ETSO të nënpjesës O; ose
- (c) në rast të pjesëve standard, në përputhje me standardet e njohura zyrtarisht.

21A.305 Miratimi i pjesëve dhe pajisjeve

Në të gjitha rastet, kur miratimi i një pjese ose pajisjeje kërkohet qartësisht nga ligjet e Komunitetit ose masat e Agjencisë, pjesa ose pajisja përputhet me ETSO e zbatueshme ose me kushtet e njohura si ekuivalente nga Agjencia në atë rast të veçantë.

21A.307 Lëshimi i pjesëve dhe pajisjeve për montim

Asnjë pjesë ose pajisje (përveç pjesëve standard) nuk është e pranueshme për montim në një produkt të certifikuar tip përveç se kur:

- (a) shoqërohet me një certifikatë të lëshimit të autorizuar (Formulari EASA 1), që certifikon aftësinë e fluturimit; dhe
- (b) është shënuar në përputhje me nënpjesën Q.

(NËNPJESA L – E PAZBATUESHME)

NËNPJESA M – RIPARIMET

21A.431 Qëllimi

- (a) Kjo nënpjesë përcakton procedurën për miratimin e projektit riparues dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e kërkuesve për, dhe mbajtësve të këtyre miratimeve.
- (b) “Riparim” nënkupton eliminimin e dëmit dhe/ose rivendosjen e një kushti të aftësisë për të fluturuar pas vënies fillestare në shërbim nga prodhuesi i çdo produkti, pjese ose pajisjeje.
- (c) Eliminimi i dëmit nëpërmjet zëvendësimit të pjesëve ose pajisjeve pa nevojën e aktivitetit projektues konsiderohet si një detyrë mirëmbajtjeje, dhe për rrjedhojë nuk kërkon miratim sipas kësaj pjese.
- (d) Riparimi i një objekti ETSO trajtohet si një ndryshim i projektit ETSO dhe trajtohet në përputhje me 21A.611.

21A.432 Kualifikimi

- (a) Çdo person fizik ose juridik që ka treguar, ose është duke treguar aftësitë e tij sipas 21A.432B pranohet si një kërkues për një miratim projektues riparues të madh, sipas kushteve të vendosura në këtë nënpjesë.
- (b) Çdo person fizik ose juridik pranohet të bëjë kërkesë për miratimin e një projekti riparues të vogël.

21A.432B Dëshmimi i aftësive

- (a) Një kërkues për një miratim të një projekti riparimi të madh dëshmon aftësitë e tij duke pasur një miratim të sipërmarrjes projektuese, të lëshuar nga Agjencia në përputhje me nënpjesën J.
- (b) Duke u shmangur nga germa (a), si një procedurë alternative për të dëshmuar aftësinë e tij, një kërkues mund t'i kërkojë Agjencisë marrëveshje për përdorimin e procedurave që parashtrajnë praktika projektuese të caktuara, burime dhe radhë aktivitete të nevojshme për t'u përputhur me këtë nënpjesë.

21A.433 Projekti i riparimit

(a) Kërkuesi për një miratim të projektit të riparimit:

1. Tregon përputhshmëri me bazën e certifikatës tip dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore, të përfshira nëpërmjet referimit në certifikatën tip ose certifikatën tip shtesë, të zbatueshme, ose me ato në fuqi në ditën e kërkesës (për miratimin e projektit të riparimit), si dhe me ndryshime të atyre përcaktimeve të certifikimit ose kushteve të veçanta, të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme për të përcaktuar një nivel sigurie të barabartë me atë të

përcaktuar nga baza e certifikimit tip të përfshirë nëpërmjet referencës në certifikatën tip ose në certifikatën tip shtesë.

2. Paraqet të gjithë të dhënat e nevojshme mbështetëse, kur kërkohen nga Agjencia.

3. Deklaron përputhshmëri me kushtet e certifikatës dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore të germës (a) pika 1.

(b) kur kërkuesi nuk është mbajtës i certifikatës tip ose certifikatës tip shtesë, sikurse është praktika, kërkuesi mund të përmbushë kërkesat e germës (a) përmes përdorimit të burimeve të tij, ose përmes një marrëveshjeje me mbajtësin e një certifikate tip ose certifikate tip shtesë sikurse është e zbatueshme.

21A.435 Klasifikimi i riparimeve

(a) Riparimi mund të jetë “i madh” ose “i vogël”. Klasifikimi bëhet në përputhje me kriteret e 21A.91 për një ndryshim në projektin tip.

(b) Riparimi klasifikohet “i madh” ose “i vogël” sipas germës (a) ose:

1. nga Agjencia, ose

2. nga një sipërmarrje projektuese e miratuar ashtu si duhet sipas një procedure për të cilën është rënë dakord me Agjencinë.

21A.437 Dhënia e miratimit të projektit të riparimit

Kur është deklaruar dhe është treguar se projekti i riparimit përmbush kushtet certifikuese të zbatueshme dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore të 21A.433 germa (a) pika 1, ai miratohet nga:

(a) Agjencia, ose

(b) nga një sipërmarrje e miratuar siç duhet, që është gjithashtu mbajtëse e certifikatës tip ose certifikatës tip shtesë, sipas një procedure për të cilën është rënë dakord me Agjencinë, ose

(c) vetëm për riparimet e vogla, nga një sipërmarrje projektuese e miratuar siç duhet sipas një procedure për të cilën është rënë dakord me Agjencinë.

21A.439 Prodhimi i pjesëve për riparim

Pjesët dhe pajisjet që do të përdoren për riparim, prodhohen në përputhje me të dhënat prodhuese të bazuara në të gjitha të dhënat e nevojshme projektuese, si jepen nga mbajtësi i miratimit të projektit të riparimit:

(a) Sipas nënpjesës F, ose

(b) nga një sipërmarrje e miratuar si duhet në përputhje me nënpjesën G, ose

(c) nga një sipërmarrje mirëmbajtjeje e miratuar si duhet.

21A.441 Realizimi i riparimit

(a) Realizimi i një riparimi bëhet nga një sipërmarrje mirëmbajtjeje e miratuar si duhet, ose nga një sipërmarrje prodhuese e miratuar si duhet në përputhje me nënpjesën G, sipas privilegjit 21A.163.

(b) Sipërmarrje projektuese i transmeton sipërmarrjes që kryen riparimin, të gjithë udhëzimet e nevojshme të montimit.

21A.443 Kufizimet

Një projekt riparimi mund të miratohet në varësi të kufizimeve, rast në të cilin miratimi i projektit të riparimit përfshin të gjitha udhëzimet dhe kufizimet e nevojshme. Këto udhëzime dhe kufizime i transmetohen, nga mbajtësi i miratimit të projektit të riparimit, operatorit, në përputhje me një procedurë për të cilën është rënë dakord me Agjencinë.

21A.445 Dëmi i riparueshëm

(a) Kur një produkt, pjesë ose pajisje e dëmtuar, nuk riparohet, dhe nuk mbulohet nga të dhëna të miratuara më parë, vlerësimi i dëmit për pasojat në aftësinë e fluturimit mund të bëhet vetëm:

1. nga Agjencia, ose

2. nga një sipërmarrje projektuese e miratuar si duhet, sipas një procedure për të cilën është rënë dakord me Agjencinë.

Çdo kufizim i nevojshëm trajtohet në përputhje me procedurat e 21A.443.

(b) Kur sipërmarrja që vlerëson dëmin sipas germës (a) nuk është ose Agjencia ose mbajtësi i certifikatës tip ose certifikatës tip shtesë, kjo sipërmarrje vërtetohet, se informacioni mbi të cilin bazohet vlerësimi është informacioni i duhur, ose nga vetë burimet e sipërmarrjes ose përmes një marrëveshjeje me mbajtësin e certifikatës tip ose të certifikatës tip shtesë, ose me prodhuesin, sikurse është praktika.

21A.447 Mbajtja e të dhënave

Për çdo riparim, i gjithë informacioni përkatës i projektimit, skicimet, raportet e provave, udhëzimet dhe kufizimet mundësisht të lëshuara në përputhje me 21A.443, arsyetimi për klasifikimin dhe prova e miratimit të projektit:

(a) mbahet nga mbajtësi i miratimit të projektit të riparimit në dispozicion të Agjencisë, dhe

(b) ruhet nga mbajtësi i miratimit të projektit të riparimit me qëllim për të dhënë informacionin e nevojshëm për të siguruar vazhdimësinë e aftësisë për të fluturuar të produkteve, pjesëve ose pajisjeve të riparuar.

21A.449 Udhëzimet për aftësinë e vazhdueshme të fluturimit

(a) Mbajtësi i miratimit të projektit të riparimit siguron të paktën një set të plotë të atyre ndryshimeve të udhëzimeve për aftësinë e vazhdueshme të fluturimit, të cilat rezultojnë nga projekti i riparimit, duke përfshirë të dhëna përshkruese dhe udhëzime ekzekutuese, të përgatitura në përputhje me kërkesat e zbatueshme, për secilin operator të avionit, ku përfshihet riparimi. Produkti, pjesa ose pajisja e riparuar mund të futet në shërbim përpara se ndryshimet e këtyre udhëzimeve të kenë përfunduar, por kjo do të jetë për një periudhë të kufizuar shërbimi, dhe në marrëveshje me Agjencinë. Disponueshmëria e ndonjë manuali ose e ndonjë pjese të ndryshimeve të udhëzimeve për aftësinë e vazhdueshme të fluturimit, që trajtojnë riparimin ose forma të tjera të mirëmbajtjes së rëndë, mund të vonohen deri pasi produkti të jetë vënë në shërbim, por duhet të jetë i disponueshëm përpara se ndonjë nga produktet të arrijë moshën ose orët/ciklet e fluturimit përkatës.

(b) Nëse përditësimet e këtyre ndryshimeve të udhëzimeve për aftësinë e vazhdueshme të fluturimit lëshohen nga mbajtësi i miratimit të projektit të riparimit, pasi riparimi është miratuar më parë, ato do t'i sigurohen çdo operatori, dhe sipas kërkesave do të vihen në dispozicion të çdo personi tjetër që duhet të përmbushë ndonjë nga kushtet e atyre ndryshimeve të udhëzimeve. Një program që tregon sesi shpërndahen përditësimet e këtyre ndryshimeve të udhëzimeve për aftësinë e vazhdueshme të fluturimit i dorëzohet Agjencisë.

21A.451 Detyrimet dhe shënimi MEP

(a) Secili mbajtës i një miratimi të projektit të një riparimi të madh:

1. Merr përsipër detyrimet:

(i) e përcaktuara në 21A.3, 21A.3B, 21A.4, 21A.439, 21A.441, 21A.443, 21A.447 dhe 21A.449;

(ii) e nënkuptuara në bashkëpunim me mbajtësin e certifikatës tip ose certifikatës tip shtesë ose të dyja, sipas 21A.433 germa (b), si të jetë e përshtatshme.

2. Përcakton shënimin, duke përfshirë germat MEP (Miratimi European i Pjesës) në përputhje me 21A.804 germa (a).

(b) Me përjashtim të mbajtësit të certifikatës tip për të cilin bëhet kërkesë 21A.44, mbajtësi i një miratimi të projektit riparues të vogël:

1. merr përsipër detyrimet e përcaktuara në 21A.4, 21A.447 dhe 21A.449; dhe

2. përcakton shënimin, duke përfshirë germat MEP, në përputhje me 21A.804 germa (a).

(NËNPJESA N – E PAZBATUESHME)

NËNPJESA O – AUTORIZIMET E URDHËRAVE TË STANDARDEVE TEKNIKE EUROPIANE

21A.601 Qëllimi

(a) Kjo nënpjesë përcakton procedurën për lëshimin e autorizimeve të Urdhrit Teknik Standard European dhe rregullat që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e kërkuesve për, ose mbajtësve të autorizimeve të tilla.

(b) Për qëllim të kësaj nënpjese:

1. “Objekt” nënkupton çdo pjesë dhe pajisje që përdoret në avionët civilë.
2. “Urdhri Standard Teknik European” (përmendur në këtë pjesë si “ETSO”) është një kusht i hollësishëm i aftësisë për të fluturuar i lëshuar nga Agjencia për të siguruar përputhshmëri me kërkesat thelbësore të Rregullores bazë dhe është një standard minimal i rendimentit për objektet e përcaktuara.
3. Një objekt i prodhuar sipas një autorizimi ETSO është një objekt i miratuar për qëllimin e nënpjesës K.

21A.602A E drejta për t’u përzgjedhur

Çdo person fizik ose juridik që prodhon ose përgatitet për të prodhuar një objekt ETSO, dhe që ka dëshmuar ose është në procesin e dëshmimit, të aftësisë së tij sipas 21A.602B, ka të drejtë të bëjë kërkesë për një autorizim ETSO.

21A.602B Dëshmimi e aftësisë

Çdo kërkues për një autorizim ETSO dëshmon aftësinë e tij si vijon:

(a) për të prodhuar, duke pasur një miratim të sipërmarrjes prodhuese, të lëshuar në përputhje me nënpjesën G ose përmes zbatimit të procedurave të nënpjesës F; dhe

(b) për të projektuar:

1. për një njësi ndihmëse të energjisë, duke pasur një miratim të sipërmarrjes prodhuese, të lëshuar nga Agjencia në përputhje me nënpjesën J;
2. për të gjitha objektet e tjera, duke përdorur procedurat që vendosin praktikatat e caktuara projektuese, burimet dhe radhën e aktiviteteve të nevojshme për t’u përputhur me këtë pjesë.

21A.603 Kërkesa

(a) Kërkesa për një autorizim ETSO bëhet në një formë dhe mënyrë të përcaktuar nga Agjencia dhe përfshin një përmbledhje të informacionit të kërkuar nga 21A.605.

(b) Kur një seri e ndryshimeve të vogla në përputhje me 21A.611 parashikon që kërkuesi duhet të parashtrojë në kërkesën e tij, numrin e modelit bazë të objektit dhe numrat e pjesës shoqëruese me kllapa të hapura pas tij, për të treguar që germa ose numra ndryshues të parashtesës (ose kombinim i tyre) do të shtohen herë pas here.

21A.604 Autorizimi ETSO për një Njësi Ndihmëse të Energjisë (APU)

Në lidhje me autorizimin ETSO për një njësi ndihmëse të energjisë:

(a) 21A.15, 21A.16B, 21A.17, 21A.20, 21A.21, 21A.31, 21A.33, 21A.44 zbatohen duke u shmangur nga 21A.603, 21A.606 germa (c), 21A.610 dhe 21A.615, por autorizimet ETSO lëshohen në përputhje me 21A.606 në vend të certifikatës tip;

(b) nënpjesa D ose nënpjesa E e kësaj pjese 21 zbatohet për miratimin e ndryshimeve projektuese duke u shmangur nga 21A.611. Kur përdoret nënpjesa E, në vend të certifikatës tip shtesë lëshohet autorizim ETSO i veçantë.

21A.605 Kërkesat e të dhënave

Kërkuesi i dorëzon Agjencisë dokumentet e mëposhtme:

- (a) Një deklaratë të përputhshmërisë që certifikon se kërkuesi ka përmbushur kërkesat e kësaj nënpjesë.
- (b) Një Deklaratë të Projektit dhe Rendimentit (DPP).
- (c) Një kopje të të dhënave teknike të kërkuara në ETSO-n e zbatueshme.
- (d) Përshkrimin (ose një referencë të përshkrimit) të përmendur në 21A.143 për qëllimin e marrjes së një miratimi të përshtatshëm të sipërmarrjes prodhuese sipas nënpjesës G, ose manualin (ose një referencë të manualit) të përmendur në 21A.125 germa (b) për qëllimin e prodhimit sipas nënpjesës F pa miratimin e sipërmarrjes prodhuese.
- (e) Për një APU, manual (ose referencë të manualit) të përmendur në 21A.243 për qëllimin e marrjes së një miratimi të përshtatshëm të sipërmarrjes prodhuese sipas nënpjesës J.
- (f) Për të gjitha objektet e tjera, procedurat e përmendura në 21A.602B germa (b) pika 2.

21A.606 Dhënia e autorizimit ETSO

Kërkuesi ka të drejtën t'i lëshohet autorizimi ETSO nga Agjencia pasi:

- (a) të ketë dëshmuar aftësinë e tij në përputhje me 21A.602B; dhe
- (b) të ketë dëshmuar se objekti përputhet me kushtet teknike të ETSO-s së zbatueshme dhe të ketë dorëzuar deklaratën përkatëse të përputhshmërisë;
- (c) të tregojë se është në gjendje të zbatojë 21A.3 germat (b) dhe (c).

21A.607 Privilegjet e autorizimit ETSO

Mbajtësi i një autorizimi ETSO ka të drejtën të prodhojë dhe shënojë objektin me shenjën e përshtatshme të ETSO-s.

21A.608 Deklarata e Projektit dhe Rendimentit (DPP)

(a) DPP-ja përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

1. Informacionin që i përket 21A.31 germat (a) dhe (b), duke identifikuar objektin dhe standardin e projektit dhe testimit të tij.
 2. Rendimentin e klasifikuar të objektit, ku të jetë e përshtatshme, ose drejtpërsëdrejti ose duke iu referuar dokumenteve të tjera shtesë.
 3. Një deklaratë përputhshmërie që certifikon se objekti ka përmbushur ETSO-n e përshtatshme.
 4. Referencë të raporteve të provave/testeve.
 5. Referencë të manualeve të duhura të mirëmbajtjes, përmirësimit dhe riparimit.
 6. Nivelet e përputhshmërisë, ku nivele të ndryshme të përputhshmërisë lejohen nga ETSO.
 7. Listën e devijimeve të pranuar në përputhje me 21A.610.
- (b) DPP-ja vërtetohet me datën dhe nënshkrimin e mbajtësit të autorizimit ETSO, ose përfaqësuesit të tij të autorizuar.

21A.609 Detyrimet e mbajtësve të autorizimeve ETSO

Mbajtësi i një Autorizimi ETSO sipas kësaj nënpjesë:

- (a) Prodhon çdo objekt në përputhje me nënpjesën G ose nënpjesën F që siguron se çdo objekt i përfunduar përputhet me të dhënat e tij projektuese dhe është i sigurt për montim;
- (b) përgatit dhe mirëmban, për çdo model të çdo objekti për të cilin një autorizim ETSO është lëshuar, një dosje aktuale të të dhënave teknike të plota dhe rekorde në përputhje me 21A.613;

- (c) përgatit, mirëmban dhe përditëson origjinalet e të gjitha manualeve të kërkuara nga kushtet e zbatueshme të aftësisë për të fluturuar, për objektin;
- (d) kur i kërkohet, u mundëson përdoruesve të objektit dhe Agjencisë këto manuale mirëmbajtjeje, përmirësimi dhe riparimi të nevojshëm për përdorimin dhe mirëmbajtjen e objektit, si dhe ndryshimet e këtyre manualeve;
- (e) shënon çdo objekt në përputhje me 21A.807; dhe
- (f) përputhet me 21A.3 germa (b) dhe (c), 21A.3B dhe 21A.4;
- (g) vazhdon të përmbushë kërkesat kualifikuese të 21A.602B.

21A.610 Miratimi për devijimin

- (a) Çdo prodhues që kërkon miratimin për të devijuar nga ndonjë standard i rendimentit së një ETSO-je dëshmon se standardet nga të cilat kërkohet të devijohet janë kompensuar nga faktorë ose karakteristika projektuese që japin një nivel të barasvlefshëm të sigurisë.
- (b) Kërkesa për miratimin e devijimit, së bashku me të dhënat përkatëse i paraqiten Agjencisë.

21A.611 Ndryshimet e projektit

- (a) Mbjtësi i autorizimit ETSO mund të bëjë ndryshime të vogla në projekt (çdo ndryshim tjetër nga një ndryshim i madh) pa autorizim tjetër nga Agjencia. Në këtë rast, objekti i ndryshuar mban numrin e modelit origjinal (ndryshimet e numrit të pjesës ose ndryshimet do të përdoren për të identifikuar ndryshimet e vogla) dhe mbajtësi i përcjell Agjencisë çdo të dhënë të rishikuar që është e nevojshme për të qenë në përputhje me 21A.603 germa (b).
- (b) Çdo ndryshim në projekt nga mbajtësi i autorizimit ETSO që është aq i gjerë sa mjafton për të kërkuar një investigim të plotë, të konsiderueshëm, për të përcaktuar përputhshmërinë me një ETSO, është një ndryshim i madh. Përpara se të bëjë një ndryshim të tillë, mbajtësi bën një përcaktim të ri lloji ose modeli për objektin, dhe bën kërkesë për një autorizim të ri sipas 21A.603.
- (c) Asnjë ndryshim në projekt nga ndonjë person juridik ose fizik që nuk janë mbajtës të autorizimit ETSO, që kanë paraqitur deklaratën e përputhshmërisë për objektin, nuk mund të pranohet për miratim sipas kësaj nënpjesë, vetëm me përjashtim të rasteve kur personi që kërkon miratimin bën kërkesë sipas 21A.603 për një autorizim ETSO të veçantë.

21A.613 Mbajtja e të dhënave

Përveç kërkesave për mbajtjen e të dhënave të përshtatshme me, ose që kanë të bëjnë me sistemin e cilësisë, i gjithë informacioni projektues përkatës, skicimet dhe raportet e provave, duke përfshirë të dhënat e inspektimit për objektin e testuar, mbahet në dispozicion të Agjencisë dhe ruhet me qëllim për të siguruar informacionin e nevojshëm për të garantuar aftësinë e vazhdueshme të objektit për të fluturuar dhe të produktit të certifikuar tip në të cilin përshtatet.

21A.615 Inspektimet e Agjencisë

Me kërkesë të Agjencisë, çdo kërkues ose mbajtës i një autorizimi ETSO për një objekt e lejon Agjencinë:

- (a) Të jetë e pranishme gjatë çdo prove.
- (b) Të inspektojë dosjet e të dhënave teknike të atij objekti.

21A.619 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e vazhdueshme

- (a) Autorizimi ETSO lëshohet për një kohëzgjatje të pakufizuar. Ai mbetet i vlefshëm në rastet kur:
 1. Kushtet e kërkuara kur u dha autorizimi ETSO nuk po respektohen më; ose
 2. detyrimet e mbajtësit të përcaktuara në 21A.609 nuk po përmbushen më; ose
 3. objekti ka provuar të shkaktojë rreziqe të papranueshme në shërbim; ose

4. autorizimi është dorëzuar ose shfuqizuar sipas procedurave administrative të zbatueshme të caktuara nga Agjencia.

(b) Me t'u dorëzuar ose shfuqizuar, certifikata i kthehet Agjencisë.

21A.621 Transferueshmëria

Përveç rastit kur ndryshon pronësia e mbajtësit, i cili shihet si një ndryshim i rëndësishëm dhe për rrjedhojë siç është praktika, përputhet me 21A.147 dhe 21A.247, Autorizimi ETSO që lëshohet sipas kësaj pjese nuk transferohet.

(NËNPJESA P – E PAZBATUESHME)

NËNPJESA Q – IDENTIFIKIMI I PRODUKTEVE, PJESËVE DHE PAJISJEVE

21A.801 Identifikimi i produkteve

(a) Identifikimi i produkteve përfshin informacionin e mëposhtëm:

1. Emrin e prodhuesit

2. Projektimin e produktit

3. Numrin serial të prodhuesit

4. Çdo informacion tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga Agjencia.

(b) Çdo person fizik ose juridik që prodhon një avion ose motor sipas nënpjesës G ose nënpjesës F identifikon që avioni ose motori përmes një pllake zjarrduruese, që ka informacionin e përcaktuar në germën (a) të shënuar mbi të duke e printuar, stampuar, gdhendur, ose metoda të tjera të miratuara për të shënuar se është zjarrduruese. Pllaka identifikuese sigurohet në një mënyrë të tillë që të jetë e arritshme dhe e lexueshme, dhe të mos ketë mundësi të zhduket ose hiqet gjatë shërbimit normal, ose të humbasë apo të shkatërrohet në aksident.

(c) Çdo person fizik ose juridik që prodhon një helikë thikë, ose bosht helike, sipas nënpjesës G ose nënpjesës F e identifikon atë përmes një pllake duke e printuar, stampuar, gdhendur ose me metoda të tjera të miratuara të identifikimit të shenjës së rezistencës ndaj zjarrit, që vendoset mbi të në një sipërfaqe jokritike, e përmban informacionin e përcaktuar në germën (a) dhe nuk ka të ngjarë të zhduket ose hiqet gjatë shërbimit normal, ose të humbasë ose shkatërrohet në një aksident.

(d) Për balonat, pllaka identifikuese e përshtuar në germën (b) fiksohet në mbulesën e balonës dhe vendoset, nëse është e mundur, aty ku është e lexueshme për operatorin, kur balona është fryrë. Gjithashtu, çdo bashkim shporte dhe ngrohësi shënohen në mënyrë të përhershme dhe të lexueshme me emrin e prodhuesit, numrin e pjesës ose ekuivalentin e tij, dhe numrin serial ose ekuivalentin e tij.

21A.803 Trajtimi i të dhënave identifikuese

(a) Asnjë person nuk heq, ndryshon ose vendos informacion identifikues të përmendur në 21A.801 germa (a) mbi një avion, motor, helikë, thikë helike, ose bosht helike, ose në 21A.807 germa (a) mbi një APU, pa miratimin e Agjencisë.

(b) Asnjë person nuk heq ose monton ndonjë pllakë identifikimi të përmendur në 21A.801, ose në 21A.807 për një APU, pa miratimin e Agjencisë.

(c) Duke u shmangur nga gerrat (a) dhe (b), çdo person fizik ose juridik që kryen punë mirëmbajtjeje, sipas rregullave shoqëruese në fuqi për vënien në zbatim, në përputhje me metodat, teknikat dhe praktikat e caktuara nga Agjencia mund të:

1. heqë, ndryshojë ose vendosë informacionin identifikues të përmendur në 21A.801 germa (a) mbi çdo avion, motor, helikë, thikë helike ose bosht helike, ose në 21A.807 germa (a) mbi një APU; ose

2. të heqë një pllakë identifikuese të përmendur në 21A.801, ose 21A.807 për një APU, kur nevojitet gjatë operimeve të mirëmbajtjes.

(d) Askush nuk monton pllaka identifikuese të hequra në përputhje me germën (c) pika 2 mbi një avion, motor, helikë, thikë helike, ose bosht helike, përveç se në atë nga e cila u hoq.

21A.804 Identifikimi i pjesëve dhe pajisjeve

(a) Çdo prodhues i një pjese ose pajisjeje shënon në mënyrë të përhershme dhe të lexueshme pjesën ose pajisjen me:

1. një emër, marka e fabrikës, ose simbol që identifikon prodhuesit; dhe
2. numrin e pjesës, si përcaktohet në të dhënat projektuese të zbatueshme; dhe
3. germat MEP (Miratimi Europian i Pjesës) për pjesët ose pajisjet e prodhuara në përputhje me të dhënat projektuese të miratuara, që s'i përkasin mbajtësit të certifikatës tip të produktit përkatës, përveç se për objektet ETSO.

(b) Duke u shmangur nga germa (a), nëse Agjencia bie dakord që një pjesë ose pajisje është shumë e vogël, ose që nuk është praktike për të shënuar në pjesë ose pajisje çdo informacion të kërkuar sipas germës (a). Informacioni që mund të shënohet mbi këtë pjesë përfshihet në dokumentin lëshues të autorizuar që shoqëron pjesën ose pajisjen, ose në kutinë e saj.

21A.805 Identifikimi i pjesëve kritike

Krahas kërkesës së 21A.804, çdo prodhues i një pjese, që do të vendoset në ndonjë produkt të certifikuar tip, i cili është identifikuar si një pjesë kritike, shënon në mënyrë të përhershme dhe të lexueshme mbi atë pjesë numrin e pjesës dhe një numër serial.

21A.807 Identifikimi i objekteve ETSO

(a) Çdo mbajtës i një autorizimi ETSO sipas nënpjesës O shënon në mënyrë të përhershme dhe të lexueshme çdo objekt me informacionin e mëposhtëm:

1. emrin dhe adresën e prodhuesit;
2. emrin, llojin, numrin e pjesës ose projektimin e modelit të objektit;
3. numrin serial ose datën e prodhimit të objektit ose të dyja; dhe
4. numrin e zbatueshëm ETSO.

(b) Duke u shmangur nga germa (a), nëse Agjencia bie dakord që një pjesë është shumë e vogël ose që nuk është praktike të shënojë një pjesë me çdo informacion të kërkuar nga germa (a), përfshin informacionin që nuk mund të shënohet mbi këtë pjesë, në dokumentin lëshues të autorizuar që shoqëron pjesën ose kutinë e saj.

(c) Çdo person që prodhon një APU sipas nënpjesës G ose nënpjesës F identifikon që APU-ja përmes një pllake zjarrduruese, që ka informacionin e përcaktuar në germën (a) të shënuar mbi të duke e printuar, stampuar, gdhendur ose me metoda të tjera të miratuara të shenjës së zjarrdurueshmërisë. Pllaka identifikuese fiksohet në një mënyrë të tillë që të jetë e arritshme dhe e lexueshme dhe të mos mund të zhduket ose të hiqet gjatë shërbimit normal, ose të mos humbasë ose shkatërrohet në aksident.

SEKSIONI B PROCEDURAT PËR AUTORITETET KOMPETENTE

NËNPJESA A – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

21B.5 Qëllimi

(a) Ky seksion përcakton procedurën për autoritetin kompetent të Shtetit Anëtar në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësisë të tij lidhur me lëshimin, mirëmbajtjen, ndryshimin, pezullimin dhe shfuqizimin e certifikatave, miratimeve dhe autorizimeve të përmendura në këtë pjesë.

(b) Agjencia zhvillon në përputhje me nenin 14 të Rregullores bazë kushtet certifikuese dhe materialet udhëzuese për të asistuar Shtetet Anëtare në zbatimin e këtij seksioni.

21B.20 Detyrimet e autoritetit kompetent

Çdo autoritet kompetent i Shtetit Anëtar është përgjegjës për zbatimin e seksionit A, nënpjesët F,G,H dhe I vetëm për kërkuesit ose mbajtësit, vendi kryesor i biznesit të të cilëve është në territorin e tij.

21B.25 Kërkesat për sipërmarrjen e autoritetit kompetent

(a) Të përgjithshme:

Shteti Anëtar përcakton një autoritet kompetent me përgjegjësi të caktuara për zbatimin e seksionit A, nënpjesët F,G,H dhe I me procedurat e dokumentuara, strukturën e sipërmarrjes dhe personelin.

(b) Burimet:

1. Numri i personelit duhet të jetë i mjaftueshëm për të kryer detyrat e caktuara.

2. Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar emëron një menaxher ose menaxherë, që janë përgjegjës për ekzekutimin e detyrës/detyrave të caktuara brenda autoritetit, duke përfshirë komunikimin me Agjencinë dhe autoritetet e tjera kombëtare, si të jetë e përshtatshme.

(c) Kualifikimi dhe trajnimi:

I gjithë personeli kualifikohet si duhet dhe ka njohuritë, përvojën dhe trajnimin e mjaftueshëm për të kryer detyrat që u janë caktuar.

21B.30 Procedurat e dokumentuara

(a) Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar përcakton procedurat e dokumentuara për të përshkruar sipërmarrjen e tij, mjetet dhe metodat për të përmbushur kërkesat e kësaj pjese. Procedurat mbahen të përditësuara dhe shërbejnë si dokumente bazë pune brenda atij autoriteti për të gjitha aktivitetet përkatëse.

(b) Një kopje e procedurave dhe ndryshimet e tyre i vihen në dispozicion Agjencisë.

21B.35 Ndryshimet në sipërmarrje dhe procedurat

(a) Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar i bën të ditur Agjencisë çdo ndryshim të rëndësishëm në sipërmarrjen dhe procedurat e dokumentuara të Agjencisë.

(b) Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar përditëson në kohë procedurat e tij të dokumentuara, lidhur me çdo ndryshim në rregulloret për të siguruar zbatimin të efektshëm.

21B.40 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

(a) Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar përcakton brenda procedurave të dokumentuara të sipërmarrjes së tij një proces për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

(b) Kur ndërmjet autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare ka një mosmarrëveshje që nuk mund të zgjidhet, sikurse përcaktohet në 21B.25 germa (b) pika 2, menaxherët kanë përgjegjësinë të kërkojnë ndërmjetësimin e Agjencisë për çështjen në fjalë.

21B.45 Raportimi/koordinimi

(a) Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar siguron koordinimin sikurse është e zbatueshme, me ekipet e tjera përkatëse të certifikimit, hetimit, miratimit ose autorizimit të atij autoriteti, Shteteve të tjera Anëtare dhe Agjencisë për të siguruar shkëmbim efikas të informacionit, që lidhet me sigurinë e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve.

(b) Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar njofton Agjencinë për çdo vështirësi në zbatimin e kësaj pjese.

21B.55 Mbajtja e të dhënave

Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar mban ose ruan akses në të dhënat e përshtatshme lidhur me certifikimet, miratimet dhe autorizimet që ka lëshuar në përputhje me rregulloret kombëtare përkatëse, dhe për të cilat përgjegjësia i transferohet Agjencisë, për aq kohë sa këto të dhëna nuk i janë transferuar Agjencisë.

21B.60 Direktivat e aftësisë për të fluturuar

Kur një autoritet kompetent i një Shteti Anëtar merr një direktivë të aftësisë për të fluturuar nga autoriteti kompetent i një shteti jo anëtar, kjo direktivë e aftësisë për të fluturuar i transferohet Agjencisë për shpërndarje, në përputhje me nenin 15 të Rregullores bazë.

NËNPJESA B – CERTIFIKATAT TIP DHE CERTIFIKATAT TIP TË KUFIZUARA

Zbatohen procedura administrative të përcaktuara nga Agjencia.

(NËNPJESA C – E PAZBATUESHME)

NËNPJESA D – NDRYSHIMET E CERTIFIKATAVE TIP DHE CERTIFIKATAVE TIP TË KUFIZUARA

Zbatohen procedura administrative të përcaktuara nga Agjencia.

NËNPJESA E – CERTIFIKATAT TIP SHITESË

Zbatohen procedura administrative të përcaktuara nga Agjencia

NËNPJESA F – PRODHIMI PA MIRATIMIN E SIPËRMARRJES PRODHUESE

21B.120 Hetimi

(a) Autoriteti kompetent cakton një grup investigimi për çdo kërkues për ose mbajtës të një letërmarrëveshjeje, për të kryer të gjitha detyrat përkatëse në lidhje me këtë letërmarrëveshje, i cili konsiston në një drejtues grupi për të menaxhuar dhe drejtuar grupin hetues, dhe nëse kërkohet, një ose më shumë anëtarë grupi. Drejtuesi i grupit i raporton menaxherit përgjegjës për aktivitetin, siç përcaktohet në 21B.25 germa (b) pika 2.

(b) Autoriteti kompetent kryen aktivitete hetuese të mjaftueshme për një kërkues për ose mbajtës të një letërmarrëveshjeje, për të justifikuar rekomandimet për lëshimin, mirëmbajtjen, ndryshimin, pezullimin ose shfuqizimin e letërmarrëveshjes.

(c) Autoriteti kompetent përgatit procedurat për investigimin e kërkuesve për, ose mbajtësve të një letërmarrëveshjeje si pjesë e procedurave të dokumentuara që mbulojnë të paktën elementet e mëposhtëm:

1. vlerësimi i kërkesave të marra;
2. përcaktimin e grupit hetues;
3. përgatitja dhe planifikimi i hetimit;
4. vlerësimi i dokumentacionit (manuali, procedurat, etj.);
5. auditimi dhe inspektimi;
6. ndjekja e veprimeve korigjuese; dhe
7. rekomandimin për lëshimin, ndryshimin, pezullimin ose shfuqizimin e letërmarrëveshjes.

21B.130 Lëshimi i letërmarrëveshjes

- (a) Kur autoriteti kompetent përfundon se prodhuesi përmbush kërkesat e zbatueshme të seksionit A, nënpjesa F, ai, pa vonesa të pajustificueshme, lëshon një letërmarrëveshje për të treguar përputhshmërinë e produkteve, pjesëve ose pajisjeve individuale (Formulari EASA 65, shiko shtojcën).
- (b) Letërmarrëveshja përmban qëllimin e marrëveshjes, datën e përfundimit, dhe kur është e zbatueshme, kufizimet e përshtatshme lidhur me autorizimin.
- (c) Kohëzgjatja e letërmarrëveshjes nuk është më shumë se një vit.

21B.135 Mbajtja e letërmarrëveshjes

Autoriteti kompetent mban letërmarrëveshjen për sa kohë që:

- (a) prodhuesi përdor siç duhet Formularin EASA 52 (shiko shtojcën) si një deklaratë të përputhshmërisë për të gjithë avionin, dhe Formularin EASA 1 (shiko shtojcën) për produktet që nuk janë avion i plotë, pjesët dhe pajisjet; dhe
- (b) inspektimet e kryera nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar përpara vleftësimit të formularit EASA 52 (shih shtojcën) ose formularit EASA 1 (shih shtojcën), si për 21A.130 germa (c) dhe nuk japin ndonjë përfundim mospërputhjeje ndaj kërkesave ose procedurave që përfshihen në manualin e siguruar nga prodhuesi, ose ndaj përputhshmërisë së produkteve, pjesëve ose pajisjeve përkatëse. Këto inspektime kontrollojnë të paktën që:
1. marrëveshja mbulon produktin, pjesën ose pajisjen që vleftësohet dhe mbetet e vlefshme;
 2. manuali i përshkruar në 21A.125 germa (b) dhe statusi i tij i ndryshuar, i përmendur në letërmarrëveshjen e lëshuar si dokumenti bazë i punës nga prodhuesi. Në të kundërt, inspektimi nuk vazhdon dhe për rrjedhojë certifikatat e lëshimit nuk do të vleftësohen;
 3. prodhimi është kryer sipas kushteve të përshkruara në letërmarrëveshjen dhe është realizuar në mënyrë të kënaqshme;
 4. inspektimet dhe testet (përfshirë testet e fluturimit, nëse është e përshtatshme) si për 21A.130 germa (b) pika 2 dhe/ose germa (b) pika 3, janë kryer sipas kushteve të përshkruara në letërmarrëveshjen dhe janë realizuar në mënyrë të kënaqshme;
 5. inspektimet e autoritetit kompetent të përshkruara ose trajtuara në letërmarrëveshje janë kryer dhe janë gjetur të pranueshme;
 6. deklaratata e përputhshmërisë përputhet me 21A.130, dhe informacioni i siguruar nga ajo nuk e pengon vleftësimin e saj; dhe
- (c) nuk është arritur ndonjë datë përfundimi për letërmarrëveshjen.

21B.140 Ndryshimi i një letërmarrëveshjeje

- (a) Autoriteti kompetent heton, si të jetë e përshtatshme, në përputhje me 21B.120 çdo ndryshim të letërmarrëveshjes.
- (b) Kur një autoritet kompetent përfundon se kërkesat e seksionit A, nënpjesa F vazhdojnë të përmbushen, ndryshon letërmarrëveshjen përkatësisht.

21B.143 Njoftimi i përfundimeve

- (a) Kur autoriteti kompetent gjen prova objektive, që tregojnë se mbajtësi i një letërmarrëveshjeje nuk respekton kërkesat e zbatueshme të kësaj pjese, ky përfundim klasifikohet në përputhje me 21A.125B dhe:
1. Përfundimet e nivelit të parë i bëhen të ditura menjëherë mbajtësit të letërmarrëveshjes dhe konfirmohen me shkrim brenda 3 ditë pune pas vendimit.
 2. Përfundimet e nivelit të dytë i konfirmohen me shkrim mbajtësit të letërmarrëveshjes brenda 14 ditë pune pas vendimit.
- (b) Autoriteti kompetent i identifikon mbajtësit të letërmarrëveshjes çdo përfundim të nivelit të tretë, siç përcaktohet në 21A.125B germa (b), përmes mjeteve të përshtatshme, si të jetë e përshtatshme për të.

21B.145 Pezullimi dhe shfuqizimi i një letërmarrëveshjeje

(a) Kur arrihen përfundime të nivelit të parë ose të dytë, autoriteti kompetent kufizon pjesërisht ose plotësisht, pezullon, ose shfuqizon letërmarrëveshjen si më poshtë:

1. kur arrihen përfundime të nivelit të parë letërmarrëveshja kufizohet ose pezullohet menjëherë. Nëse mbajtësi i letërmarrëveshjes nuk arrin të jetë në përputhje me 21A.125B germa (c) pika 1, letërmarrëveshja shfuqizohet.

2. kur arrihen përfundime të nivelit të dytë, autoriteti kompetent vendos për çdo kufizim të letërmarrëveshjes, duke e pezulluar përkohësisht letërmarrëveshjen ose pjesë të saj. Nëse mbajtësi i letërmarrëveshjes nuk arrin të jetë në përputhje me 21A.125B germa (c) pika 2, letërmarrëveshja shfuqizohet.

(b) Pezullimi ose shfuqizimi i letërmarrëveshjes i komunikohet me shkrim mbajtësit të letërmarrëveshjes. Autoriteti kompetent konstaton arsyet e kufizimit, pezullimit ose shfuqizimit dhe informon mbajtësin e letërmarrëveshjes mbi të drejtën e tij për apelim.

(c) Kur një letërmarrëveshje është pezulluar, ajo rikthehet në pozitën e mëparshme, pasi të jetë rivendosur përputhshmëria me Seksionin A, Nënpjesa F.

21B.150 Mbajtja e të dhënave

(a) Autoriteti kompetent përcakton një sistem të mbajtjes së të dhënave, që lejon ndjekjen e përshtatshme të procesit për lëshimin, mirëmbajtjen, ndryshimin, pezullimin ose shfuqizimin e çdo letërmarrëveshjeje individuale.

(b) Të dhënat duhet të përmbajnë të paktën:

1. dokumentet e siguruar nga kërkuesi për, ose mbajtësi i një letërmarrëveshjeje,

2. dokumentet e përcaktuara gjatë investigimit dhe inspektimit, në të cilat janë paraqitur aktivitetet dhe rezultatet përfundimtare të elementeve të përcaktuara në 21B.120,

3. letërmarrëveshja, duke përfshirë ndryshimet, dhe

4. procesverbalet e takimeve me prodhuesin.

(c) Të dhënat arkivohen për një periudhë minimale të ruajtjes prej gjashtë vjetësh pas përfundimit të letërmarrëveshjes.

(d) Autoriteti kompetent i mban të dhënat e të gjitha deklaratave të përputhshmërisë (Formulari EASA 52, shih shtojcën) dhe certifikatat e autorizuara të lëshimit (Formulari EASA 1, shih shtojcën) të cilat i ka bërë të vlefshme.

NËNPJESA G – MIRATIMI I SIPËRMARRJES PRODHUESE

21B.220 Hetimi

(a) Autoriteti kompetent cakton një grup miratimi të sipërmarrjes prodhuese për çdo kërkues ose mbajtës të një miratimi të sipërmarrjes prodhuese, të kryejë çdo detyrë përkatëse në lidhje me këtë miratim të sipërmarrjes prodhuese, i cili përbëhet nga një drejtues grupi për të menaxhuar dhe drejtuar grupin e miratimit, dhe nëse kërkohet, një ose më shumë anëtarë grupi. Drejtuesi i grupit i raporton menaxherit përgjegjës për aktivitetin, siç përcaktohet në 21B.25 germa (b) pika (2).

(b) Autoriteti kompetent kryen aktivitete të mjaftueshme hetimore për një kërkues ose mbajtës të një miratimi të sipërmarrjes prodhuese, për të justifikuar rekomandimet për lëshimin, mbajtjen, ndryshimin, pezullimin ose shfuqizimin e miratimit.

(c) Autoriteti kompetent përgatit procedurat për hetimin, për miratimin e sipërmarrjes prodhuese si pjesë e procedurave të dokumentuara, që përfshijnë të paktën elementet e mëposhtme:

1. vlerësimin e kërkesave të marra;

2. përcaktimin e grupit të miratimit të sipërmarrjes prodhuese;

3. përgatitjet dhe planifikimi i hetimit;

4. vlerësim të dokumentacionit (ekspozeja e sipërmarrjes prodhuese, procedurat, etj.);

5. auditimin;

6. ndjekja e veprimeve korrigjuese;

7. rekomandimet për lëshimin, ndryshimin, pezullimin ose shfuqizimin e miratimit të sipërmarrjes prodhuese;
8. mbikëqyrje e vazhdueshme.

21B.225 Njoftimi i përfundimeve

- (a) Kur gjenden prova objektive që tregojnë mospërputhshmëri të mbajtësit të miratimit të sipërmarrjes prodhuese me kërkesat e zbatueshme të kësaj pjese, ky përfundim klasifikohet në përputhje me 21A.158 germa (a) dhe:
1. Përfundimet e nivelit të parë i njoftohen menjëherë mbajtësit të miratimit të sipërmarrjes prodhuese dhe konfirmohen me shkrim brenda 3 ditë pune pas vendimit.
 2. Përfundimet e nivelit të dytë i konfirmohen me shkrim mbajtësit të miratimit të sipërmarrjes prodhuese brenda 14 ditë pune pas vendimit.
- (b) Autoriteti kompetent i identifikon mbajtësit të miratimit të sipërmarrjes prodhuese çdo përfundim të nivelit të tretë, siç përcaktohet në 21A.158 germa (b), përmes mjeteve të përshtatshme, si të jetë e përshtatshme për të.

21B.230 Lëshimi i certifikatës

- (a) Kur autoriteti kompetent përfundon, se sipërmarrja prodhuese është në përputhje me kërkesat e zbatueshme të seksionit A, nënpjesa G, autoriteti kompetent lëshon miratim të sipërmarrjes prodhuese (Formulari EASA 55, shih shtojcën) pa vonesa të mëtejshme.
- (b) Numri i referencës përfshihet në Formularin EASA 55 në një mënyrë të përcaktuar nga Agjencia.

21B.235 Mbikëqyrja e vazhdueshme

- (a) Me qëllim që të justifikojë mbajtjen e miratimit të sipërmarrjes prodhuese autoriteti kompetent kryen mbikëqyrje të vazhdueshme:
1. për të verifikuar që sistemi i cilësisë i mbajtësit të miratimit të sipërmarrjes prodhuese vazhdon të përputhet me seksionin A, nënpjesa G; dhe
 2. për të verifikuar që sipërmarrja e mbajtësit të miratimit të sipërmarrjes prodhuese operon në përputhje me ekspozenë e sipërmarrjes prodhuese; dhe
 3. për të verifikuar efektshmërinë e procedurave të sipërmarrjes prodhuese; dhe
 4. për të monitoruar nëpërmjet mostrave, standardet e produktit, pjesës ose pajisjes.
- (b) Mbikëqyrja e vazhdueshme kryhet në përputhje me 21B.220.
- (c) Autoriteti kompetent siguron përmes një mbikëqyrjeje të planifikuar të vazhdueshme, se miratimi i sipërmarrjes prodhuese është plotësisht i rishikuar në përputhje me këtë pjesë gjatë një periudhe prej 24 muajsh. Mbikëqyrja e vazhdueshme mund të konsistojë në disa aktivitete hetuese gjatë kësaj periudhe. Numri i auditimeve mund të luhet në varësi të kompleksitetit të sipërmarrjes, numrit të vendndodhjeve dhe rëndësisë së produktit. Së paku, mbajtësi i miratimit të sipërmarrjes prodhuese i nënshtrohet aktivitetit të mbikëqyrjes së vazhdueshme nga autoriteti kompetent, të paktën një herë në vit.

21B.240 Ndryshimet e miratimit të sipërmarrjes prodhuese

- (a) Autoriteti kompetent monitoron çdo ndryshim të vogël përmes aktiviteteve të vazhdueshme të mbikëqyrjes.
- (b) Autoriteti kompetent heton si të jetë e përshtatshme në përputhje me 21B.220, çdo ndryshim të rëndësishëm të miratimit të sipërmarrjes prodhuese, ose çdo kërkesë nga mbajtësi i miratimit të sipërmarrjes prodhuese për një ndryshim të qëllimit dhe kushteve të miratimit.
- (c) Kur autoriteti kompetent përfundon, se vazhdojnë të respektohen kërkesat e seksionit A, nënpjesës G, ai ndryshon miratimin e sipërmarrjes prodhuese.

21B.245 Pezullimi dhe shfuqizimi i miratimit të sipërmarrjes prodhuese

(a) Në rast se arrihen përfundime të nivelit të parë ose të dytë, autoriteti kompetent pjesërisht ose plotësisht kufizon, pezullon ose shfuqizon miratimin e sipërmarrjes prodhuese si vijon:

1. në rast se arrihen përfundime të nivelit të parë, miratimi i sipërmarrjes prodhuese kufizohet ose pezullohet menjëherë. Nëse mbajtësi i miratimit të sipërmarrjes prodhuese nuk respekton 21A.158 germa (c) pika 1, miratimi i sipërmarrjes prodhuese shfuqizohet.

2. në rast se arrihen përfundime të nivelit të dytë, autoriteti kompetent vendos mbi kufizimet me qëllimin e miratimit përmes pezullimit të përkohshëm të miratimit të sipërmarrjes prodhuese ose ndonjë pjese të saj. Nëse mbajtësi i miratimit të sipërmarrjes prodhuese nuk përmbush 21A.158 germa (c) pika 2, miratimi i sipërmarrjes prodhuese revokohet.

(b) Kufizimet, pezullimet ose shfuqizimet e miratimit të sipërmarrjes prodhuese i komunikohen me shkrim mbajtësit të miratimit të sipërmarrjes prodhuese. Autoriteti kompetent konstaton arsyet për pezullimin ose revokimin, dhe informon mbajtësin e miratimit të sipërmarrjes prodhuese mbi të drejtën e tij për apelim.

(c) Kur miratimi i sipërmarrjes prodhuese është pezulluar, ai mund të rikthehet, vetëm pasi të jetë rivendosur përputhshmëria me Seksionin A, nënpjesa G.

21B.260 Mbajtja e të dhënave

(a) Autoriteti kompetent krijon një sistem të mbajtjes së të dhënave që lejon ndjekjen e përshtatshme të procesit të lëshimit, mbajtjes, ndryshimit, pezullimit ose shfuqizimit të çdo miratimi të sipërmarrjeve prodhuese.

(b) Të dhënat përmbajnë të paktën:

1. dokumentet e siguruar nga kërkuesi ose mbajtësi i certifikatës së miratimit të sipërmarrjes prodhuese,

2. dokumentet e përcaktuara gjatë investigimit, në të cilat janë konstatuar aktivitetet dhe rezultatet përfundimtare të elementeve të përcaktuara në 21B.220, duke përfshirë përfundimet e arritura në përputhje me 21B.225,

3. programin e mbikëqyrjes së vazhdueshme, duke përfshirë të dhënat e investigimeve të kryera,

4. certifikatën e miratimit të sipërmarrjes prodhuese, duke përfshirë ndryshimet,

5. procesverbalet e takimeve me mbajtësin e miratimit të sipërmarrjes prodhuese.

(c) Të dhënat arkivohen për një periudhë minimale të ruajtjes prej 6 vjetësh.

NËNPJESA H – CERTIFIKATAT E AFTËSISË PËR TË FLUTURUAR

21B.320 Hetimi

(a) Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit kryen aktivitete hetuese të mjaftueshme për një kërkues për, ose mbajtës të certifikatës së aftësisë për të fluturuar, për të justifikuar lëshimin, mirëmbajtjen, ndryshimin, pezullimin ose shfuqizimin e certifikatës ose të lejes.

(b) Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit përgatit procedurat e vlerësimit, që përfshijnë të paktën elementet e mëposhtme:

1. vlerësimin e të drejtës për t'u përzgjedhur të kërkuesit;

2. vlerësimin e të drejtës për t'u përzgjedhur të kërkesës;

3. klasifikimin e certifikatave të aftësisë për të fluturuar;

4. vlerësimin e dokumentacionit të marrë me kërkesën;

5. inspektimin e avionit.

6. përcaktimin e kushteve të nevojshme, kufizimeve ose limiteve të certifikatave të aftësisë për të fluturuar.

21B.325 Lëshimi i certifikatave të aftësisë për të fluturuar

(a) Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit, sipas praktikës, lëshon, ose ndryshon certifikata të aftësisë për të fluturuar (Formulari EASA 25, shih shtojcën), certifikata të kufizuara të aftësisë për të fluturuar (Formulari EASA 24, shih shtojcën), ose lejet e fluturimit (Formulari EASA 20, shih shtojcën), pa vonesa të pajustificuara kur përfundon se kërkesat e zbatueshme të Seksionit A, nënpjesa H janë plotësuar.

(b) Krahas certifikatës së aftësisë për të fluturuar për një avion të ri ose për një avion të përdorur me origjinë nga një shtet joanëtar, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit lëshon një certifikatë fillestare rishikimi të aftësisë për të fluturuar (Formulari EASA 15a, shih nënshtojcën).

21B.330 Pezullimi dhe shfuqizimi i certifikatave të aftësisë për të fluturuar

(a) Kur ka prova, se disa nga kushtet e përcaktuara në 21A.181 germa (a) nuk janë plotësuar, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit pezullon ose shfuqizon certifikatën e aftësisë për të fluturuar.

(b) Me të dhënë njoftimin e pezullimit dhe shfuqizimit të certifikatës së aftësisë për të fluturuar, certifikatës së kufizuar ose lejes së fluturimit, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit paraqet arsyet për pezullimin ose shfuqizimin, dhe informon mbajtësin e certifikatës ose lejes mbi të drejtën e tij për të apeluar.

21B.345 Mbajtja e të dhënave

(a) Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit krijon një sistem të ruajtjes së të dhënave që lejon ndjekje të mjaftueshme të procesit për të lëshuar, mirëmbajtur, ndryshuar, pezulluar ose shfuqizuar çdo certifikatë individuale të aftësisë për të fluturuar.

(b) Të dhënat përmbajnë të paktën:

1. dokumentet e paraqitura nga kërkuesi,
2. dokumentet e përgatitura gjatë hetimit, në të cilat paraqiten aktivitetet dhe rezultatet përfundimtare të elementeve të përcaktuara në 21B.320 germa (b), dhe
3. një kopje të certifikatës ose lejes, duke përfshirë ndryshimet.

(c) Të dhënat arkivohen për një periudhe minimale të ruajtjes prej 6 vjetësh pas largimit nga ai regjistër kombëtar.

NËNPJESA I – CERTIFIKATAT E ZHURMËS

21B.420 Hetimi

(a) Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit kryen aktivitete hetuese të mjaftueshme për një kërkues për, ose mbajtës të një certifikate të zhurmës për të justifikuar lëshimin, mirëmbajtjen, ndryshimin, pezullimin ose shfuqizimin e certifikatës.

(b) Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit përgatit procedurat e vlerësimit si pjesë e procedurave të dokumentuara që mbulojnë të paktën elementet e mëposhtme:

1. vlerësimin e të drejtës për t'u përzgjedhur;
2. vlerësimin e dokumentacionit të marrë me kërkesën;
3. inspektimin e avionit.

21B.425 Lëshimi i certifikatave të zhurmës

Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit, si të jetë e zbatueshme, lëshon ose ndryshon certifikatat e zhurmës (Formulari EASA 45, shih nënshtojcën) pa vonesa të mëtejshme, kur përfundon se kërkesat e zbatueshme të Seksionit A, nënpjesa I janë plotësuar.

21B.430 Pezullimi dhe shfuqizimi i certifikatës së zhurmës

(a) Kur ka prova, se disa nga kushtet e përcaktuara në 21A.211 germa (a) nuk janë plotësuar, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit pezullon ose shfuqizon një certifikatë zhurme.

(b) Me lëshimin e njoftimit të pezullimit dhe shfuqizimit të një certifikate të zhurmës, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit paraqet arsyet për pezullimin dhe shfuqizimin, dhe informon mbajtësin e certifikatës mbi të drejtën e tij për të apeluar.

21B.445 Mbajtja e të dhënave

(a) Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit krijon një sistem të ruajtjes së të dhënave me kriteret minimale të ruajtjes, që lejojnë ndjekje të mjaftueshme të procesit për të lëshuar, mirëmbajtur, ndryshuar, pezulluar ose shfuqizuar çdo certifikatë individuale të zhurmës.

(b) Të dhënat përmbajnë të paktën:

1. dokumentet e paraqitura nga kërkuesi,
2. dokumentet e përcaktuara gjatë hetimit, në të cilat pasqyrohen aktivitetet dhe rezultatet përfundimtare të elementeve të përcaktuara në 21B.420 germa (b),
3. një kopje të certifikatës duke përfshirë ndryshimet.

(c) Të dhënat arkivohen për një periudhë minimale të ruajtjes prej 6 vjetësh pas largimit nga ai regjistër kombëtar.

NËNPJESA J – MIRATIMI I SIPËRMARRJES PROJEKTUESE

Zbatohen procedura administrative të vendosura nga Agjencia.

NËNPJESA K – PJESËT DHE PAJISJET

Zbatohen procedura administrative të vendosura nga Agjencia.

(NËNPJESA L – E PAZBATUESHME)

NËNPJESA M - RIPARIMET

Zbatohen procedura administrative të vendosura nga Agjencia.

(NËNPJESA N – E PAZBATUESHME)

NËNPJESA O – AUTORIZIMET E URDHËRAVE TË STANDARDEVE TEKNIKE EUROPIANE

Zbatohen procedura administrative të vendosura nga Agjencia.

(NËNPJESA P – E PAZBATUESHME)

NËNPJESA Q – IDENTIFIKIMI I PRODUKTEVE, PJESËVE DHE PAJISJEVE

Zbatohen procedura administrative të vendosura nga Agjencia.

NËNSHTOJCAT

Formularët EASA

Kur formularët e kësaj shtojce lëshohen në një gjuhë ndryshe nga ajo anglisht, ato përfshijnë një përkthim në anglisht.

Formularët EASA ('Agjencia Europiane për Sigurinë e Aviacionit') të përmendur në nënshtojcat e kësaj pjese përmbajnë tiparet e detyrueshme si më poshtë. Shtetet Anëtare sigurohen që formularët EASA të lëshuar nga ata të jenë të dallueshëm dhe janë përgjegjës për printimin e formularëve.

Nënshtojca I – Formulari EASA 1 Certifikata e lëshimit të autorizuar

Nënshtojca II – Formulari EASA 15a Certifikata e rishikimit të aftësisë për fluturim

Nënshtojca III – Formulari EASA 20 Leja e fluturimit

Nënshtojca IV – Formulari EASA 24 Certifikata e kufizuar e aftësisë për fluturim

Nënshtojca V – Formulari EASA 25 Certifikata e aftësisë për fluturim

Nënshtojca VI – Formulari EASA 45 Certifikata e zhurmës

Nënshtojca VII – Formulari EASA 52 Deklarata e përputhshmërisë

Nënshtojca VIII – Formulari EASA 53 Certifikata e lëshimit për shërbim

Nënshtojca IX – Formulari EASA 55 Certifikata e miratimit të sipërmarrjes prodhuese

Nënshtojca X – Formulari EASA 65 Letërmarrëveshje (Prodhim pa POA-në)

1. Autoriteti kompetent miratues/Shteti		Certifikata e lëshimit të autorizuar Formulari EASA 1			3. Numri i gjurmimit të formularit	
4. Emri dhe adresa e sipërmarrjes së miratuar:					5. Urdhri i punës/Kontrata/Fatura	
6. Njësia	7. Përshkrimi	8. Nr. i pjesës	9. Kualifikimi [*]	10. Sasia	11. Nr. serial/grupit	12. Statusi/Puna
13. Komente Numri i miratimit të sipërmarrjes së pjesës M, seksioni A, nënpjesa F: AAA RRR XXXX						
14. Certifikon që produktet e identifikuar më janë prodhuar në përputhje me: <input type="checkbox"/> të dhënat e projektimit të miratuar dhe në gjendje të sigurtë pune <input type="checkbox"/> të dhënat e projektimit të pamiratuar të përcaktuara në fushën 13			19. <input type="checkbox"/> pjesa-145.A.50 Lëshimi për shërbim <input type="checkbox"/> Rregulbre tjetër e përcaktuar në fushën 13 Certifikon që, nëse nuk përcaktohet ndryshe në fushën 13, puna e identifikuar në fushën 12 dhe e përshkruar në fushën 13 u krye në përputhje me pjesën-145 dhe në lidhje me punën e dhënë, produktet gjykohen të gatshëm për lëshim shërbimi.			
15. Firma e autorizuar		16. Numri i autorizimit/miratimit		20. Firma e autorizuar	21. Nr. i referencës së certifikatës/miratimit	
17. Emri		18. Data (d/m/v)		22. Emri	23. Data (d/m/v)	

Formulari EASA 1 – Botimi 1

[*] Montuesi duhet të kontrollojë kualifikimet sipas të dhënave teknike të zbatueshme

Certifikata e lëshimit të autorizuar – Formulari EASA 1 (ana e prapme)

Përgjegjësitë e përdoruesit/montuesit

Shënim:

1. Është e rëndësishme të kuptohet që prania e dokumentit të vetëm nuk jep automatikisht të drejtë për të montuar pjesën/përbërësin/pjesën e montuar
2. Kur përdoruesi/montuesi punon në përputhje me rregullat kombëtare të një autoriteti aftësie fluturimi të ndryshëm nga ai i përcaktuar në fushën 1, është thelbësore që përdoruesi/montuesi të sigurohet që autoriteti i tij/saj i aftësisë së fluturimit pranon pjesë/përbërës/pjesë të montuara nga autoriteti i përcaktuar në fushën 1.
3. Deklaratat 14 dhe 19 nuk përbëjnë një certifikatë montimi. Në të gjitha rastet, regjistri i mirëmbajtjes së avionit përmban një certifikatë montimi të lëshuar në përputhje me rregullat kombëtare nga përdoruesi/montuesi para fluturimit të avionit.

Certifikata e lëshimit të autorizuar – Formulari EASA 1

Udhëzime plotësimi

Këto udhëzimet lidhen vetëm me përdorimin e Formularit EASA 1 për qëllime prodhimi. Duhet pasur parasysh Nënshtojca 1 e pjesës 145 që mbulon përdorimin e Formularit EASA 1 për qëllime mirëmbajtjeje.

1. Qëllimi dhe fusha e zbatimit

Sipas pjesës 21, nënpjesa G, qëllimi parësor i certifikatës është të lëshojë produktet, pjesët, pajisjet (quajtur më poshtë ‘njësi’) dhe/ose materiale të identifikuar në fushat 7 deri në 11 të zbatueshme pas prodhimit, ose të lëshojë për punë mirëmbajtjeje të kryer tek njësitë me miratimin e Autoritetit kompetent. Certifikata me referencë Formulari EASA 1 quhet Certifikata e lëshimit të autorizuar.

Certifikata përdoret për qëllime importi si edhe për qëllime të brendshme dhe brenda Komunitetit dhe shërben si një certifikatë zyrtare për dërgimin e njërive nga prodhuesi tek përdoruesit. Certifikata nuk është një dokument dërgese apo poste.

Ajo mund të lëshohet vetëm nga sipërmarrje të certifikuar nga autoriteti kompetent sipas pjesës 21, nënpjesa G, brenda fushës së zbatimit të një miratimi të tillë. Certifikata nuk mund të përdoret për të autorizuar avionë.

Një përzierje njësisish të ‘reja’ dhe ‘të vjetra’ nuk lejohet në të njëjtën certifikatë.

Një përzierje njësisish në përputhje me ‘të dhëna të miratuara’ dhe ‘të dhëna të pamiratuara’ nuk lejohet në të njëjtën certifikatë, dhe rrjedhimisht, vetëm një kuti mund të shënohet në fushën 14.

Një përzierje pjesësh të lëshuara/autorizuara sipas nënpjesës G dhe F të pjesës 21 nuk lejohet në të njëjtën certifikatë.

2. Të përgjithshme

Certifikata duhet të jetë në përputhje me formatin e bashkëlidhur duke përfshirë numra të dukshëm dhe vendndodhja e çdo fushe. Sidoqoftë, përmasat e çdo fushe mund të ndryshojnë në varësi të kërkesës individuale, por jo në atë masë që e bën certifikatën të padallueshme. Përmasat e përgjithshme të certifikatës mund të zmadhohen ose të zvogëlohen për sa kohë certifikata mbetet e dallueshme dhe e lexueshme.

Lutemi të keni parasysh që deklaratat e përgjegjësisë së përdoruesit vendosen në anën e prapme të certifikatës, por mund t’i shtohen anës së përparme duke zvogëluar thellësinë e formularit.

Shkrimi duhet të jetë i qartë dhe i lexueshëm për të mundësuar një lexim të lehtë.

Certifikata ose mund printohet paraprakisht ose të nxirret me anë të kompjuterit, por në çdo rast printimi i vijave dhe të dhënave duhet të jetë e qartë dhe e lexueshme. Fjalët e printuara paraprakisht janë të lejuara në përputhje me shembullin e bashkëlidhur, por asnjë deklaratë certifikimi tjetër nuk lejohet. Anglishtja, dhe sipas rastit, një ose më shumë gjuhë zyrtare të Shtetit Anëtar lëshues janë të lejuara.

Të dhënat për t’u hedhur në certifikatë mund të jenë ose të printuara me anë të pajisjeve/kompjuterit ose të shkruara me dorë duke përdorur shkronja shtypi të mëdha dhe duhet të jenë të lehta për t’u lexuar. Shkurtime duhet të përdoren sa më pak që të jetë e mundur.

Hapësira në anën e prapme të certifikatës mund të përdoret nga krijuesi fillestar për informacion shtesë, por nuk duhet të shtojë asnjë deklaratë certifikimi.

Certifikata fillestare duhet të shoqërojë njësitë dhe duhet të vendoset një ndërlidhje ndërmjet certifikatës dhe njësiteve. Një kopje e certifikatës duhet të mbahet nga sipërmarrje që prodhoi njësitë. Kur formati i certifikatës dhe të dhënat nxirren krejtësisht nëpërmjet kompjuterit, duke iu nënshtruar pranimit të autoritetit kompetent, është e lejueshme që formati i certifikatës dhe të dhënat të mbahen në një bazë të dhënash të sigurta.

Nuk ka asnjë kufizim në numrin e kopjeve të certifikatës që mund t’i dërgohen klientit ose që mund të mbahen nga krijuesi.

Certifikata që shoqëron njësinë mund t’i bashkëlidhet këtij të fundit duke u vendosur në një zarf për arsye sigurie.

3. Plotësimi i certifikatës së lëshimit nga krijuesi

Me përjashtim kur shprehet ndryshe, që dokumenti të quhet një certifikatë e vlefshme, çdo fushë duhet të përmbajë një vlerë.

- | | |
|---------|--|
| Fusha 1 | Shteti Anëtar i autoritetit kompetent që lëshon miratimin sipas së cilit lëshohet certifikata përmendur në fushën 16. Kur autoriteti kompetent është agjencia, duhet shtuar ‘EASA’. Këto emra mund të printohen paraprakisht. |
| Fusha 2 | E printuar paraprakisht ‘Certifikata e lëshimit të autorizuar/Formulari EASA 1’. |
| Fusha 3 | Një numër i veçantë duhet të printohet paraprakisht në këtë fushë për qëllime kontrolli dhe gjurmueshmërie të certifikatës, me përjashtim të rasteve kur dokumenti nxirret nga kompjuteri, nuk është e nevojshme që numri i veçantë të printohet paraprakisht kur kompjuteri është i programuar që të prodhojë numrin. |
| Fusha 4 | Informacioni në këtë fushë duhet të plotësojë dy objektiva:

1. të lidhë certifikatën me një miratim sipërmarrjeje, për qëllimin e verifikimit të origjinalitetit dhe autoritetit të certifikatës |

2. të mundësojë mënyrën e gatshme për të bërë identifikimin e shpejtë të vendit të prodhimit dhe lëshimit, të lehtësojë gjurmueshmërinë dhe komunikimin në rast problemi apo nevojë informacioni.

Prandaj, emri që vendoset në këtë kuti është i mbajtësit të miratimit të sipërmarrjes, i cili është përgjegjës për vlerësimin përfundimtar për përputhshmërinë ose aftësinë për fluturim, numri i referencës së miratimit i të cilit shënohet fushën 16. Emri duhet të shënohet saktësisht në të njëjtën mënyrë siç është në certifikatën e miratimit të mbajtur nga sipërmarrja.

Adresa(t) e shënuara në fushën 4 do të ndihmojnë në identifikimin e mbajtësit të miratimit dhe në identifikimin e vendit të lëshimit.

Nëse vendi i prodhimit dhe i lëshimit ka një nga adresa e sipërmarrjes të renditura në certifikatën e miratimit, atëherë kjo është e vetmja adresë që nevojitet në këtë fushë

Nëse vendi i prodhimit dhe i lëshimit është një vendndodhje e parenditur në certifikatën e miratimit, atëherë nevojiten dy adresa. Adresa e parë është ajo e mbajtësit të miratimit (siç renditet në certifikatën e miratimit) dhe e dyta shënohet për të treguar vendin e prodhimit dhe lëshimit.

Fusha 5 Qëllimi është të përmendet urdhri i punës/ kontrata/ fatura ose çdo veprimtari tjetër të brendshme sipërmarrjeje që të krijohet një sistem gjurmimi i shpejtë. Përdorimi i fushës për një gjurmim të tillë është shumë i këshillueshëm në mungesë të numrave seriale të njësisë ose numrave të grupit. Kur nuk përdoret, shënoni N/A.

Fusha 6 Fusha përdoret për të ardhur në ndihmë të sipërmarrjes që lëshon certifikatën për të lejuar një lidhje të lehtë me fushën 13 ‘Komente’ me anë të përdorimit të numrave të njësisë në vijë. Fusha 6 duhet të plotësohet kur ka më shumë se një njësi në vijë.

Kur disa njësi lëshohen në certifikatë, është e lejueshme të përdoret një renditje më vete që lidh certifikatën dhe renditjen me njëra tjetrën.

Fusha 7 Emri ose përshkrimi i njësisë duhet të shënohet. Përparësi i duhet dhënë përdorimit të sistemit të Katalogut të Pjesëve të Ilustruara (KPI). Përshkrimi duhet të përfshijë lidhje me çdo autorizimi ETSO të zbatueshëm ose tregues EPA.

Fusha 8 Shënoni numrin e pjesës. Përparësi i duhet dhënë sistemit KPI të numrave.

Fusha 9 Përdoret për të treguar kërkesat e miratimit të tipit për të cilat njësitë e lëshuara kanë të drejtë të montohen, bazuar në informacionin e dhënë nga mbajtësi i miratimit të projektimit sipas rregullave të përcaktuara në 21A.4 dhe 21A.133 germa (b) dhe (c). Vlerat e mëposhtme lejohen;

(a) Të paktën një avion, helikë, ose model motori i përcaktuar ose serie siç identifikohen nga mbajtësi i miratimit të projektimit. Në rastin e lëshimit të motorit ose helikës, shënoni kërkesat e miratuara të avionit, ose, nëse kërkesa nuk përcaktohet, shënoni ‘motor/helikë e tipit të certifikuar’. Në rastin e një artikulli ETSO, shënoni ose kërkesat e miratimit të tipit ose ‘artikull ETSO’. Në rastin e njësisë për montim në një artikull ETSO, shënoni numrin e pjesës së artikullit ETSO.

(b) ‘Asnjë’, përdoret vetëm kur dihet që njësitë nuk kanë ende një kërkesë të miratimit të tipit, për shembull: certifikatë e tipit në pritje, vetëm për provë, në pritje të miratimit të të dhënave. Nëse përdoret kjo kategori, atëherë duhet dhënë informacion shpjegues të përshtatshëm në fushën 13 dhe njësi të reja mund të lëshohen vetëm për qëllime përputhshmërie.

(c) ‘Të ndryshëm’ nëse njihen sipas rregullave të përcaktuara në 21A.133 germat (b) dhe (c) për të fituar të drejtën për montim në disa produkte të miratimit të tipit, në përputhje me procedurat e miratuara nga autoriteti kompetent përgjegjës për kryerjen e sondazhit POA.

Në rastin e disa kërkesave të miratimit të tipit, është e pranueshme që kjo fushë të ketë lidhje me një dokument bashkëlidhur që rendit kërkesa të tilla.

Çdo informacion në fushën 9 nuk jep të drejtë për të montuar njësinë në një avion, motor ose helikë të caktuar. Përdoruesi/montuesi duhet të vërtetojë nëpërmjet dokumenteve, si Katalogu i pjesëve, regjistrat e shërbimit, etj., fiton të drejtën për montimin e caktuar.

Çdo informacion në fushën 9 nuk do të thotë detyrimisht që produkti, pjesët ose pajisjet kanë të drejtë të montohen vetëm në modelet e renditura. Gjithashtu, ky informacion nuk siguron që produkti, pjesët ose pajisjet kanë të drejtë të montohen në të gjitha vlerat e fushës 9. Kualifikimi mund të ndikohet nga ndryshime ose sistemime të ndryshme.

Kur një pjesë identifikohet nga mbajtësi i projektimit në përputhje me standarde të njohura zyrtarisht, atëherë pjesa gjykohet si një pjesë standarde dhe lëshimi me një formulari EASA 1 nuk është i nevojshëm. Sidoqoftë, kur një mbajtës i POA-së lëshon një pjesë standarde me një formular EASA 1 atëherë duhet të jetë në gjendje të tregojë që zotëron prodhimin e pjesës së dhënë.

Fusha 10 Shënoni sasinë e njësive për lëshim.

Fusha 11 Shënoni numrin serial ose të grupit nëse ka. Nëse nuk ka asnjërin, shënoni ‘N/A’.

Fusha 12 Vendosni një ose disa fjalë standarde të përshtatshme nga tabela e mëposhtme. Tabela rendit, duke cituar, fjalët standarde të lejuara për përdorim kur lëshohen njësi të reja para se të hyjnë në shërbim, që do të thotë se njësitë nuk janë përdorur në shërbim më parë. Po ashtu, tabela shtjellon rrethanat dhe kushtet në të cilat mund të përdoren. Në të gjitha rastet, zbatohen rregullat e certifikimit në lidhje me fushën 14, shënohet kutia e përshtatshme dhe nënshkruhet fusha 15.

Tabela e fjalëve standarde për pjesët e reja

1. ‘Prodhuar’

(a) Prodhimi i një njësie të re në përputhje me të dhënat e zbatueshme të projektimit, ose

(b) Ricertifikimi nga prodhuesi fillestar pas punës riparuese në një njësi, e lëshuar paraprakisht sipas pikës 1 germa (a), që ka rezultuar e papërdorshme para hyrjes në shërbim, p.sh. me defekt, në nevojë për inspektim apo provë, ose ka përfunduar jetëgjatësinë në raft. Hollësitë e lëshimit fillestar dhe punës riparuese shtohen në fushën 13, ose ricertifikimi i njësive të reja nga qëllimi i përputhshmërisë në qëllim aftësie fluturimi në kohën e miratimit të të dhënave të zbatueshme të projektimit, nëse njësitë janë në përputhje me të dhënat e miratuara të projektimit. Një shpjegim i bazës së lëshimit dhe hollësi të lëshimit fillestar shtohen në fushën 13.

2. ‘Inspektuar’/‘Provuar’

Ekzaminimi i një njësie të lëshuar paraprakisht:

(a) për të krijuar përputhshmëri me të dhënat e zbatueshme të projektimit, ose

(b) në përputhje me një standard ose përcaktim të kërkuar nga klienti, hollësitë e të cilit shtohen në fushën 13, ose

(c) për të krijuar përdorueshmëri dhe kushtet për shërbim të sigurt para rilëshimit si një pjesë këmbimi, kur njësia është marrë me një formular EASA 1. Një shpjegim i bazës së lëshimit dhe hollësi të lëshimit fillestar shtohen në fushën 13.

3. 'Ndryshuar'

Ndryshimi nga prodhuesi fillestar i një njësie të lëshuar paraprakisht para hyrjes në shërbim. Hollësitë e ndryshimit dhe lëshimi fillestar shtohen në fushën 13.

Deklaratat e mësipërme duhet të mbështeten nga lidhje me të dhënat/udhëzuesin/përcaktimet e miratuara. Ky informacion identifikohet ose tek fusha 12 ose 13.

Fusha 13

Është e rëndësishme të shënoni çdo informacion në këtë fushë, ose drejtpërdrejt ose duke u lidhur me dokumentet mbështetëse, që identifikon të dhëna të caktuara ose kufizime në lidhje me njësinë që lëshohet, të cilat janë të nevojshme për përdoruesin/montuesin për të bërë vlerësimin përfundimtar të aftësisë për fluturim të njësisë. Informacioni duhet të jetë i qartë, i plotë dhe i dhënë në një formë dhe mënyrë që i përshtatet qëllimit të një vlerësimi të tillë.

Çdo deklaratë duhet të identifikohet qartësisht se cilit njësie i përket.

Nëse nuk ka asnjë deklaratë, shënoni 'Asnjë'

Shembuj të kushteve që sjellin nevojën për deklarata në fushën 13 janë:

- kur certifikata përdoret për qëllime përputhshmërie, deklarata e mëposhtme shtohet në fillim të fushës 13:
'vetëm për përputhshmëri, nuk ka të drejtë montimi në avionë/motorë/helika në shërbim të tipit të certifikuar';
- kur të dhënat e projektimit nuk janë miratuar nga agjencia, atëherë duhet të identifikohet autoriteti kompetent i vendit të tretë përgjegjës për miratimin e të dhënave të projektimit dhe deklarata e mëposhtme duhet të shtohet bashkë me një lidhje që identifikon miratimin:
'të dhëna të miratuara projektimi nga <identifikoni autoritetin kompetent përgjegjës të një vendi të tretë dhe lidhjen me miratimin>';
- ricertifikimi i njësive të reja nga qëllimi i përputhshmërisë në qëllim aftësie për fluturim në kohën e miratimit të të dhënave të zbatueshme të projektimit, nëse njësitet janë në përputhje me të dhënat e miratuara të projektimit.

Nëse nuk ka pasur asnjë ndryshim në projektim gjatë procesit të miratimit të të dhënave të projektimit, prodhuesi mund të pohojë se të dhënat e projektimit janë miratuar dhe nëse përbërësi i caktuar është në të njëjtën gjendje që ishte kur ju dërgua përdoruesit/montuesit, përbërësi është tani gati për t'u montuar. Prodhuesi duhet të japë po këtë deklaratë në një tjetër formular EASA 1, kur bashkë me komente të tjera duhet të japë dhe informacion shpjegues të përshtatshëm. Duhet të

përdoret formulimi në vazhdim: ‘Ricertifikimi i pjesëve të reja nga përputhshmëri në aftësi për fluturim: ky dokument certifikon vetëm miratimin e të dhënave të projektimit me të cilat kjo (këto) njësi u prodhua(n), por nuk mbulon përputhshmërinë/gjendjen pas lëshimit të formularit fillestar EASA 1 me ref.....’.

Formulari EASA 1 (si për ‘qëllime përputhshmërie’ ashtu edhe për ‘qëllime aftësie për fluturim’) duhet të nxirret nga e njëjta sipërmarrje, që do të thotë prodhuesi fillestar ose kryesor, kushdo që paraqiti formularin origjinal EASA 1 për qëllime përputhshmërie.

- Ku certifikata nuk lëshohet sipas pjesës 21, duhet të përdoret deklarata e mëposhtme:
‘Kjo certifikatë u lëshua sipas...[rregullave të zbatueshme ndryshe nga pjesa 21]’.
- Për motorë dhe helika të përfunduara duhet referuar certifikata e zbatueshme e tipit.
- Për motorë dhe helika të përfunduara, çdo deklaratë eksporti shtesë e kërkuar nga vendi importues siç shprehet në faqen e të dhënave të certifikatës së tipit.
- Për motorë të përfunduar, një deklaratë përputhjeje me kërkesat e zbatueshme të lëshimit të gazrave në fuqi datën e prodhimit të motorit.
- Për artikujt ETSO, shënoni numrin e zbatueshëm të autorizimit ETSO.
- Kufizimet e përdorimit për njësitë e riparuar.
- Standardi i ndryshimeve
- Njësitë e alternative të miratuara të furnizuara.
- Koncesionet e zbatueshme.
- Mospërputhja me përcaktimet e certifikimit.
- Hollësitë e punës riparuese të kryer ose referencë në një dokument ku shprehet kjo punë.
- Përputhja ose mospërputhja me direktiva aftësie për fluturim ose buletinët e shërbimit.
- Informacion për njësitë me jetëgjatësi të kufizuar.
- Gjendja e njësive ose referencë në një dokument që jep këtë informacion.
- Data e prodhimit ose e kurimit.
- Të dhënat për jetëgjatësinë në përdorim.
- Mungesat.
- Koha që nga e reja (TSN), Koha që nga riparimi (TSO), etj.
- Përgjashtime nga kërkesat e veçanta të njoftuara të vendit importues.

- Sistemuar me porosi që të plotësojë kërkesat e veçanta të njoftuara të vendit importues.
- Ricertifikim i njësive të reja të lëshuara paraprakisht.

Fusha 14 Kjo fushë përdoret vetëm për të treguar statusin e njësive të reja.

Qëllimi kryesor i certifikatës është të lëshojë njësi për qëllime aftësie për fluturim, që nënkupton përputhshmëri me të dhënat e miratuara të projektimit dhe në gjendje pune të sigurt.

Certifikimi i aftësisë për fluturim gjykohet nga BE-ja si e vlefshme në mbarë botën, në qoftë se nuk ka kushte importi të veçanta të njoftuara.

Kur formulari EASA 1 përdoret për qëllime aftësie për fluturim për të përmbushur kushte importi të njoftuara të tilla, përputhje me këto kushte importi certifikohet sipas marrëveshjeve dypalëshe ose rregullave të punës të tjera. Kur shënohet P/N në fushën 8 dhe vendoset përputhje me çdo kusht importi në fushën 13, ‘miratuar’ merr kuptimin i miratuar nga autoriteti kompetent i vendit importues.

Certifikata mund të përdoret gjithashtu si një certifikatë përputhshmërie kur njësitë janë në përputhje me të dhënat e zbatueshme të projektimit të cilat nuk miratohet për arsyen e dhënë në fushën 13 (p.sh. certifikatë e tipit në pritje, vetëm për provë, në pritje të dhënash të miratuara).

Në këtë rast deklarata e mëposhtme shtesë duhet të shtohet në fillim të vetë fushës 13 dhe jo në një dokument tjetër: ‘vetëm për përputhshmëri, nuk ka të drejtë montimi në avionë/motorë/helika në shërbim të tipit të certifikuar’.

Përzierja e njësive të lëshuara për qëllime aftësie për fluturim dhe përputhshmërie nuk lejohen në të njëjtën certifikatë. Gjithashtu, referojuni shënimeve për plotësimin e fushës 9.

Fusha 15 Firma normale e shkruar me dorë e një personi që ka autorizim me shkrim nga një sipërmarrje prodhuese e miratuar për të dhënë certifikime në lidhje me njësi të reja. Përdorimi i një vule në vend të firmës nuk lejohet, por personi i autorizuar mund të shtojë firmës së tij gjurmën e një vule për të ndihmuar me njohjen. Firma të nxjerra nga kompjuteri, edhe pse duhet t’i nënshtrohen në çdo rast pëlqimit të autoritetit kompetent, lejohen nëse mund të vërtetohet se ekziston një nivel kontrolli, gjurmimi dhe përgjegjshmërie të barabartë. (Shikoni AMC 21A.163 germa (c) për firmat e nxjerra nga kompjuteri).

Fusha 16 Shënoni referencën e plotë të autorizimit e dhënë nga autoriteti kompetent sipërmarrjes që lëshon njësitë e reja.

Fusha 17 Emri i personit që nënshkruan në fushën 15, e printuar, e shtypur ose e shkruar me shkrim të lexueshëm.

Fusha 18 Data në të cilën nënshkruhet fusha 15, në formatin dita/muaji/viti. Muaji duhet të shkruhet me shkronja (shkronjat duhet të jenë të mjaftueshme në numër që të mos ketë asnjë dyshim mbi muajin e shprehur)

Fusha 19 Nuk përdoret dhe të hiqet për lëshimin e njësive të reja.

- Fusha 20 Nuk përdoret dhe të hiqet për lëshimin e njësive të reja.
- Fusha 21 Nuk përdoret dhe të hiqet për lëshimin e njësive të reja.
- Fusha 22 Nuk përdoret dhe të hiqet për lëshimin e njësive të reja.
- Fusha 23 Nuk përdoret dhe të hiqet për lëshimin e njësive të reja.

SHTETI ANËTAR

Anëtar i

Agjencisë Europiane për Sigurinë e Aviacionit

CERTIFIKATA E RISHIKIMIT TË AFTËSISË PËR FLUTURIM

REFERENCA ARC:

Në zbatim të Rregullores (KE) nr. 1592/2002 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në fuqi në këtë kohë, Shteti Anëtar certifikon se avioni i mëposhtëm:

Prodhuesi i avionit:

Standardi i avionit të prodhuesit:

Tipi i avionit:.....

Regjistrimi i avionit:

Numri serial i avionit:

gjkohet se është i aftë për fluturim në kohën e lëshimit.

Data e lëshimit:

Data e përfundimit:

Firma:

Numri i autorizimit:

Logo-ja e autoritetit kompetent

LEJA E FLUTURIMIT

[*]	
Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar e dhënë sipas Rregullores (KE) nr. 1592/2002 lejon avionin në fjalë të fluturojë brenda Shtetit Anëtar sipas kushteve të renditura më poshtë. Kjo leje është e vlefshme gjithashtu për fluturime drejt dhe brenda shteteve të tjera, nëse merret një miratim i veçantë nga autoritetet kompetente të këtyre shteteve.	1. Kombësia dhe shënime regjistrimi
2. Prodhuesi/tipi i avionit	3. Numri seria
4. Leja mbulon	
5. Kufizime/komente	
6. Vendi dhe data e lëshimit	7. Firma e përfaqësuesit të autoritetit kompetent

Formulari EASA 20

Kjo leje duhet të mbahet në kabinën e avionit gjatë çdo fluturimi.

[*] Për t'u përdorur nga shteti i regjistrimit.

CERTIFIKATA E KUFIZUAR E AFTËSISË PËR FLUTURIM

[*]	(Shteti Anëtar i regjistrimit) (Autoriteti lëshues)	[*]
1. Kombësia dhe shënime regjistrimi	2. Prodhuesi dhe standardi i avionit të prodhuesit	3. Numri seria i avionit
4. Kategoritë		
5. Kjo certifikatë aftësie për fluturim lëshohet në zbatim të [**] (Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, datë 7 dhjetor 1944) dhe Rregullores (KE) nr. 1592/2002, neni 5 pika 3 germa (b) në lidhje me avionin e lartpërmendur, i cili gjykohet se është i aftë për fluturim nëse mirëmbahet dhe drejtohet në përputhje me kufizimet e mëparshme dhe ato përkatëse të shërbimit.		
Bashkë me të mësipërmet zbatohet kufizimet e mëposhtme:		
[**] Avioni mund të përdoret në udhëtime ndërkombëtare pavarësisht nga kufizimet e mësipërme.		
Data e lëshimit:	Firma:	
6. Kjo certifikatë aftësie për fluturim është e vlefshme përveç rastit kur anulohet nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit. Një certifikatë rishikimi të aftësisë për fluturim i bashkëlidhet kësaj certifikate.		

Formulari EASA 24

Kjo leje duhet të mbahet në kabinën e avionit gjatë çdo fluturimi.

[*] Për t'u përdorur nga shteti i regjistrimit.

[**] Fshini atë që nuk zbatohet.

LOGO-JA EASA

LOGO-JA E AUTORITETIT KOMPETENT

CERTIFIKATA E AFTËSISË PËR FLUTURIM

[*]	(Shteti Anëtar i regjistrimit) (Autoriteti lëshues)	[*]
1. Kombësia dhe shënime regjistrimi	2. Prodhuesi dhe standardi i avionit të prodhuesit	3. Numri serial i avionit
4. Kategoritë		
5. Kjo certifikatë aftësie për fluturim lëshohet në zbatim të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, datë 7 dhjetor 1944 dhe Rregullores (KE) nr. 1592/2002, neni 5 pika 3 germa (b) në lidhje me avionin e lartpërmendur, i cili gjykohet se është i aftë për fluturim nëse mirëmbahet dhe drejtohet në përputhje me kufizimet e mëparshme dhe ato përkatëse të shërbimit.		
Data e lëshimit:		
Firma:		
Kufizime/Komente:		
6. Kjo certifikatë aftësie për fluturim është e vlefshme përveç rastit kur anulohet nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit. Një certifikatë rishikimi të aftësisë për fluturim i bashkëlidhet kësaj certifikate.		

Formulari EASA 25

Kjo leje duhet të mbahet në kabinën e avionit gjatë çdo fluturimi.

[*] Për t'u përdorur nga shteti i regjistrimit.

Për t'u përdorur nga shteti i regjistrimit	1. Shteti i regjistrimit	2. Numri i dokumentit:
CERTIFIKATA E ZHURMËS		

3. Kombësia dhe shënime regjistrimi		4. Prodhuesi dhe standardi i avionit të prodhuesit		5. Numri serial i avionit	
6. Motori			7 Helikat [*]		
8. Peshë maksimale e ngritjes (kg)		9. Peshë maksimale e uljes (kg) [*]		10. Standardi i zhurmës	
11. Ndryshime					
12. Niveli i zhurmës anësore/me fuqi maksimale		13. Niveli i zhurmës në afrim	14. Niveli i zhurmës në mbifluturim	15. Niveli i zhurmës në mbifluturim në territor të huaj	16. Niveli i zhurmës në ngritje.
Komente					
17. Kjo certifikatë e zhurmës lëshohet në zbatim të Shtojcës 16, Vëllimi I i Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, datë 7 dhjetor 1944 dhe Rregullores (KE) nr. 1592/2002, neni 6 në lidhje me avionin e lartpërmendur, i cili gjykohet se është në përputhje me standardet e mëparshme të zhurmës nëse mirëmbahet dhe drejtohet në përputhje me kërkesat përkatëse dhe kufizimet e shërbimit.					
18. Data e lëshimit			19. Firma		

Formulari EASA 45

[*] Këto fusha mund të hiqen në varësi të kapitullit të certifikimit.

DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË SË AVIONIT		
1. Shteti i prodhimit	2. Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të Bashkimit Europian ose të EASA-s	3. Nr. i referencës së deklaratës
4. Sipërmarrje		
5. Tipi i avionit		6. Referencat e certifikatave të tipit:
7. Regjistrimi i avionit ose shenja		8. Nr. i identifikimit të prodhuesit
9. Hollësitë e motorit/helikës [*]		
10. Ndryshime dhe/ose buletine shërbimi [*]		
11. Direktiva të aftësisë për fluturim		
12. Koncesione		
13. Përfundime, lëshime ose shmangie [*]		
14. Komente		
15. Certifikata e aftësisë për fluturim		
16. Kërkesa shtesë		
17. Deklarata e përputhshmërisë		
Ky dokument certifikon se avioni i përputhet plotësisht me projektimin e certifikimit të tipit dhe njësisive të lartpërmendura në fushat 9, 10, 11, 12 dhe 13.		
Ky avion është në kushte pune të sigurta.		
Ky avion ka kaluar me sukses provat e fluturimit..		
18. Firma	19. Emri	20. Data (d/m/v)
21. Referenca e miratimit të sipërmarrjes prodhuese		

Formulari EASA 52

[*] Fshini atë që nuk zbatohet

DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË SË AVIONIT – Formulari EASA 52

Udhëzime plotësimi

Për qëllimet e pjesës 21, seksioni A, nënpjesa F, deklaratë e përputhshmërisë nënkupton formularin EASA 52 për avionë të plotë ose formulari EASA 1 për produkte, pjesë, pajisje dhe/ose materiale.

Person i autorizuar nënkupton një person i identifikuar si nënshkrues në manualin e pranuar nga autoriteti kompetent dhe siç parashikohet në 21A.125 germa (b).

Pozicion përgjegjës nënkupton një pozicion të një personi me terma reference që përfshijnë përgjegjësi për përputhshmërinë e produktit dhe që zotëron autoritet të mjaftueshëm për të ndaluar lëshimin e njësive, të cilat nuk përputhen me të dhënat e zbatueshme të projektimit dhe/ose nuk janë në gjendje të sigurt pune.

1. Qëllimi dhe fusha e zbatimit

Përdorimi i deklaratës së përputhshmërisë të lëshuar nga prodhuesi që vepron sipas pjesës 21, seksioni A, nënpjesa F përshkruhet sipas 21A.130 dhe mënyrave të pranueshme përkatëse të përputhshmërisë.

Qëllimi i deklaratës së përputhshmërisë (formulari EASA 52) të lëshuar sipas pjesës 21, seksioni A, nënpjesa G është t'i japë mbajtësit të një miratimi të përshtatshëm të sipërmarrjes prodhuese të drejtë të ushtrijë privilegjin për të marrë një certifikatë individuale të aftësisë për fluturim nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të regjistrimit.

2. Të përgjithshme

Deklarata e përputhshmërisë duhet të jetë në përputhje me formatin e bashkëlidhur duke përfshirë numra të shkruar të dukshëm dhe vendndodhjen e secilës fushë. Përmasat e secilës fushë mund të ndryshojnë në varësi të kërkesës individuale, por jo në atë masë që e bën certifikatën të padallueshme. Nëse jeni të paqartë, këshillohuni me autoritetin kompetent.

Certifikata ose mund printohet paraprakisht ose të nxirret me anë të kompjuterit, por në çdo rast printimi i vijave dhe të dhënave duhet të jetë e qartë dhe e lexueshme. Fjalët e printuara paraprakisht janë të lejuara në përputhje me shembullin e bashkëlidhur, por asnjë deklaratë certifikimi tjetër nuk lejohet.

Të dhënat për t'u hedhur në certifikatë mund të jenë ose të printuara me anë të pajisjeve/kompjuterit ose të shkruara me dorë duke përdorur shkronja shtypi të mëdha dhe duhet të jenë të lehta për t'u lexuar. Anglishtja, dhe sipas rastit, një ose më shumë gjuhë zyrtare të Shtetit Anëtar lëshues janë të lejuara.

Një kopje e deklaratës si dhe të gjitha referencat e bashkëlidhura duhet të ruhen nga sipërmarrje prodhuese e miratuar.

3. Plotësimi i certifikatës së lëshimit nga krijuesi

Në mënyrë që dokumenti të quhet një deklaratë e vlefshme, çdo fushë duhet të përmbajë një vlerë.

Një deklaratë e përputhshmërisë nuk mund t'i lëshohet autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të regjistrimit pa miratimin e projektimit të avionit dhe pjesëve të tij të montuara.

Informacioni i nevojshëm në fushat 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14 mund të jepet si referencë e dokumentave të identifikuar të veçantë mbajtur në dosje nga sipërmarrje prodhuese, përveç rasteve kur autoriteti kompetent vendos ndryshe.

Kjo deklaratë e përputhshmërisë nuk ka për qëllim të përfshijë ato njësi pajisjesh që duhet të montohen për të plotësuar rregullat e zbatueshme të shërbimit. Sidoqoftë, disa nga këto njësi mund të përfshihen në fushën 10 ose në projektimin e tipit të miratuar. Prandaj, përdoruesit duhet të kujtohen për përgjegjësinë e tyre për të siguruar se shërbimi i caktuar i tyre është në përputhje me rregullat e zbatueshme të shërbimit.

Fusha 1	Shtoni emrin e shtetit të prodhimit
Fusha 2	Autoriteti kompetent nën përgjegjësinë e së cilit lëshohet deklarata e përputhshmërisë
Fusha 3	Një numër serial unik duhet të jetë i printuar paraprakisht në këtë fushë për kontrollin dhe gjurmueshmërinë e deklaratës. Përveç rastit kur dokumenti nxirret nga kompjuteri numri nuk duhet të printohet paraprakisht nëse kompjuteri është i programuar të prodhojë dhe të printojë një numër unik.
Fusha 4	Emri i plotë dhe adresa e sipërmarrjes që lëshon deklaratën. Kjo fushë mund të printohet paraprakisht. Logo-t etj., lejohen nëse logo-ja qëndron brenda fushës.
Fusha 5	Tipi i plotë i avionit siç përshkruhet në certifikatën e tipit dhe faqen shoqëruese të të dhënave.
Fusha 6	Numrat e referencës së certifikatës së tipit dhe botimi i avionit të dhënë.
Fusha 7	Nëse avioni është i regjistruar, atëherë kjo shenjë është ajo e regjistrimit. Nëse avioni nuk është i regjistruar, atëherë kjo është një shenjë e pranuar nga autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar dhe, nëse është e zbatueshme, nga autoriteti kompetent i një vendi të tretë.
Fusha 8	Numri i identifikimit i caktuar nga prodhuesi për kontroll dhe gjurmueshmëri dhe mbështetje në lidhje me produktin. Ky quhet ndonjëherë nr. serial i prodhuesit ose nr. i krijuesit.
Fusha 9	Tipi ose tipat e plotë të motorit dhe helikave siç përshkruhen në certifikatën përkatëse të tipit dhe në faqen shoqëruese të të dhënave.
Fusha 10	Ndryshimet e miratuara të projektimit në përkufizimin e avionit
Fusha 11	Një renditje e të gjitha direktivave të zbatueshme të aftësisë për fluturim (ose të barasvlefshmet) dhe një deklaratë përputhjeje bashkë me një përshkrim të mënyrës së përputhjes për avionin në fjalë duke përfshirë produkte dhe pjesë të montuara, aparatura dhe pajisje. Çdo periudhë e kërkesës së përputhjes në të ardhmen duhet të tregohet.
Fusha 12	Ndryshime të miratuara të paqëllimshme në projektimin e miratuar të tipit ndonjëherë quajtur koncesione, divergjenca ose mospërputhje.
Fusha 13	Këtu mund të shënohen vetëm përjashtimet, lëshimet ose shmangiet e pranuar.
Fusha 14	Komente. Çdo deklaratë, informacion, të dhëna ose kufizime të veçanta të cilat mund të ndikojnë në aftësinë për fluturim të avionit. Nëse nuk ka informacion ose të dhëna të tilla, vendosni: ‘Asnjë’.

- Fusha 15 Shënimi 'certifikatë aftësie për fluturim', ose 'certifikatë e kufizuar aftësie për fluturim', ose certifikatën e aftësisë për fluturim që kërkohet.
- Fusha 16 Kjo fushë duhet të përmbajë kërkesat shtesë si ato të njoftuara nga një vend importues.
- Fusha 17 Vlefshmëria e deklaratës së përputhshmërisë është në varësi të plotësisë të të gjitha fushave në formular. Një kopje e raportit të fluturimit provë bashkë me çdo defekt të regjistruar dhe hollësi riparimi duhet të mbahen në dosje nga mbajtësi POA. Raporti duhet të jetë i nënshkruar si i pranueshëm nga stafi i përshtatshëm certifikues dhe një anëtar i ekuipazhit të fluturimit, p.sh. piloti i provës ose inxhinier i fluturimit të provës. Fluturimet e provës të kryera janë ato të përcaktuar sipas sistemit të kontrollit të cilësisë, siç shprehet në 21A.139 në veçanti 21A.139 germa (b) pika 1 nënpika (vi), për të siguruar që avioni është në përputhje me të dhënat e zbatueshme të projektimit dhe është në gjendje pune të sigurtë.
- Fusha 18 Deklarata e përputhshmërisë mund të nënshkruhet nga personi i autorizuar për këtë nga mbajtësi i miratimit të prodhimit në përputhje me 21A.145 germa (d). Nuk lejohet përdorimi i një vule gome).
- Fusha 19 Emri i personit që nënshkruan certifikatën duhet të printohet ose të shkruhet që të jetë i lexueshëm.
- Fusha 20 Këtu vendoset data e nënshkrimit të certifikatës së aftësisë për fluturim.
- Fusha 21 Këtu vendoset referenca e miratimit e autoritetit kompetent që zotëron mbajtësi POA.

CERTIFIKATË LËSHIMIT NË SHËRBIM

[EMRI I SIPËRMARRJES SË MIRATUAR TË PRODHIMIT]

Referenca e miratimit të sipërmarrjes së prodhimit:

Certifikata e lëshimit në shërbim në përputhje me 21A.163 germa (d).

Avioni:..... Tipi:..... Nr. i prodhuesit/regjistrimi:.....

është miratuar si përputhshëm në Udhëzimin e Detyrues

Formulari EASA 53

CERTIFIKATA E LËSHIMIT NË SHËRBIM – FORMULARI EASA 53

Udhëzime plotësimi

Fusha e përshkrimit të shkurtër të punës së kryer në formularin EASA 53 duhet të përfshijë një referencë të të dhënave të miratuara që janë përdorur për të kryer punën.

Fusha e vendndodhjes/vendit në formularin EASA 53 nënkupton vendin ku është kryer mirëmbajtja dhe jo vendin e ndërtesave/zyrave të sipërmarrjes (nëse janë të ndryshme).

CERTIFIKATA E MIRATIMIT TË SIPËRMARRJES PRODHUESE

Autoriteti kompetent
i Shtetit Anëtar të
Bashkimit Europian* ose EASA-s

Certifikatë miratimi

Referenca: NAA.G.XXX

Autoritetit kompetent i Shtetit Anëtar të Bashkimit European ose EASA-s	Kushtet e miratimit	TA: NAA.G.XXXX
Ky dokument është pjesë e numrit të miratimit të sipërmarrjes prodhuese NAA.G.XXXX lëshuar: Emri i kompanisë		

Seksioni 1 Fusha e zbatimit:

PRODHIMI I

PRODUKTET/KATEGORITË

Për hollësi dhe kufizime referohuni tek Ekspozita e sipërmarrjes prodhuese, seksioni xxx

Seksioni 2. Vendndodhjet:

Seksioni 3: Privilegjet

Sipërmarrje prodhuese ka të drejtë të ushtrojë, brenda kushteve të miratimit dhe në përputhje me procedurat e ekspozitës së sipërmarrjes prodhuese, privilegjet e përcaktuara në 21A.163. Këto i nënshtrohet rregullave të mëposhtme:

Një formular EASA 1 mund të lëshohet vetëm për qëllime përputhshmërie para miratimit të projektimit të produktit.

Një deklaratë përputhshmërie nuk mund të lëshohet për një avion të pamiraturar.

Mirëmbajtja mund të kryhet, deri kur të kërkohet përputhja me rregulloret e mirëmbajtjes, në përputhje me Ekspozitën e sipërmarrjes prodhuese, seksioni xxx.

Data e lëshimit fillestar:	Data e këtij lëshimi:	Firma:
		Për autoritetin kompetent ose EASA-n

Formulari EASA 55 – Certifikata e miratimit POA – Faqe B

Muaji Viti

LETËRMARRËVESHJE

Autoriteti kompetent i
Shtetit Anëtar i
Bashkimit European ose EASA-s

[Emri i kërkuesit]

[Emri tregtar (nëse është ndryshe)]

Adresa e plotë e kërkuesit]

Data (dita, muaji, viti)

Referenca: [NAA].F.[XXX]

Lënda: Prodhimi pa POA-në, Letërmarrëveshje

Të nderuar zotërinj,

Sistemi juaj i inspektimit të prodhimit është vlerësuar dhe gjykohet të jetë në përputhje me pjesën 21, seksioni A, nënpjesa F.

Prandaj, duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara më poshtë, jemi të mendimit se shfaqja e produkteve, pjesëve dhe aparaturave të përmendura më poshtë mund të kryhet sipas pjesës 21, seksioni A, nënpjesa F.

Nr. i njësive	P/N	S/N
---------------	-----	-----

AVIONI

PJESËT

Kushtet e mëposhtme janë të zbatueshme për këtë marrëveshje:

1. Marrëveshja është e vlefshme për sa kohë që [emri i kompanisë] qëndron në përputhje me pjesën 21, seksioni A, nënpjesa F.
2. Marrëveshja duhet të jetë në përputhje me procedurat e përcaktuara në referencën e udhëzuesit/Datën e lëshimit..... të [emri i kompanisë].
3. Marrëveshja përfundon më
4. Deklarata e përputhshmërisë e lëshuar nga [emri i kompanisë] sipas dispozitave të 21A.130 bëhet e vlefshme nga autoriteti lëshues i kësaj letërmarrëveshjeje në përputhje me procedurat të udhëzuesit të lartpërmendur.
5. [Emri i kompanisë] njofton autoritetin lëshues të kësaj letërmarrëveshjeje menjëherë mbi çdo ndryshim në sistemin e inspektimit të prodhimit që mund të ndikojë inspektimin, përputhshmërinë ose aftësinë për fluturim të produkteve dhe pjesëve të renditura në këtë letër.

Data dhe firma

Formulari EASA 65